



# Zotërimi i armëve të zjarrit dhe dhuna në familje në Ballkanin Perëndimor:

Një studim krahasues i legjislacionit dhe mekanizmave zbatuese



**SEESAC**

South Eastern and Eastern Europe Clearinghouse  
for the Control of Small Arms and Light Weapons

---

**Zyra për Koordinimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta për Evropën Lindore dhe Jug-lindore (SEESAC)** ka mandat nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (UNDP) dhe Pakti i Stabilitetit për Evropën Jug-lindore (SCSP) të mbështesë të gjithë grupet kombëtare dhe ndërkombëtare të interesit nëpërmjet forcimit të kapaciteteve kombëtare dhe rajonale në drejtim të kontrollit dhe reduktimit të përhapjes dhe keqpërdorimit të armëve të vogla dhe të lehta, duke ndihmuar kështu në rritjen e stabilitetit, sigurisë dhe zhvillimit në Evropën Lindore dhe Jug-lindore.

---

*Për informacione të mëtejshme kontaktoni në:*

**Head, SEESAC  
Hadzi Milentijeva 30  
11000 Belgrade  
Serbia and Montenegro**

Tel: (+381) (11) 344 6353; 383 6972; 383 6974

Fax: (+381) (11) 344 6356

[www.seesac.org](http://www.seesac.org)

***Zotërimi i armëve të zjarrit dhe dhuna në familje në Ballkanin Perëndimor: Një studim krahasues i legjislationit dhe mekanizmave zbatuese.***

#### **Mirënjohje**

Ky raport u shkrua dhe përpilua nga Mirjana Dokmanovic, Kërkuese e Pavarur. Raporti bazohet mbi kërkimet e kryera në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Provincën Kosovës të Administruar nga KB . Kërkimet kombëtare u kryen nga Arta Mandro (Shqipëri), Nikolina Obradovic (Bosnje and Hercegovinë), Snjezana Vasiljevic (Kroaci), Jasminka Friscik (IRJ e Maqedonisë), Ferdane Osmani (Provincia e Kosovës e Administruar nga KB), Boban Saranovic (Mal i Zi) and Diana Miladinovic (Serbi). Raporti u projektua, menaxhua dhe editua nga Ciara Loughney Zyrtare për Ndërgjegjësim e SEESAC SALW. Dizajnimi grafik dhe paraqitja u kryen nga Katarina Stankovic-Bjegovic.

© **SEESAC 2007 – Të gjitha të drejtat janë të rezervuara**

**ISBN: 978-86-7728-073-4**

---

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian, Paktit të Stabilitetit për Evropën Jug-lindore apo Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin. Shprehjet dhe materialet e paraqitura në këtë publikim nuk shprehin pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Paktit të Stabilitetit për Evropën Jug-lindore apo Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin në lidhje me 1) statusin ligjor të ndonjë vendi, territori apo zone apo të autoriteteve ose të grupeve të tij të armatosura; ose 2) të përcaktimit të kufijve apo kufizimeve.

---

## Përmbledhje

Vendet e Ballkanit Perëndimor<sup>1</sup> përballen me një nivel të lartë të dhunës kriminale dhe pasigurisë së njerëzve kjo si pasojë e trashëgimisë së konflikteve të kohëve të fundit, përshtjellimeve politike dhe krizave ekonomike. Lufta në ish Jugosllavi ndikoi në një rritje të numrit të armëve të vogla dhe të lehta si dhe në gjetjen dhe zotërimin e tyre me lehtësi si legalisht ashtu dhe ilegalisht, duke ndikuar kështu në një rritje të sjelljeve të dhunshme jo vetëm në hapësirat publike por dhe brenda familjes. Të tjerë faktorë që lidhen me situatat post-konfliktuale dhe tranzicionin kanë ndihmuar gjithashtu në një rritje të dhunës në familje, duke përfshirë dhe pasigurinë ekonomike dhe personale, papunësinë, krimin dhe mostolerancën.

Të dhëna të siguruara nga kërkime ekzistuese sugjerojnë se dhuna në familje është forma më e përhapur e dhunës përgjatë gjithë rajonit dhe se gratë janë viktimat kryesore. Është përlogaritur se një në çdo katër gra që kanë pasur qoftë dhe një partner, ka përjetuar dhunë fizike apo seksuale në marrëdhëniet intime. Studimet e kryera kryesisht nga OJQ-të e grave, zbulojnë një nivel të lartë të rasteve që nuk janë raportuar të dhunës në familje, kjo në sajë të paragjykimeve ekzistuese gjinore që i dekurajojnë gratë për të raportuar dhunën në familje si dhe mungesa e sigurisë dhe e qasjes së shpejtë në sistemin e drejtësisë. Për më tej, kërkimet tregojnë se viktimat zakonisht kërkojnë ndihmë pasi janë ekspozuar kundrejt një dhune të vazhdueshme shumëvjeçare dhe pasi marrin dëmtime fizike.

Për më tepër si rezultat i punës avokuese të OJQ-ve të grave, qeveritë e vendeve të rajonit kanë bërë përparime këto vitet e fundit në drejtim të zhvillimit të një legjislacioni specifik kundër dhunës në familje, duke krijuar masa ligjore dhe penalizime *ex officio*. Në shumicën e këtyre vendeve dhuna në familje është tani e saktësuar si kundërvajtje penale. Pothuaj të gjitha vendet kanë përshtatur ligje të veçanta kundër dhunës në familje dhe kanë zhvilluar legjislacionin për krimet e lehta që siguron masa mbrojtëse për viktimat, duke përfshirë mundësinë për të urdhëruar konfiskimin e armëve të zjarrit të personave abuzues.

Gjithsesi, një aplikim i plotë i autoriteti të ligjit është penguar nga mungesat që ekzistojnë në parashikimet ligjore dhe zbatimin e tyre; nga mungesa e kuptimit të politikave që kanë të bëjnë me dhunën në familje; mungesa e zhvillimeve institucionale dhe mungesa e hapësirave buxhetore për strategjitë kombëtare në këtë fushë. Gjithashtu ekziston mungesa e një mbështetjeje sistematike nga ana e OJQ-ve që japin shërbime për viktimat e dhunës në familje. Në të gjitha vendet e rajonit shërbimet që mbrojnë viktimat e dhunës në familje sigurohen më së shumti nga grupet e grave dhe financohen nga donatorë ndërkombëtarë. Kohët e fundit autoritetet kombëtare kanë filluar të rrisin përfshirjen e shërbimeve sociale që synojnë në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Pavarësisht, qeveritë ende nuk u kushtojnë pothuajse fare vëmendje aktiviteteve që synojnë ngritjen e ndërgjegjësimit, edukimit të rinjve, trajnimet profesionale dhe masa të tjera parandaluese. Gjithashtu ekziston një mungesë e mbledhjes së të dhënave në mënyrë të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse, e kërkimeve dhe monitorimeve gjë që sjell dhe pengimin e politikave efektive.

Në një situatë post konfliktuale, përgjigjja kundrejt dhunës në familje duhet t'i drejtohet çështjes së kontrollit të AVL-ve nëpërmjet politikave, strategjive dhe masave që synojnë parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave. Sidoqoftë në Ballkanin Perëndimor armët e zjarrit të konsideruara si një faktor rreziku për dhunën në familje dhe lidhja e tyre me numrin në rritje të AVL-ve, nuk janë njohur deri më tani në mënyrë eksplicite si nga ana e qeverive ose, në më të shumtën e rasteve, nga shoqëria civile. Kështu, nuk kanë munguar lidhjet mes strategjive kombëtare dhe planeve të veprimit në fushën e dhunës në familje dhe kontrollit të AVL-ve si dhe nuk janë zhvilluar politika gjithëpërfshirëse dhe mekanizma monitorimi.

E vetmja fushë ku janë bërë lidhjet është fusha e legjislacionit e rregullon pajisjen me një licencë për armë zjarri dhe zotërimin e një të tille, por ende ka hapësira si në legjislacion ashtu dhe në zbatimin e tij në këtë fushë që pengojnë parandalimin efektiv të dhunës në familje të shkaktuar nga armët. Një histori sjelljesh të dhunshme, gjykimi apo dënimi në rast krimesh, janë kritere për refuzimin e aplikimit për pajisje me licencë për armë zjarri, por këto kufizime janë ende shumë të buta. Për më tepër, kontrollet kundrejt kandidatit kanë mungesa të

<sup>1</sup> Ky studim i referohet Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi, Serbisë, Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Territorit të Kosovës nën Administrimin e Kombeve të Bashkuara. Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) u vendos në bazë të Rezolutës 1244 Këshillit të Sigurimit të datës 10 Qershor 1999, dhe qysh prej asaj kohë është autoriteti administrativ i Kosovës. 'Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, përdoret si term nga Kombet e Bashkuara për t'ju referuar këtij vendi, kjo në sajë të kundërshtive mes këtij vendi dhe Greqisë. Për këtë arsye termi 'IRJ Maqedoni' do të përdoret përgjatë këtij teksti.

procedurave dhe udhëzimeve të qarta dhe përgjithësisht nuk përfshijnë konsultime me anëtarët e familjes dhe ish partnerët rreth sjelljeve të mundshme të dhunshme të kandidatit. Sigurimi i një prove që vërteton një shëndet mendor dhe kushte psikologjike të qëndrueshme të kandidatit nuk është i detyrueshëm në të gjitha vendet.

Për sa i përket shërbimeve të mbrojtjes së viktimave, në shumicën e vendeve nuk është zhvilluar bashkëpunimi i ndërsjellët dhe protokollet funksionuese që kanë të bëjnë me dhunën në familje mes gjithë institucioneve përkatëse. Mund të thuhet se programet edukuese dhe trajnuese për zyrtarët e policisë, gjykatësit, prokurorët, punonjësit sociale dhe profesionistët e tjerë që merren me dhunën në familje nuk janë zbatuar në bazë sistematike dhe të rregullt nga ana e shtetit. Profesionistët janë të ndjeshëm për sa i përket çështjeve gjinore dhe nuk janë gjithashtu të trajnuar mjaftueshëm për të zbatuar legjislacionin specifik mbi dhunën në familje dhe veçanërisht në rastet kur ka rrezik të përdoren armët e zjarrit. Mekanizmat dhe strukturat zbatuese janë përgjithësisht jo efektive ose në rastin tjetër jo të mirë koordinuara. Mungon kontrolli apo monitorimi i vazhdueshëm i sjelljeve të njerëzve që zotërojnë dhe/ose mbajnë me vete armë zjarri.

Gjithashtu masat parandaluese kundrejt dhunës së armatosur janë zhvilluar në mënyrë të dobët. Plani i Veprimit Kombëtar për Barazinë Gjinore e pajis politikën kombëtare në fushën e luftimit të dhunës në familje por nuk i drejtohet çështjes së kontrollit të armëve të zjarrit. Kjo çështje nuk ka qenë në agjendën e mekanizmave të barazisë gjinore në asnjë nga vendet ku është shtrirë kërkimi. Nuk ekzistojnë arsimim i drejtuar nga çështjet gjinore në shkolla, programet edukuese që synojnë djemtë dhe burrat me qëllim parandalimin e dhunës apo programet rehabilituar personat që kanë kryer kështu lloj krimesh. Nuk ekziston gjithashtu asnjë fushatë gjithëpërfshirëse e ngritjes së ndërgjegjësimit kundra 'kulturës së armëve' dhe mentalitetit për të pasur një armë zjarri në shtëpi.

Si rezultat i kësaj, viktimat e dhunës në familje duke përfshirë dhe dhunën me armë, ende nuk kanë qasje të shpejtë dhe të sigurt në sistemin e drejtësisë si dhe nuk kanë mbrojtje të përshtatshme pavarësisht legjislacionit dukshëm të përparuar. Qeveritë duhet të ndërmarrin veprime që ti drejtohen kësaj çështjeje, duke përfshirë këtu dhe zhvillimin dhe zbatimin e masave parandaluese që synojnë dhënien fund të të gjitha formave të dhunës, duke marrë përgjegjësinë për mbrojtjen e viktimave dhe zhvillimin e politikave që reduktojnë gjetjen dhe keqpërdorimin e armëve të zjarrit. OJQ-të e grave mund të japin një ndihmesë të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi duke përfshirë e çështjen e kontrollit të AVL-ve në aktivitetet e tyre lobuese dhe avokuese.

## Shkurtime

AVL	Armët e Vogla dhe të Lehta
BE	Bashkimi Evropian
BH	Bosnja dhe Hercegovina
CEDAW	Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave
EJL	Evropa Jug Lindore
FBH	Federate e Bosnjës dhe Hercegovinës
FNK	Forcat e NATO-s në Kosovë
IRJ e Maqedonisë	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
KDESK	Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (i OKB-së)
KE	Këshilli i Evropës
KEDN	Karta Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
MAPE	Misioni i Asistencës Policore të Komunitetit Evropian në Shqipëri
MeB	Ministria e Brendshme
MeD	Ministria e Drejtësisë
MeM	Ministria e Mbrojtjes
MeSH	Ministria e Shëndetësisë
MPCSMB	Ministria e Punës, çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikave Sociale
OJQ	Organizata Joqeveritare
OSBE	Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin Evropian
RRNVAV	Rrjeti Ndërkombëtar i Veprimtarisë mbi Armët e Vogla
RS	Republika Srpska
RSD	Dinar Serb
SEESAC	Zyra për Koordinimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta për Evropën Lindore dhe Jug-lindore
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin
UNIFEM	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Gratë
UNMIK	Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

## Përmbajtja

<b>Përmbledhje</b> .....	<b>i</b>
<b>Shkurtime</b> .....	<b>iii</b>
<b>Përmbajtja</b> .....	<b>iv</b>
<b>1 Hyrje</b> .....	<b>1</b>
1.1 Prapafusha e Studimit .....	1
1.2 Synimet .....	1
1.3 Metodologjia .....	2
<b>2 Armët e Zjarrit si një faktor rreziku për dhunën në familje në Ballkanin Perëndimor</b> .....	<b>3</b>
2.1 Përhapja e armëve të zjarrit të zotëruara nga civilët .....	3
2.2 Përhapja e dhunës në familje .....	3
2.3 Ndikimi i armëve të vogla në dhunën në familje .....	5
<b>3 Qasja e qeverive kombëtare në luftën kundër dhunës në familje</b> .....	<b>7</b>
3.1 Legjislationi dhe parashikimet ligjore që lidhen me dhunën në familje .....	7
3.2 Masat për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje dhe dhunës së armatosur në familje .....	9
3.3 Masat për të parandaluar dhunën në familje dhe dhunën e armatosur në familje .....	14
3.4 Mekanizmat zbatues .....	17
3.5 Përmbledhje .....	19
<b>4 Rregullat kombëtare për mbajtjen e AVL-ve nga ana e civilëve</b> .....	<b>20</b>
4.1 Legjislationi i përfundimit dhe zotërimit të armëve të zjarrit .....	20
4.2 Mekanizmat zbatues .....	23
4.3 Përmbledhje .....	24
<b>5 Lidhjet mes regjimeve të kontrollit të armëve të vogla dhe legjislationit të dhunës në familje</b> .....	<b>25</b>
5.1 Legjislationi dhe praktika .....	25
5.2 Hapësirat dhe praktikat e mira .....	26
5.3 Propozimet ekzistuese për ndryshimet ligjore dhe strategjike .....	29
5.4 Përmbledhje .....	29
<b>6 Përfundime</b> .....	<b>30</b>
<b>7 Rekomandime për Qeveritë</b> .....	<b>32</b>
<b>8 Aktivitete dhe strategjitë e reja: Mundësitë për përfshirje të shoqërisë civile</b> .....	<b>36</b>
<b>9. Përmbledhje e konkluzioneve dhe rekomandimeve për qeveritë nga studimet kombëtare</b> .....	<b>38</b>
<b>Shtojca A – Një rishikim i praktikave me të mira globale</b> .....	<b>49</b>
<b>Shtojca B – Bibliografia</b> .....	<b>54</b>
<b>Shtojca C – Lista e kontakteve të kërkuesve</b> .....	<b>64</b>
<b>Shtojca D – Shembull i pyetësorit/ Udhëzues për Intervistën</b> .....	<b>66</b>

# 1 Hyrje

## 1.1 Prapafusha e Studimit

Vendet e Ballkanit perëndimor ndajnë mes tyre shumë karakteristika që kanë të bëjnë me të kaluarën të tashmen dhe të ardhmen e tyre të përbashkët dhe të ndërlidhur. Të gjitha këto janë vende postsocialiste dhe postkonfliktuale, që ndajnë mes tyre rrjedhojat e luftërave të dhunshme, paqëndrueshmëri politike, kriza ekonomike dhe tranzicionin në një ekonomi të tregut.

Tani, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor janë në procesin e ecjes drejt integritit në Bashkimin Evropian, duke eliminuar të gjitha pengesat e së kaluarës dhe duke ndërtuar politika korniza legjislative dhe mekanizma që do të ndihmojnë në demokratizimin, shtetin ligjor, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe barazinë gjinore. Në këtë drejtim të gjitha vendet janë në procesin e zhvillimit apo kanë zhvilluar kohët e fundit legjislacione të reja në fushën e mbajtjes dhe të pajisjes me armë dhe në dhunën në familje. Kjo përfaqëson një mundësi të rëndësishme për Shtetet e Ballkanit Perëndimor për të përfutur nga eksperiencat e njëri – tjetrit dhe nga praktikat më të mira botërore në mënyrë që të miratojnë ligjet më të mira të mundshme për të mbrojtur interesat e shtetit dhe të qytetarëve.

Të dhënat e mbledhura tregojnë së dhuna në familje është një problem i përhapur dhe serioz në rajon, i përkeqësuar ky dhe nga tensionet post konfliktuale dhe problemet që lidhen me to. Të dhëna nga strehimoret e grave tregojnë se frekuenca e përdorimit të armëve në këto raste është e lartë, si në rastet kur përdoret për të kërcënuar viktimën ashtu dhe në rastet për ta plagosur apo vvarë. Ky informacion mbështetet nga të dhënat e studimeve në rajon si dhe nga monitorimi i raporteve dhe analizave të mediave.

Eksperienca nga vendet e tjera ka treguar se lidhja mes gjetjes dhe zotërimit të armëve nga ana e civilëve dhe legjislatcionit që ka të bëjë me dhunën në familje ka çuar në një ulje domethënëse të numrit të grave të vrara, të plagosura apo dhe të kërcënuara nga armët në dhunën në familje.<sup>1</sup>

Deri më tani nuk është kryer ndonjë kërkim relevant mbi këto lidhje në Ballkanin Perëndimor. Ky studim rajonal synon të mbushë këtë zbrazëti. Studimi do të shohë se deri ku ligjet që kanë të bëjnë me dhunën në familje dhe regjimet e kontrollit të armëve janë përqsasur në rajon në mënyrë që të japë rekomandime për të bërë përmirësime në legjislatcionin dhe mekanizmat zbatuese dhe për të ndërtuar një platformë lobuese për shoqërinë civile që luftojnë dhunën ndaj grave për tu përfshirë në procesin e armatimit. Si procesi i kërkimit të këtij studimi ashtu dhe gjetjet që dalin prej tij do të ndihmojnë në ndërtimin e kapaciteteve të shoqërisë civile dhe autoriteteve kombëtare në çështjet e armatimit nëpërmjet përfshirjes në diskutime, ndërtimit të rrjeteve dhe sigurimit të informacionit dhe analizës së nevojshme për të avokuar në drejtim të përmirësimit të parandalimit të dhunës së armatosur në familje si dhe mbrojtjes së viktimave.

## 1.2 Synimet

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të vlerësojë lidhjet mes përfutimit të armëve dhe kushteve të zotërimit të tyre dhe legjislatcionit mbi dhunën në familje në mënyrë që të zhvillojë strategji dhe rekomandime për përmirësime në legjislatcion dhe mekanizmat zbatuese për të rritur mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe për të luftuar dhunën në mënyrë më efektive.

Synimet specifike të këtij studimi janë:

- Të demonstrojë lidhjet ekzistuese si dhe nevojën për lidhje të mëtejshme mes legjislatcionit që ka të bëjë me dhunën në familje dhe zotërimin dhe përfutimin e armëve në mënyrë që të reduktojë numrin e vdekjeve, lëndimeve dhe kërcënimeve që vijnë prej armëve të zjarrit në dhunën në familje;
- Të krijojë një platformë lobuese prej së cilës të mund të avokohet tek qeveritaret dhe ligjvënësist në Ballkanin Perëndimor për të kaluar apo përmirësuar legjislatcionin që ka të bëjë me dhunën në familje dhe përfutimin dhe zotërimin e armëve;

<sup>1</sup> Shiko Aneksin A – Shikim mbi Praktikrat më të Mira Botërore.



- Të rrisë ndërgjegjësimin mes qeverive dhe shoqërisë civile mbi mënyrën se si ato mund të veprojnë për të reduktuar ndikimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje dhe të rrisë dhe të përmirësojë mbrojtjen e viktimave të prekura nga kjo dhunë;
- Të mbështesë proceset lobuese me qëllim çarmatimin në Ballkanin Perëndimor apo aty ku nuk janë të pranishme, të nxisë shoqërinë civile (në mënyrë të veçantë OJQ-të e grave) për tu përfshirë në debate çarmatimi dhe të llojë për legjislacionin e zotërimit të armëve si dhe në atë të dhunës në familje.

### 1.3 Metodologjia

Studimi ka një karakter kombëtar dhe rajonal. Kërkimi është drejtuar nga dhuna në familje dhe legjislacioni i AVL-ve dhe mekanizmat zbatuese në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Territorin e Kosovës të Administruar nga OKB-ja.<sup>2</sup>

Pyetjet kryesore që shtrohen në kërkimet kombëtare mund të përkufizohen si më poshtë vijon:

- Deri në çfarë mase janë të lidhura legjislacionet që merren me dhunën në familje dhe regjimet kombëtare që kontrollojnë armët?
- Cilat janë mënyrat më të mira për të lidhur legjislacionin që ka të bëjë me përfundimin dhe zotërimin e armëve me atë të dhunës në familje në mënyrë që të zvogëlohet dhuna kundër grave në sferën private?

Duke iu referuar pyetjeve të kërkimit, kërkuesit kryen kërkime në zyra dhe në terren. Kërkuesit analizuan si legjislacionin specifik aktual dhe atë që është planifikuar mbi dhunën në familje dhe AVL-të ashtu si dhe parashikimet përkatëse të Ligjit mbi Barazinë Gjinore, Kodi Penal, Ligjin mbi Ligjin Publik dhe rendin dhe strategjitë dhe planet e veprimit përkatës për çdo komb.

Në mënyrë që të mblidhej informacion mbi mënyrën se si këto ligje janë zbatuar në praktikë dhe në të njëjtën kohë janë interpretuar nga gjykatat, policia, prokurorët, qendrat e punës sociale dhe institucionet e kujdesit shëndetësor, kërkuesit kanë kryer intervista personale me përfaqësues të këtyre institucioneve. OJQ-të e grave që merren me çështjet e dhunës në familje ishin gjithashtu të përfshira në procesin e intervistimit. Për këtë qëllim, u përgatitën pyetësorë të përbashkët. Pyetësorët përfshinin pyetje mbi të dhënat që nuk janë bërë të ditura apo nuk janë lehtësisht të kapshme në statistikat zyrtare (siç është numri i rasteve në të cilat dhunuesi ka përdorur armë zjarri për të kërcënuar apo sulmuar viktimën, ose numri i viktimave të lënduara apo të kërcënuara prej armëve të zjarrit që kanë kërkuar strehim). Kërkuesit pyetën gjithashtu rreth praktikave më të mira dhe më të këqija në drejtim të mbrojtjes së viktimave dhe parandalimit të dhunës në familje. Për më tepër, personave të intervistuar iu kërkua të jepnin opinionin e tyre mbi atë që duhet bërë për të përmirësuar legjislacionin e tanishëm dhe praktikën që kanë të bëjnë me uljen e përdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje.

Kërkimi kombëtar zbuloi se të dhënat ekzistuese dhe informacioni në vendet ku është kryer kërkimi mbi përdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje, janë mbledhur në sajë të përdorimit të metodologjive dhe shembujve të ndryshëm; ato lidhen me periudha të ndryshme dhe janë mbledhur në nivele të ndryshme, disa në nivelin kombëtar e disa të tjera në atë rajonal. Kështu, është e vështirë të bëhet një krahasim i tyre. Për këtë arsye, të dhënat që dalin prej burimeve kombëtare dhe kërkimi i kryer në secilin vend do të përdoret në raportin rajonal pa bërë përpjekje për krahasimin mes tyre.

Kërkimi në zyra dhe ai në terren ka përfshirë analizën e legjislacionit, politikave dhe praktikave që janë të pranishme në secilin vend dhe që ka të bëjë me dhunën në familje dhe rregullimin e AVL-ve, analizën dhe interpretimin e ligjeve nga aktoret që e kanë këtë përgjegjësi në shtete përkatëse si dhe OJQ-të e grave dhe identifikimi i strukturave shtetërore dhe atyre jo shtetërore ekzistuese. Kërkuesit kanë sugjeruar rekomandime për mënyrën se si secila qeveri mund të bëhet më e përgjegjshme dhe për problemin e dhunës së armatosur në familje dhe mundësive për strategji të OJQ-ve në të ardhmen në këtë fushe.

Ky raport rajonal është një studim krahasues i bazuar në gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e kërkuesve kombëtare si dhe në një rishikim që i është bërë praktikave më të mira ndërkombëtare.<sup>3</sup>

<sup>2</sup> Në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të datës 10 korrik, 1999, u krijua Misioni i Administrimit të përkohshëm të OKB-së në Kosovë, i cili qysh atëherë ka qenë autoriteti administrativ i Kosovës.

<sup>3</sup> Shiko Aneksin A – Rishikim i Praktikave më të mira botërore.



## 2 Armët e Zjarrit si një faktor rreziku për dhunën në familje në Ballkanin Perëndimor

### 2.1 Përhapja e armëve të zjarrit të zotëruara nga civilët

Zotërimi i armëve të zjarrit nga ana e civilëve në vendet e Ballkanit perëndimor ka qenë tradicionalisht shumë e lartë, për shkak të një traditave të rrënjësura kulturore dhe historike që lidhen me të pasurit e një pushke. Si pasojë e konflikteve të dhunshme në rajonin e ish-Jugosllavisë dhe trazirave qytetare në Shqipëri gjatë viteve 1990, u rrit në mënyrë dramatike numri i armëve të zjarrit të paligjshme në duart e qytetarëve. Situatat postkonfliktuale rrisin tensionet dhe problemet, falë një ambienti të paqëndrueshëm dhe të stresuar, të mbushur me papunësi, varfëri, rritje të diskriminimit të bazuar mbi përkatësinë etnike dhe gjinore dhe dhunimit të drejtave të njeriut. Një numër i madh i armëve që iu dhanë për përdorim nga autoritetet kombëtare civilëve dhe ish ushtarakëve me qëllim që të merrnin pjesë në konflikte nuk u kthyen pas luftës, duke mbetur shpesh në shtëpitë e qytetarëve si 'kujtime lufte'. Shumë nga këto armë u legalizuan dhe regjistruan më vonë nga pronarët e tyre.

Rritja e shpejtë e numrit të AVL-ve ndihmon dhe lehtëson dhunën, krimin dhe pasigurinë në gjithë rajonin. Autoritetet kombëtare, të mbështetura dhe nga organizatat ndërkombëtare (OKB, OSBE, BE) dhe marrëveshjet rajonale (Pakti i Stabilitetit për Evropën Jug-Lindore), kanë treguar gatishmërinë për të zhvilluar politika dhe për të marrë masa për të kontrolluar më mirë qarkullimin, përdorimin dhe tregtinë e AVL-ve.

Sot më shumë se një dekadë pas përfundimit të konflikteve të dhunshme, ka ende një numër shumë të lartë të armëve të zjarrit që mbahen në familje në mbarë rajonin. Një studim i kohëve të fundit për AVL-të në vendet Ballkanike<sup>4</sup> nxjerr të dhëna shqetësuese. Në këtë studim llogaritet se janë rreth 968,000 armë zjarri në duart e civilëve në Kroaci, duke përfshirë si ato të zotëruara legalisht ashtu dhe ilegalisht, në Serbi 2047,300; në Shqipëri 200,000; 175,000 në Mal të Zi dhe 400,000 në Kosovë.<sup>5</sup> Në Bosnjë dhe Hercegovinë ka rreth 353 armë zjarri të regjistruara tek civilët,<sup>6</sup> në IRJ të Maqedonisë numri është 140,000. Është shumë e vështirë të matet numri i armëve të paligjshme. Këto studime tregojnë që në Ballkanin Perëndimor me një popullsi prej 19.6 milion, ka gati 4,280,000 armë zjarri në duart e civilëve. Për shkak të vështirësive për të gjetur numrin e armëve në pronësi të paligjshme, ndoshta nuk është e ekzagjeruar të thuhet se çdo familje në rajon ka të paktën një armë zjarri.

Fatkeqësisht, shumica e statistikave të lidhura me çështjen e AVL-ve nuk janë të ndara sipas seksit. Sidoqoftë, statistikave dhe studimet ekzistuese tregojnë një dominim të numrit të burrave qofte si viktimave qofte si persona që kanë kryer krime dhe dhunime të armatosura me AVL. Shumica e pronarëve të AVL-ve janë burra. Në Ballkanin Perëndimor, burrat kryejnë 99 për qind të krimeve me armë zjarri dhe përbejnë 85 për qind të numrit të viktimave, ndërsa gratë përbejnë 15 për-qind të viktimave por vetëm një për qind e tyre janë shkaktare të krimin.<sup>7</sup> Përveç kësaj, burrat dhe gratë shpesh kanë një ndryshim në sjelljen kundrejt mbajtjes dhe përdorimit të armëve. 'Kultura e armëve' që mbizotëron në rajon është e lidhur me konceptet tradicionale patriarkale që e lidhin të qenit mashkull dhe të qenit burrë me rolin e mbrojtësit të familjes dhe pronës. Kështu, çështja e AVL-ve dhe si pasojë e dhunës së armatosur, është shumë e lidhur me çështjen gjinore pavarësisht nëse ndodh në sferën publike apo atë private.

### 2.2 Përhapja e dhunës në familje

Te dhëna që vijnë nga gjithë rajoni pranojnë se viktimat e dhunës në familje janë më së shumti gratë dhe se ata që ushtrojnë këtë dhunë janë më së shumti burrat. Studimet e kryera gjatë pesë viteve të fundit nga OJQ-të

<sup>4</sup> Studimet mbi AVL-të të kryera në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor mund të gjenden në: <http://seesac.org>.

<sup>5</sup> Këto të dhëna përfshijnë armët që civilët posedojnë në mënyrë të ligjshme dhe të paligjshme. Ato nuk përfshijnë të dhëna mbi armët e zotëruara nga oficerët e policisë apo të ushtrisë, ose zyrtarëve të tjerë të shtetit.

<sup>6</sup> Ky informacion është marrë nga Studimi i AVL-ve për Bosnjën dhe Hercegovinën, 2004, fq. 20-21. Sidoqoftë, për shkak se nuk ka ndonjë sistem regjistrimi të centralizuar të armëve të zjarrit në BH është e vështirë të njihet madje dhe sa armë zjarri ka në mënyrë të ligjshme në këtë vend, pa përmendur armët e paligjshme.

<sup>7</sup> Statistikat janë marrë nga 'Strategjia për çështjet Gjinore të SEESAC në Kontrollin e Aktivitetëve të AVL-ve', <http://www.seesac.org/resources>, qasja në këtë faqe është bërë më 30 qershor 2007.

vendore në republikat e ish-Jugosllavisë tregojnë se një e treta deri në dy të tretat e grave në Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë kanë përjetuar abuzime nga ana e partnereve.<sup>8</sup> Studimi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë ka treguar rezultate të ngjashme për dhunën intime mes partnereve në Serbi.<sup>9</sup> Përkatësisht, çdo një në katër gra që ka pasur ndonjëherë një partner ka përjetuar dhunë fizike apo seksuale. Rezultate të ngjashme janë gjetur në një kërkim në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Për shkak të metodologjive të ndryshme të aplikuar, është e vështirë për të krahasuar të dhënat mbizotëruese nga vendet e ndryshme. Sidoqoftë të dhënat që dalin nga kërkimet ekzistuese, të kryera kryesisht nga OJQ-të e grave sugjerojnë se dhuna në familje është një problem serioz dhe i përhapur përgjatë gjithë rajonit.<sup>10</sup>

Te dhënat nga OJQ-të e grave mbi nivelin e lartë të dhunës në familje mbështeten nga numri i ndërhyrjeve të policisë në rastet e dhunës në familje, ndërhyrje që janë rritur në mënyrë të vazhdueshme vit pas viti. Sipas të dhënave të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Kroacisë, gjatë vitit 2005 policia ndërhyri në 15,696 raste të dhunës në familje; një rritje prej gjashtë për-qind nga viti 2004. 31 për-qind më shumë qytetarë janë mbajtur nën mbikëqyrjen e policisë si masë për të mbrojtur viktimat; 20 për-qind më shumë dënime për shkelje të ligjit që kanë të bëjnë me dhunën në familje dhe 16 për-qind më shumë dënime për krimet e dhunës në familje. Në total dhuna në familje ka prekur 22,207 persona në vitin 2005, ose 14 për-qind më shumë sesa në vitin 2004. Në vitin 2005 policia i kërkoi Gjykatës së Lartë të lëshojë 4,916 masa parandaluese që lidheshin me dhunën në familje.<sup>11</sup>

Në të njëjtin vit në 'Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë' (IRJ e Maqedonisë),<sup>12</sup> Ministria e Brendshme regjistroi 215 raste krimi, 1.202 shkelje ligji dhe 3,750 ankime për dhunë në familje, ndërsa gjatë periudhës qershor 2005 – qershor 2006, qendrat e punës sociale regjistruan 839 raste të dhunës në familje. Dhuna në familje e shkaktuar kundër grave në IRJ të Maqedonisë përfaqësoi 18 të numrit total të rasteve të krimit të regjistruara në vitin 2005, 19 për-qind në vitin 2006 dhe 26 për-qind në gjysmën e parë të vitit 2007. Në Kosovë, sipas Sektorit të Shërbimit Investigativ për dhunën në Familje dhe Abuzimin e Fëmijëve, janë regjistruar 3,300 raste të raportuara të dhunës në familje në periudhën 2005 deri në qershor 2007. Numri më i lartë i rasteve u regjistrua në vitin 2006 (1,371), ndërkohë që rajoni më i prekur ishte Prishtina me 989 raste të raportuara.

Fatkeqësisht, dhuna në familje është edhe më e përhapur sesa ekziston në të dhënat e treguara. Statistikat dhe të dhënat përkatëse janë të fragmentuara, të mbledhura në mënyrë të dobët dhe jo të standardizuara, kjo është në vendet që kanë adoptuar legjislacion specifik në këtë fushë.<sup>13</sup> Për më tepër, eksperiencia e OJQ-ve dhe ekspertëve që po punojnë me këtë çështje tregon se pjesa më e madhe e rasteve nuk raportohet. Nuk ka shumë gjasa që viktimat të raportojnë dhunën në familje pas incidentit të parë; ato zakonisht raportojnë dhunën pas disa vitesh abuzimi. Është gjithashtu e mundur që një viktimitë e dhunës së armatosur në familje nuk e raporton përdorimin e armëve të zjarrit që është përdorur për ta kërcënuar atë nga frika se arma nuk do të konfiskohet dhe do të përdoren mbi të përsëri. Për këtë arsye shumë raste të dhunës në familje nuk gjejnë pasqyrim në të dhënat. Përafërime që mund të jepen për 'numrat e errët' (rastet e pa-raportuara) variojnë nga një në tre në një në dhjetë (p.sh. Për çdo rast të raportuar nga dhjetë raste të pa-raportuara).<sup>14</sup>

<sup>8</sup> 'OJQ-të në Republikat Ish-Jugosllave Fokusohen në Edukimin e të Rinjve drejt Ndryshimit të Kulturës së Periudhës së Pasluftës që ka të bëjë me Dhunën- 9 qershor 2007, [http://www.stopvaw.org/NGOs\\_in\\_the\\_Former\\_Yugoslav\\_Republics\\_Focus\\_on\\_Education\\_Youth\\_to\\_Change\\_Post-War\\_Culture\\_of\\_Violence.html](http://www.stopvaw.org/NGOs_in_the_Former_Yugoslav_Republics_Focus_on_Education_Youth_to_Change_Post-War_Culture_of_Violence.html).

<sup>9</sup> Organizata Botërore e Shëndetësisë, 'Studim në shumë vende i OBSH-së mbi Shëndetin e Grave dhe dhunën në Familje kundër Grave: Fakte nga Serbia dhe Mali i Zi, 2005, [http://www.who.int/gender/violence/who\\_multicountry\\_study/fact\\_sheet/SerbiaandMontenegro.pdf](http://www.who.int/gender/violence/who_multicountry_study/fact_sheet/SerbiaandMontenegro.pdf), qasja në këtë faqe është bërë më 21 shtator 2007.

<sup>10</sup> Nukolic-Ristanovic, Vesna dhe Dokmanovic, Mirjana, Standarted Ndërkombëtare mbi dhunën në Familje dhe Zbatimi i tyre në Ballkanin Perëndimor, Beograd: Prometej, 2006. fq. 21-24.

<sup>11</sup> Burimi: Këshilli i Evropës, Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut, 'Legjislacioni i Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës në fushën e dhunës kundër Grave', Janar 2007, [http://ëëë.coe.int/t/e/human\\_rights/equality](http://ëëë.coe.int/t/e/human_rights/equality), qasja në këtë faqe është bërë më 1 tetor 2007.

<sup>12</sup> Për shkak të mosmarrëveshjeve që lidhen me emrin mes këtij vendi dhe Greqisë, OKB-ja i referohet këtij vendi si 'Ish republika Jugosllave e Maqedonisë'. Për qëllime të këtij raporti termi 'IRJ e Maqedonisë' do të përdoret gjatë gjithë tekstit.

<sup>13</sup> Për shembull, në vërejtjet përmblyëse në Raportin për Bosnjën dhe Hercegovinën Komiteti i CEDAW-ut shpreh shqetësimet e tij rreth 'mungesës së të dhënave statistikore mbi aktet e dhunës në familje kundër grave dhe sw akte të këtitilla vazhdojnë të jenë të mosraportuara dhe shihen si çështje private', 'Komente Përmblyëse të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave: Bosnja dhe Hercegovina, sesioni i 35të, 15 maj 2006', CEDAW/C/BIH/CO3, paragraf. 25.

<sup>14</sup> 'Studim mbi dhunën në Familje në Bosnjë dhe Hercegovinë – Pasazhe', Banja Luka: 'Asambleja Banja Luka e Qytetarëve të Helsinkit, Organizata e Grave 'Lara', Bijeljina dhe Shoqata 'Gruaja për Gruan', Sarajevë, maj 2006, fq. 11 – 12.

Shumë faktorë kontribuojnë në ngritjen e dhunës në familje në një situatë postkonfliktuale, duke përfshirë faktorët social-ekonomikë që janë të lidhura me tranzicionin dhe luftën e kohëve të fundit,<sup>15</sup> si për shembull rritja e pasigurisë ekonomike dhe personale, të qenit i pafuqishëm para varfërisë, papunësia, krimi, dhuna dhe mostoleranca. Shqetësimet politike, sociale dhe ekonomike, konfliktet e armatosura, spastrimet etnike, migracioni i popullsisë rurale dhe numri i madh i refugjatëve dhe personave të zhvendosur kanë ndihmuar në destabilizimin e familjes dhe kanë shkaktuar rritjen e nivelit të stresit shoqëror. Pasojat e luftës në rajonin e ish Jugosllavisë janë ende të dukshme, duke ndihmuar kështu në përhapjen e të gjitha formave të dhunës. shumë njerëz veçanërisht ish-ushtarë dhe viktimë të luftës, ende vuajnë nga çrregullimet e stresit post-traumatik. Të gjithë këto faktorë kanë një ndikim të fortë mbi statusin social të burrave dhe njëkohësisht mbi maskilizmin e tyre, duke tronditur identitetin dhe vetëbesimin e tyre. Në shumë raste rezultatet e kësaj traume masive shkrehen në familje gjë që çon në përkeqësimin e marrëdhënieve familjare dhe martesore dhe në rritjen e rasteve të dhunës në familje.

Dhuna në familje është forma më e përhapur e dhunës dhe diskriminimit të grave. Komuniteti ndërkombëtar, dike përfshirë këtu dhe shumicën e Organizatave Ndërkombëtare (si p.sh OKB), e konsiderojnë dhunën në familje si dhunim të të drejtave njerëzore të grave dhe e ndalojnë atë nëpërmjet traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.<sup>16</sup> Dhuna në familje në vendet e Ballkanit Perëndimor, si një formë e dhunës e lidhur me diskriminimin e bazuar mbi gjininë, është nxitur nga rritje e përgjithshme e mostolerances dhe diskriminimit të grupeve të minoriteteve dhe atyre të marginalizuara në të gjitha pjesët e rajonit. Dhuna e bazuar mbi gjininë është provokuar nga një rinovim i traditës së rolit të gjinive në shoqëri dhe familje, nga rritja e ndikimit të kishës dhe traditës si dhe ringjalljes së vlerave patriarkale. Gjithë këto faktorë kanë ndikuar në rritjen e vulnerabilitetit të grave dhe fëmijëve përkundrejt dhunës së të gjitha llojeve.

### 2.3 Ndikimi i armëve të vogla në dhunën në familje

Pavarësisht faktit të dukshëm se çështja e AVL-ve është në mënyrë të natyrshme e lidhur me çështjen gjinore, siç u vu re dhe më lart, kjo lidhje nuk është eksploruar në mënyrë të mjaftueshme duke pasur në mend dhunën në familje. Statistikat zyrtare mbi dhunën e armatosur në familje, duke përfshirë lëndimet nga armët e zjarrit në vendet e rajonit, nuk janë gjerësisht të prekshme si dhe ka mungesa në kuadrin e kërkimeve që kanë lidhje me këtë çështje.

Kërkimi i vetëm specifik mbi ndikimin e AVL-ve mbi dhunën e bazuar mbi heshtjet gjinore që përfshin çështjen e dhunës në familje u krye në Mal të Zi.<sup>17</sup> të dhëna të marra nga Drejtoria e Policisë në Podgorice tregojnë se 49 gra ishin viktimë të sulmeve kriminale kundër jetës dhe integritetit fizik, në vitin 2006, 14 për-qind e të cilave ishin viktimë të dhunës që përfshin armë zjarri. Rezultati i studimit që përfshiu 1,500 gra që kërkuan dhunë nga strehimoret e grave tregoi se 90 për-qind e viktimave ishin kërcënuar me armë zjarri nga partneret e tyre dhe 27 për-qind e viktimave tha se dhunuesi kishte marrë pjesë në luftë.

Vlerësime të tilla të ngjashme u mbi përhapjen dhunës së armatosur në familje u dhanë nga strehimoret në Bosnjë dhe Hercegovinë. Strehimorja në Modrica ka të dhëna të përftuesve të shërbimeve të saj që përfshin raste të kërcënimeve dhe sulmeve me armë zjarri. 70 për-qind e 206 viktimave të dhunës në familje në vitin 2006 që kërkuan ndihmë ishin kërcënuar me vrasjen duke përfshirë dhe armët e zjarrit. Në gjysmën e parë të vitit 2007 74 për-qind e 127 viktimave të dhunës në familje kanë përjetuar dhunë të armatosur familjare. Fatkeqësisht, shumica e strehimoreve nuk mbajnë statistika mbi këtë çështje. Pavarësisht nga të dhënat e marra nga strehimoret e drejtuara nga OJQ-të e grave, qendrat e punës sociale dhe institucione të tjera shtetërore në Bosnjë dhe Hercegovinë injorojnë në shkallë të larte çështjen e dhunës së armatosur në familje.<sup>18</sup> Ato nuk mbajnë

<sup>15</sup> Popa, Raluca Maria, Duke i dhënë fund dhunës në Familje në Evropën Juglindore dhe në Turqi: Drejt një Strategjie Rajonale për Veprim, Bratislava: UNIFEM CĚĚ, 10 korrik 2007, fq. 45.

<sup>16</sup> 'Dhuna kundër Grave në Familje', Raport i Raportueses Speciale mbi dhunën kundër grave, shkaqeve dhe pasojave të saj, Radhika Coomaraswamy, i përpiluar në bazë të Rezolutës 1995/85, E/CN.4/1999/68 të Komisionit të të Drejtave të Njeriut me 10 mars 1999. Rekomandimi i Përgjithshëm 19 i Komitetit të CEDAW, thekson së përkufizimi i diskriminimit në CĚDAĚ 'përfshin akte që shkaktojnë dëmtime apo vuajtje fizike, mentale apo seksuale, kërcënimet nga akte të tilla, shtypja apo privime të tjera të lirisë', U.N.DocA/47/38 (1992).

<sup>17</sup> Krkeljic, Ljiljana, Armët e vogla dhe dhuna e bazuar mbi çështjet gjinore në Mal të Zi - një Studim Kërkimor, Podgorice, UNDP, 2007.

<sup>18</sup> Për shembull në Qendrën për Punë Sociale në Sarajevën Lindore, sipas menaxheres së saj, incidentet e dhunës në familje janë shumë të rralla ndërsa rastet e armëve të zjarrit madje nuk ekzistojnë. Në dy vitet e fundit, janë raportuar vetëm dy raste të dhunës në familje. Puna kryesore e qendrës përqendrohet kryesisht në mbarëvajtjen dhe ruajtjen e martesave.

të dhëna mbi përdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje dhe punonjësit sociale nuk janë madje as të detyruar të pyesin viktimat nëse ato janë kërcënuar nga përdorimi i armëve të zjarrit apo të llojeve të tjera.

Në Mal të Zi, gjatë periudhës 2002 deri më 2007, 1,223 gra u drejtuan linjës SOS në Podgorice për të kërkuar mbrojtje nga dhunuesit brenda familjes apo lidhjeve intime. Nga ky numër, 190 gra u kërcënuar më vrasje, nëntë për-qind e të cilave u kërcënuar nga armët e zjarrit. Lobi i grave të Malit të Zi, regjistroi se gjatë periudhës pesëvjeçare 2001 – 2006, 30 për-qind e numrit prej 637 viktimave të dhunës në familje u kërcënuar më vrasje. Kjo OJQ gjithashtu ka marrë të dhëna nga lajmërimet e mediave dhe ve re së gjatë të njëjtës periudhë (2001 – 2006) 12 gra u vranë nga armët e zjarrit të përdorura nga pjesëtarët e familjes apo nga partnerët e tyre.

Te dhëna zyrtare të mbledhura në kërkimin kombëtar në Kroaci tregojnë se armët e vogla u përdoren vetëm në një për-qindje të vogël të rasteve të dhunës në familje, ndërsa thikat përbejnë mjetin që përdoret më shpesh. Statistikat e policisë në Kroaci tregojnë së 27 për-qind e vrasjeve dhe 11 për-qind e vrasjeve të mbetura në tentative në vitin 2006 u kryen brenda familjes apo marrëdhënieve të intime. Në numrin më të lartë të rasteve (40 për-qind) dhunues ishte bashkëshorti. Në më të shumtën e rasteve ishin përdorur armë të ftohta dhe shumë rrallë armë zjarri. Gjykatësit e intervistuar shprehën opinionin e tyre se nuk ekziston një marrëdhënie e fortë mes mbajtjes së armëve të zjarrit (qofte në mënyrë ligjore qofte jo) dhe përdorimit të tyre nga dhunuesit në dhunën në familje. Sidoqoftë kjo mund të vije si mungese e kuptimit të natyrës së dhunës në familje nga ana e tyre. Për sa i përket numrave të ulet të raportuar, OJQ-të e grave që merren më viktimat e dhunës në familje dhe asaj seksuale mësojnë së ky numër është shumë më i ulet sesa gjendja reale, pasi përdorimi i armëve të zjarrit redukton mundësinë e viktimave për të raportuar këto incidente për shkak të frikës së arma e zjarrit nuk do të konfiskohet prej dhunuesve dhe së do të përdoret përsëri.

Një studim i kryer nga Victimology Society i Serbisë në vitin 2001 përfshiu një seksion të veçantë të ndikimit të armëve të vogla në dhunën në familje.<sup>19</sup> Ata gjeten së shtatë për-qind e grave që kanë përjetuar dhunën në familje janë sulmuar apo kërcënuar më armë zjarri apo të tjera mjete apo armë të rrezikshme. Në 27 për-qind të rasteve të regjistruara sulmet fizike më ose pa armë të rrezikshme u përsëriten në më shumë së pesë herë. Forma më e përhapur e dhunës së armatosur është ajo e përdorimit të armës së ftohte, sidomos thikës (34 raste), ndërsa armët e zjarrit u përdoren në 11 raste, shumica për të kërcënuar një anëtar femër të familjes. Sipas analizës së shtypit të drejtuar nga OJQ-të e grave në Serbi për qëllime të fushatës kombëtare avokuese kundër dhunës në familje në 2003, të titulluar 'Pse Ata nuk Janë më NE', 31 gra u vranë gjatë një viti nga burrat apo partneret e tyre, ndërsa 60 për-qind e të gjitha vrasjeve u kryen kundër një anëtari të familjes.

Kërkimi nga Kosova tregon një nivel të lartë të dhunës familjare të armatosur. Personat e intervistuar nga Qendra për Mirëqenien e Grave të Pejës, treguan së dhuna në familje është shumë e lidhur më mbajtjen e armëve të zjarrit nga ana e dhunuesve dhe njëkohësisht ata besojnë se niveli i zotërimit të armëve të zjarrit në Kosovë është shumë i lartë, ndërsa numri i konfiskimeve nga ana e policisë shumë i ulet. Në gjysmën e parë të vitit 2007, kjo OJQ regjistroi 33 raste të dhunës në familje, duke përfshirë katër raste të dhunës seksuale. Në 17 nga këto raste, viktimat u kërcënuar më armë zjarri ndërsa në katër raste viktimat femra ishin lënduar nga armët e zjarrit. Liria, një nga punonjëset e OJQ-se, raportoi së viktimat e dhunës në familje nga Gjilani që kishin kërkuar mbështetje, deklaruan së dhunuesit mbanin armë zjarri në më të shumtën e rasteve, por këto armë nuk ishin konfiskuar nga policia.

Te dhënat e përdorimit të armëve të zjarrit në rastet e dhunës në familje nuk janë të regjistruara ashtu si duhet nga asnjë nga institucionet që merren më dhunuesit dhe viktimat e dhunës në familje. Për këtë arsye, të dhënat ekzistuese nuk mund të merren parasysh si tregues të besueshëm të përdorimit të armëve të zjarrit në rastet e dhunës në familje. Mund të mendohet së ato tregojnë vetëm majën e ajërbergut. Praktika e mbajtjes së të dhënave nga këto raste sapo ka filluar të zhvillohet. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të rasteve të pa raportuara të dhunës në familje, mund të thuhet realisht së rastet e përdorimit të armëve të zjarrit nga një dhunues për të kërcënuar dhe bërë presion tek anëtarët e tjerë të familjes është shumë herë më i lartë se sa tregohet nga të dhënat zyrtare. Ashtu si tregon dhe kërkimi i bërë nga OJQ-të e grave mbi përhapjen e dhunës në familje në të gjitha vendet ku ai është kryer, ka pak gjasa që gratë të raportojnë dhunuesit sidomos në rastet kur ato janë të frikësuara dhe kanë jetën e tyre nën kërcënimin e armëve të rrezikshme apo atyre të zjarrit.

<sup>19</sup> Vidakovic, Ivana, 'Rasprostranjenost nasilja u porodici' ('Përhapja e dhunës Brenda familjes'), Porodico nasilje u Srbiji (Dhuna në Familje në Serbi), ed. Vesna Nukolic-Ristanovic, Beograd: Victimology Society of Serbia & Prometej, 2002. fq. 49-59. Studimi u krye duke marrë për bazë një kampion prej 700 grash mbi moshën 18 vjeç në gjashtë qytete në Serbi, 74.4% e të cilave jetojnë në zona urbane dhe 25.6% në ato rurale.

## 3 Qasja e qeverive kombëtare në luftën kundër dhunës në familje

### 3.1 Legjislacioni dhe parashikimet ligjore që lidhen me dhunën në familje

Gjatë dhjetë-vjeçarit të fundit, të gjitha qeveritë në vendet e Ballkanit Perëndimor kanë bërë përparime të dukshme në penalizimin e dhunës në familje dhe në futjen e masave ligjore për të mbështetur viktimat. Ky përparim vjen si rezultat i harmonizimit të legjislacionit kombëtar me standardet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut si dhe gjithashtu fushatave avokuese të OJQ-ve të grave. Vendet që janë pjesë e kërimit janë anëtarë të të gjitha traktateve kryesore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë dhe Konventën mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW)<sup>20</sup> dhe Protokollit të saj Shtesë. Duke pasur parasysh se vendet, me përjashtim të Bosnjës dhe Hercegovinës,<sup>21</sup> kanë një qasje njësoje ndaj ligjit ndërkombëtar, traktatet ndërkombëtare të ratifikuara bëhen pjesë e legjislacionit kombëtar dhe mund të aplikohen direkt. Kjo do të thotë se Shtetet janë të detyruara të pajtohen me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që lidhen me luftimin e dhunës në familje.

Ky detyrim ngrihet prej faktit se dhuna në familje njihet si një dhunim i të drejtave të njeriut dhe si një prej formave më të përhapura të dhunës dhe diskriminimit kundër grave.<sup>22</sup> Dokumentet e të drejtave ndërkombëtare të njeriut ndalojnë çdo dhunë në familje si dhunim i të drejtave dhe lirive bazë të njeriut ashtu siç janë garantuar nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, duke përfshirë dhe të drejtën e jetës, lirisë dhe sigurisë personale, të drejtën për të qenë i barabartë dhe i lirë nga çdo formë torture dhe trajtimi mizor apo përbuzës.<sup>23</sup> Përveç kësaj, të gjitha Shtetet janë Anëtare të Këshillit të Evropës dhe kanë nënshkruar Kartën Evropiane mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (ECHR). Këshilli i Evropës ka një listë mahnitëse të dokumenteve dhe direktivave politike që vendosin standardet dhe detyrime për Shtetet Anëtare në fushën e luftimit të dhunës në familje. Si Shtete Anëtare të OKB-së dhe Këshillit të Evropës, qeveritë janë të detyruara të zbatojnë dokumentet e tyre të të drejtave të njeriut me përpikëri dhe mirëbesim.

Te gjitha vendet në rajon kanë integruar të drejtat bazë të njeriut në parashikimet e tyre kushtetore, duke garantuar kështu se gratë, burrat, vajzat dhe djemtë do të gëzojnë mes të tjerave mbrojtje të barabartë prej dhunës në familje nga ana e Shtetit. Kushtetutat Kombëtare garantojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore si të patjetërsueshme dhe të pashmangshme. Është garantuar barazia para ligjit për të gjithë qytetarët, ndërkohë që është ndaluar si diskriminimi me bazë seksin, ashtu dhe tortura dhe trajtimi çnjerëzor dhe mizor.

Në përgjithësi kornizat ligjore që mbështesin aktivitetet dhe masat kundër dhunës në familje përfshijnë përveç parashikimeve kushtetuese, ligje specifike kundër dhunës në familje, Ligji mbi Barazinë Gjinore,<sup>24</sup> Kodi Penal, Kodi Familjar dhe Ligji mbi Rendin Publik.

<sup>20</sup> Konventën mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, <http://www.un.org/womenwatch/daw/CEDAW/>, qasja në këtë faqe është bërë me 10 tetor 2007.

<sup>21</sup> Bosnja dhe Hercegovina është një shtet kompleks korniza kushtetuese ligjore dhe politike e së cilit është vendosur nga Akordi i Paqes së Dejtonit (1995). Ajo ka të bëjë me dy entitete (Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republika Srpska) dhe një distrikti autonom (Distrikti i Brçkos), i cili ka një sistem të ndryshëm ligjor, përveç sistemit të përbashkët ligjor të Federatës. Shteti federal është i decentralizuar dhe ka disa nivele të autoritetit: lokal, kantonal, niveli i Distriktit të Brçkos, niveli i entitetit dhe niveli Shtetëror. Sipas kushtetutes së Bosnjës dhe Hercegovinës (Neni 2), Shteti zbaton në mënyrë direkte të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara nga Karta Evropiane mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (ECHR) dhe Protokolleve të saj, të cilat kanë përparesi mbi ligjet kombëtare. Përveç kësaj, Shteti dhe entitetet e tij duhet të sigurojnë zbatimin e të gjitha të drejtave dhe lirive të njeriut të njohura nga traktatet kryesore ndërkombëtare (duke përfshirë CEDAW), pa diskriminuar për të gjithë qytetarët (Akordi i Paqes i Dejtonit, Aneksi 6).

Kushtetuta e Republikës së Malit të Zi nuk ka ndonjë parashikim rreth mardhenieve mes logjit kombëtar dhe atij nderkombëtar. Sidoqoftë në Neni 44 i garanton qytetareve të drejtën për t'iu drejtuar institucioneve ndërkombëtare në mënyrë që të mbrojnë të drejtat e tyre kushtetuese. Drafti i Kushtetutes së Re parashikon përparesi të ligjit nderkombëtar.

<sup>22</sup> 'Dhuna kundër Grave në Familje', Raport i Raportueses Speciale mbi dhunën kundër grave, shkaqeve dhe pasojave të saj, Radhika Coomaraséamy, i përpiluar në bazë të Rezolutës 1995/85, E/CN.4/1999/68 të Komisionit të të Drejtave të Njeriut me 10 mars 1999.

<sup>23</sup> Analiza e rolit të ligjit ndërkombëtar në luftën kundër dhunës në familje dhe lista e normave ndërkombëtare në këtë fushë mund të gjendet në: Nukolic-Ristanovic, Vesna dhe Dokmanovic, Mirjana, Standardet Ndërkombëtare mbi dhunën në Familje dhe Zbatimin e tyre në Ballkanin Perëndimor, Beograd: Prometej, 2006. fq. 33-71 dhe fq. 153-175.

<sup>24</sup> Ligjet mbi Barazinë Gjinore ekzistojnë në Bosnjë dhe Hercegovinë (2003), Kroaci (2003), Shqipëri (2004) dhe Kosovë (2004). Në Serbi, Ligji Kundër Diskriminimit dhe Ligji mbi Barazinë Gjinore janë ende në procesin e draftimit.



Ligi i barazisë gjinore në Bosnjë dhe Hercegovinë ndalon të gjitha format e dhunës së bazuar mbi gjininë si në sferën publike dhe në atë private dhe përshkruan ndëshkime me burg nga gjashtë muaj deri në pesë vjet për akte të këtitilla. Kjo formë parashikimi nuk ekziston në Ligjin për Barazinë Gjinore në Shqipëri, Kroaci dhe Kosovë. Ligje specifike që i drejtohen dhunës në familje janë miratuar në Shqipëri (2006), Kroaci (2003) dhe në dy entitetet e Bosnjës dhe Hercegovinës (Federatën e Bosnjë Hercegovinës (2005) dhe në Republika Srpska(2005)). Ato merren me konceptin e dhunës në familje, personat që konsiderohen si anëtarë të familjes dhe format e mbrojtjes për anëtarët e familjes. Koncepti bazë për këto ligje është mbrojtja e viktimave duke hequr dhunuesin nga vendi ku qëndron viktima dhe duke urdhëruar trajtime të detyrueshme psikosociale apo të varësisë sipas rastit për dhunuesit.

Parashikime ligjore të veçanta kanë krijuar gjithashtu në Kosovë nën Rregulloren e UNMIK-ut 2003/12 mbi Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje. Një ligji i veçantë mbi Parandalimin e Dhunës në Familje u draftua në Mal të Zi por që nuk është adoptuar ende. Të gjithë vendet e kërkimit, duke përfshirë dhe ato që kanë ligje të veçanta për dhunën në familje, sigurojnë parashikime ligjore që i drejtohen dhunës në familje në Kodet penale dhe ato të Familjes. Në rastet e veçanta të dhunës në familje gjykatat mund të zbatojnë gjithashtu Ligjin mbi Rëndin.

Zbatimi i ligjit kundër dhunës në familje është i ndarë nga legjislacioni që synon dënimin e krimit. Ligje specifike sigurojnë mbrojtje dhe urdhra përjashtimore, dhe e trajtojnë dhunën në familje si shkelje të ligjit. Sanksionet zakonisht përfshijnë gjoba dhe burgime afat-shkurtra të dhunuesve (Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë). Ligjet pasojnë konceptin e mbrojtjes së menjëhershme të viktimave prej dhunës së mëtejshme duke siguruar largimin fizik të dhunuesit nga viktima. Ky legjislacion i lejon viktimat të fillojnë procedurat e shkeljes ligjore prej vete atyre. Ligjet specifike nuk përfshijnë dënime për krimin dhe nuk u sigurojnë shërbime mbështetëse si për shembull strehimore.

Dhuna në familje u bë ligj specifik në Kroaci, Mal të Zi dhe Serbi si dhe në të dyja entitetet e Bosnjë Hercegovinës dhe në Distriktin e Brçkos. Në të gjitha vendet dënohet *ex officio*. Në Shqipëri dhe Kosovë, dhuna në familje nuk gjykohet si një akt specifik kriminal por si një krim i përgjithshëm sulmi fizik, dhunim fizik apo përdhunim. Në IRJ të Maqedonisë, dhuna në familje gjykohet brenda një numri veprash penale në kodin penal, që u amendua në vitin 2004: vrasje, 'vrasje në gjaknxehtësi', dhunim fizik, forcim, heqje e paligjshme e lirisë, vënia në rrezik e sigurisë së një tjetri apo lehtësimi i prostitucionit dhe ngacmimet seksuale ndaj fëmijëve. Kodi Penal siguron përkufizimin e dhunës në familje dhe jep forma më të rënda ndëshkimore nëse këto akte janë kryer kundër një anëtar të familjes (p.sh për vrasje dhe lëndime të rënda trupore).

Sanksionet e vëna janë gjoba dhe burgime.<sup>25</sup> Dënimet me burg variojnë nga vendi në vend: deri në një vit në Distriktin e Brçkos, Mal të Zi dhe Serbi; deri në dy vjet në Republika Srpska dhe deri në tre vjet në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe në Kroaci. Ka gjithashtu dhe sanksione më të ashpra për format më të rënda të dhunës në familje. Kodi Penal i Serbisë (neni 194.2) dhe i Malit të Zi (Neni 220) parashikojnë sanksione më të ashpra nëse përdoret ndonjë armë e rrezikshme: deri në tre vjet burg. Në IRJ të Maqedonisë, nëse arma e zjarrit përdoret në mënyrë të përsëritur për të kërcënuar apo trembur, përdorimi i saj mund të konsiderohet si një rrethanë rënduese në dënimin e rasteve të dhunës në familje, por nuk shkakton dhënien e dënimeve më të ashpra. Në të dy entitetet e Bosnjës dhe në Distriktin e Brçkos ligji parashikon dënime të larta për dhunën e armatosur në familje vetëm në rastet kur viktima pëson lëndime të rënda trupore, ose kur lëndimet shkaktojnë dëmtim të shëndetit apo rezultojnë me vdekje.

Disa Shtete kanë dështuar në rishikimin dhe/ose ngritjen e sanksioneve në ndryshimet e fundit legjislative. Për shembull në vend të ngrinin sanksionet për dhunë në familje, në Serbi kohët e fundit i kanë ulur ato në dënimet e parashikuara nga kodi penal në 2005 (nga një maksimum prej tre vjetësh burg në një vit).<sup>26</sup>

Aplikimi i legjislacionit mbi dhunën në familje në Bosnjë dhe Hercegovinë është penguar nga mungesa e harmonizimit të parashikimeve të ndryshme ligjore që aplikohen në Republika Srpska dhe në Federatën e Bosnjës

<sup>25</sup> Sidoqoftë në Serbi, në praktikë, dënimet e kushtëzuara janë më të shpeshtat në rastet e gjykimeve. Burimi: Këshilli i Evropës, 'Legjislacioni i Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës në fushën e Dhunës kundër Grave', Janar 2007, [http://ëëë.coe.int/t/e/human\\_rights/equality](http://ëëë.coe.int/t/e/human_rights/equality), qasja është bërë më 1 tetor 2007.

<sup>26</sup> Komiteti i CEDAW ka shprehur shqetësime e tij rreth uljes së dënimeve për dhunën në familje. Komentet Përmblyëse të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave: Serbi, sesioni 35<sup>te</sup>. 14 maj – 1 qershor 2007, CEDAW/C/SCG/CO/1, parag. 21.

dhe Hercegovinës.<sup>27</sup> Ekziston një ambiguitet ligjor në përkufizimin e rasteve kur flitet për parashikimin e dhunës në familje si krim (Aplikimi i Kodit Penal) dhe rasteve kur ajo duhet të konsiderohet si akt i një kundërvajtje të vogël ligjore (Aplikimi i ligjit specifik mbi dhunën në Familje). Gjykatat zakonisht i dënojnë dhunuesit për krime të vogla, duke u dhënë atyre dënime më të lehta si për shembull gjoba. Për t'iu përgjigjur kësaj situatë, Komiteti i KB për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (CESC) rekomandoi Shtetin e Bosnjës dhe Hercegovinës 'të sigurojë harmonizimin e parashikimeve të kodit penal të Entiteteve dhe Distriktit të Brçkos mbi krimin e dhunës në familje më Ligjin Shtetëror mbi Barazinë Gjinore, si dhe aplikimin e tyre nga gjykatësit, prokurorët dhe policia' dhe 'të marrë masa që të sensibilizojë zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe publikun e gjerë për shkaqet dhe natyrën kriminale të akteve të dhunës në familje, si dhe për nevojat specifike të viktimave'.<sup>28</sup> Komiteti i CEDAW formuloi një rekomandim të ngjashëm, duke i bërë thirrje Shtetit 'të harmonizojë ligjet e të dy entiteteve dhe të përshpejtojë formulimin dhe adoptimin e rregulloreve dhe vendosjen e strukturave përkatëse dhe institucioneve të nevojshme për zbatim'.<sup>29</sup>

### 3.2 Masat për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje dhe dhunës së armatosur në familje

Vendet që janë marrë nën vëzhgim janë relativisht homogjene duke pasur parasysh strukturave të institucionalizuara të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje shumica e të cilave janë gra. Struktura rajonale e shërbimeve të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje përfshijnë strehimoret, linjat telefonike, ndihmën këshillimore dhe ligjore falas, shumica e të cilave sigurohen nga OJQ-të e grave. Të gjitha vendet kanë futur masa ligjore mbrojtëse që synojnë mbrojtjen e viktimave gjatë gjykimeve kriminale dhe ndërsa janë vendosur urdhra shtrënguese. Sidoqoftë analiza e praktikave dëshmon një boshllëk të madh mes situatave *de jure* dhe *de facto*.

#### Parashikimi i shërbimeve

Kërkimi kombëtar tregon se gratë zakonisht fillojnë të kërkojnë ndihmë pasi janë ekspozuar kundrejt dhunës për vite me radhë dhe pasi kanë marrë lëndime serioze fizike.<sup>30</sup> Strehimoret, linjat telefonike SOS dhe këshillimi për personat e viktimizuar ekziston në çdo vend, por numri i tyre është i pamjaftueshëm për të përballuar nevojat e viktimave.<sup>31</sup> Në Kroaci ka dhjetë strehimore dhe 24 linja telefonike, në Serbi ka nëntë strehimore dhe 39 linja telefonike, në Bosnjë dhe Hercegovinë ka shtatë strehimore dhe në Mal të Zi ka dy shtëpi të mbrojtura. Në Kosovë dhe në IRJ të Maqedonisë ka qendra të ndërhyrjes së krizave. Shtëpitë e mbrojtura nuk janë gjithmonë të lehta për tu përdorur për sa i përket shpërndarjes gjeografike, dhe janë më shumë të përhapura në zonat urbane. Strehimoret dhe shërbimet e këshillimit janë më së shumti të drejtuara nga OJQ-të e grave dhe në shumicën e rasteve të financuara nga donatorët ndërkombëtarë. Shtetet ndërhyjnë pjesërisht në mbështetjen e strehimoreve por pa pasur një strategji sistematike. Strehimoret e drejtuara nga qeveria janë të pranishme në IRJ të Maqedonisë (gjashtë) dhe në Shqipëri (një).

Linjat telefonike të ndihmës që sigurojnë asistencë psikologjike dhe ligjore janë më së shumti të drejtuara nga OJQ-të e grave. Një numër linjash në Serbi drejtohen nga qendrat e Punës sociale. Nuk ekzistojnë programet rehabilituese për gratë dhe fëmijët apo dhe mundësia për të përdorur shërbime të specializuara Përveç atyre që janë përgjithësisht në funksionim.

<sup>27</sup> Popa, Raluca Maria, Duke i dhënë fund dhunës në Evropën Juglindore dhe Turqi: Drejt një Strategjie Rajonale të Veprimit, Bratislaë: UNIFEM CEE, 10 qershor 2007, p. 12.

<sup>28</sup> E/C.12/BIH/CO/1. Vëzhgime Përmblyëse të Komitetit të KB mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore', paragrafi 43.

<sup>29</sup> Komentet Përmblyëse të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave: Bosnja dhe Hercegovina, sesioni 35<sup>te</sup>, 15 maj – 2 qershor 2006, CEDAW/C/BIH/CO3.

<sup>30</sup> Kërkimi në Bosnjë dhe Hercegovinë gjeti se viktimat zakonisht mendojnë se askush nuk do të besojë se ato janë abuzuar nëse ato janë rrahur 'pak'.

<sup>31</sup> Pas marrjes në konsideratë të raporteve periodike nga Kroacia, Komiteti i CEDAW shprehu shqetësimet 'rreth numrit të lartë të dhunës në familje, numrit të kufizuar të strehimoreve në dispozicion të grave viktimave të dhunës në familje dhe mungesës së procedurave të qarta ose procedurave të zbatimit të ligjit dhe personelit të kujdesit shëndetësor që kanë të bëjnë me rastet e dhunës në familje'. Komiteti i CEDAW nxit Shtetin të sigurojë se ka një numër të mjaftueshëm të strehimoreve në dispozicion të grave viktimave të dhunës në familje, 'Komentet Përmblyëse të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave' Kroaci, sesioni i 32<sup>te</sup>, 10 – 28 janar 2005', CEDAW/C/CRO/CC/2-3, para.31 – 32. Rekomandime të ngjashme iu dhanë dhe Serbisë, 'Komentet Përmblyëse të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave' Serbi, sesioni i 35<sup>te</sup>, 14 maj – 1 qershor 2007', CEDAW/C/SCG/CO/1, paragrafi 22.



Në vitet e fundit, autoritetet kombëtare kanë filluar të rrisin përfshirjen e tyre në shërbimet sociale që synojnë në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Në këtë këndvështrim, shumica e përparimeve është e dukshme në IRJ të Maqedonisë. Në nivelin kombëtar, Ministria e Punës dhe Politikave Sociale ka mandatin të vendosë dhe koordinojë shërbime mbrojtëse për viktimat e dhunës në familje si dhe për të propozuar masa të përkohshme ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen. Në nivel vendor, të 27 qendrat e Punës sociale janë përgjegjëse për të punuar më rastet e dhunës në familje. Nga ato pritet të sigurojnë mbrojtje nëpërmjet dhënies së shërbimeve dhe kërkesës që ato i bëjnë gjykatave për të lëshuar masa të përkohshme për mbrojtjen. Ministria e Punës dhe e Politikave Sociale jep fonde për të mbështetur strehimoret e shtetit, për të drejtuar Linjat Kombëtare telefonike SOS dhe aktivitete të tjera që kanë të bëjnë me dhunën në familje.<sup>32</sup> Në nivelin vendor, është emëruar një inspektor i delinkuencës juvenile në secilin nga autoritetet e punëve të brendshme për të koordinuar ato masa që kërkojnë ndërhyrjen e policisë për të luftuar dhunën në familje.

Në Serbi, disa strehimore drejtohen nëpërmjet projekteve të partneritetit mes OJQ-ve dhe qendrave të drejtuara nga shteti të Punës Sociale. Ato mund të marrin grante të bazuara në projekte prej Fondit të Përparimit Social pranë Ministrisë së Punës, Punësimin dhe Politikave Sociale.<sup>33</sup> Në këtë drejtim janë bërë ndryshime pozitive në Provincën autonome të Serbisë Vojvodinë. Sekretariati Provincial për Punën, Punësimin dhe Barazinë Gjinore ka dalë më nismën e ndërtimit të një strehimoreje në Novi Sad, në bashkëpunim me Këshillin Ekzekutiv të Vojvodinës. Kjo strehimore mbështetet financiarisht nga qyteti i Novi Sadit dhe drejtohet nga qendra për punë sociale. Për më tepër këshilli ekzekutiv i Vojvodinës ka rezervuar fonde për të mbështetur ndërtimin e një strehimoreje e në Zrenjanin ndërkohë që ka disa nisma për të ngritur strehimore nga bashkitë vendore (Suboticë, Sombor, Pancevë). Vendimi mbi Barazinë Gjinore i Parlamentit të Vojvodinës<sup>34</sup> në nenin 15 që i referohet mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, përfshin një rekomandim në të cilin qendrat për punë sociale duhet të kenë një linjë telefonike SOS si dhe strehimore për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës nga partnerët.

Në përgjithësi Shtetet nuk i përmbushin plotësisht detyrimet për të mbështetur OJQ-të të cilat merren më luftimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave. Qeveritë kanë së fundmi filluar të mbështesin OJQ-të të cilat drejtojnë strehimore dhe linja telefonike por kjo mbështetje është vetëm në baza ad-hoc.

## **Përgjigjja e Policisë**

Në shumicën e vendeve të studiuara, policia është e detyruar me ligj të ndërmarrë të njëjtat procedura dhe të përgjigjet në të njëjtën mënyrë kundrejt akteve të dhunës së armatosur, pavarësisht nëse ajo ndodh në shtëpi apo hapësirat publike. Kur thirren në skenën ku ka ndodhur dhunë e armatosur në familje, policia kontrollon në mënyrë rutinë për praninë e armëve të zjarrit. Nëse nuk është përdorur një armë zjarri policia do të kërkojë për të vetëm nëse ka marrë informacion rreth armëmbajtjes pa leje ose për përdorimin e padrejtë të një armë zjarri të mbajtur ilegalisht. Nëse gjendet një armë zjarri policia e ndalon atë dhe vazhdon më tej më procedura të tjera të investigimit.<sup>35</sup> Nëse personi që ka kryer këtë krim ka një armë të licencuar, oficerët e policisë do t'i marrin licencën dhe do të kryejnë shënim në raportin e tyre.

Në Shqipëri, kjo mund të çojë në heqjen e të drejtës së personit për të mbajtur një armë zjarri nga ana e Komisionit për Licencimin e Armëve të Zjarrit pranë Komisariateve të Policisë që janë njëkohësisht të ngarkuar për të hetuar rastet kriminale. Arma e ndaluar sekuestrohet nga qeveria (ose mund të nxirret në ankand në rastin e armëve të gjahut).

Policia në Mal të Zi nuk është ligjërisht e detyruar të kërkojë për praninë e armëve të zjarrit dhe licencave në skenën e incidenteve të dhunës në familje. Praktika është të kërkojnë të dhëna rreth personit në dosjet e

<sup>32</sup> Popa, Raluca Maria, Duke i dhënë fund dhunës në Familje, Evropën Juglindore dhe në Turqi: Drejt një Strategjie Rajonale për Veprim, Bratislava: UNIFEM CEE, 10 korrik 200, fq. 16.

<sup>33</sup> 'Dhuna kundër Grave: A Shqetësohet Qeveria në Serbi? Fakte e mbledhura nga OJQ-të mbi përgjigjen e shtetit' 2006, Instituti për Shoqëri të Hapur, [http://www.stopvaw.org/sites/3f6d15f4-c12d-4515-8544-26b7a3a5a41e/uploads/SERBIA\\_VAW\\_FACT\\_SHEET\\_2006\\_3.pdf](http://www.stopvaw.org/sites/3f6d15f4-c12d-4515-8544-26b7a3a5a41e/uploads/SERBIA_VAW_FACT_SHEET_2006_3.pdf), qasja është bërë më 5 prill 2007.

<sup>34</sup> Gazeta Zyrtare e Provincës së Pavarur të Vojvodinës, nr. 14/04.

<sup>35</sup> Kërkimi në Shqipëri përshkruan se procedurat të cilat përfshijnë kërkimin për armë zjarri nëse është fshehur nga dhunuesi, apo kërkesën që i bëhet dhunuesit për të dorëzuar në mënyrë vullnetare armën në polici; ndalimi dhe sekuestrimi i armës së zjarrit; masa të përshtatshme për të ndaluar humbjen e shenjave të gjstave dhe provave të tjera të gjetura në sipërfaqen e armës; ndërmarrjen e procedurave të nevojshme nëse arma e zjarrit është e licencuar nga Policia e Shtetit.

policisë (nëse ka armë zjarri dhe/ose licence, të dhënat kriminale, sjellje të mëparshme të dhunshme etj.) Rregullat e Procedurave për të Parandaluar dhe Zbuluar Rastet e Krimit për dhunën në Familje dhe Mbrojtjen e Viktimave, që ende nuk kanë hyrë në fuqi<sup>36</sup>, do të fusin një detyrim për zyrtarët e policisë për të kërkuar praninë e armëve të zjarrit në skenën e incidenteve të dhunës në familje.

Në Serbi, policia ka autoritetin të ndalojë një armë në mënyrë të përkohshme gjatë një investigimi nëse mbajtja e saj mund të çojë në akte kriminale apo shkelje ligji, nëse është e nevojshme për sigurinë publike, ose nëse personi mbahet në arrest dhe ka një armë që mund të përdoret për të lënduar veten, për të sulmuar të tjerët apo për tu arratisur. Policia gjithmonë kërkon në bazën e të dhënave për mbajtje të armëve të zjarrit përpara së të ndërhyjë në rastet e dhunës në familje, përpara së t'i afrohet vendbanimit të personit. Policia mund të kërkojë shtëpinë e personit apo apartamentin e tij vetëm në rastin kur ka një mandat. Në rast se policia ka ndaluar një armë zjarri, arma e konfiskuar do të mbahet në thesarin e gjykatës deri në fund të akuzave kriminale. Policia është e detyruar të dorëzojë një dokument zyrtar që ka të bëjë me sendin e konfiskuar përkohësisht. Nëse personi lirohet pa akuza sendi i konfiskuar kthehet.

Në Bosnjë Hercegovinë policia dhe prokurorët kërkojnë nëse personi mban një armë zjarri vetëm nëse ata kanë një 'arsye të fortë' për të vepruar në këtë mënyrë. Policia nuk mund të kërkojë për armë zjarri në skenën e dhunës në familje nëse ata nuk kanë një arsye të fortë për të kërkuar, si për shembull raportime nga viktimat apo ndonjë dëshmi se është përdorur armë zjarri. Në rastet kur është raportuar përdorimi i një arme të zjarrit, policia ndalon armën dhe pezullon licencën e saj, nëse arma zotërohet në mënyrë ligjore. Nëse personi aplikon për licence të armës së zjarrit ndërsa ndodhet i akuzuar për krim kërkesa e tij do të refuzohet bazuar në këtë fakt. Licencat e armëve të zjarrit do të konfiskohet nga ata individë që kanë qenë të akuzuar për krime dhe për akte të shkeljes së ligjit, duke përfshirë aktet e dhunës në familje të kryera në tre vitet e fundit.<sup>37</sup>

Është arritur progres për sa i përket rritjes së përgjegjësisë së zyrtarëve të shtetit në drejtim të përgjigjes kundra dhunës në familje. Në legjislacionin e Kroacisë, Serbisë, Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe në Republika Srpska, theksohet detyrimi që kanë zyrtarët për të raportuar dhunën në familje. Personeli mjekësor, profesionistët e shërbimeve sociale, psikologët, punonjësit socialë, pedagogët socialë dhe stafi i institucioneve mësimdhënëse janë të detyruar të raportojnë çdo akt të dyshuar të dhunës në familje të cilin ata e hasin gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, pranë policisë apo prokurorit publik. Moskryerja e këtyre detyrimeve sipas këtyre parashikimeve konsiderohet shkelje ligji.

Sidoqoftë praktikatat e policisë ende kanë nevojë të përmirësohen. OJQ-të e grave në Bosnjë dhe Hercegovinë raportojnë se policia në përgjithësi nuk ka gjasa të përgatisë një raport zyrtar në rastin kur viktimat ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe/ose e ka për herë të parë që raporton dhunë në familje. Policia zakonisht pret që këto raste të përsëriten disa herë para së të ndërmarrë një lëvizje zyrtare në drejtim të viktimës dhe dhunuesit. Ka ende raste kur dhuna në familje trajtohet si dhunim i Ligjit mbi Rendin dhe qetësinë Publike ashtu si ka qenë përpara së të miratoheshin ligjet mbi mbrojtjen kundra dhunës në familje. Si pasojë nuk mund të kërkohej urdhra shtrëngues prej gjykatës. Kështu, viktimat mbetet e ekspozuar ndaj dhunës dhe kërcënimeve të dhunuesit.

Rastet e dhunës në familje që janë më shumë serioze për shkak se dhunuesi ka përdorur armë zjarri raportohen rrallë në prokurori dhe polici. Një nga arsyet për këtë mund të jete se viktimat i frikësohet hakmarrjes nga ana e partnerit të dhunshëm dhe nuk beson se arma e zjarrit do të konfiskohet. Kështu këto viktimat përgjithësisht nuk përfitojnë prej asnjë nga masave mbrojtëse që mund të siguronin mbrojtjen e tyre. Shumë shpesh, me gjithë nevojën urgjente, viktimat nuk mund të vendosen në shtëpitë e mbrojtura për shkak të kapaciteteve të tyre të pamjaftueshme. Gjithashtu është venë re se shpesh viktimat nuk kanë sigurim shëndetësor, si rrjedhojë ato nuk kërkojnë trajtim për lëndimet që kanë marre, kështu që shërbimet shëndetësore e nuk kanë kontakt me këto raste, duke u hequr një mundësi këtyre rasteve për tu shënuar në statistikat zyrtare.

<sup>36</sup> Dokumenti i policisë është firmosur dhe miratuar nga Ministri i Brendshëm por duhet të miratohet nga qeveria në mënyrë që të hyjë në fuqi.

<sup>37</sup> Fatkeqësisht, kërkimi i bërë në Bosnjë dhe Hercegovinë thekson se këto masa nuk mund të jenë një garantues i mjaftueshëm i mbrojtjes së viktimës për shkak të përhapjes së gjerë të armëve të zjarrit të zotëruara ilegalisht në atë vend.

## Mbrojtja nga gjykata

Qasja ndaj drejtësisë është e vlefshme për të gjithë viktimat e dhunës në familje në të gjitha vendet por kjo nuk është aq e sigurt dhe aq e shpejtë sa kërkohet nga standardet ndërkombëtare. Procesi i ndjekjes së krimit zakonisht është i gjatë dhe si rrjedhojë shkruajues për viktimit. Një numër viktimitash nuk i përdorin mundësitë ligjore për të përfutur drejtësi për shkak të mungesës së njohurive dhe informacionit, frikës nga dhunuesit (e lidhur me mungesën e masave efektive mbrojtëse), refuzimit të bërjes publike të çështjeve private, mungesës së besimit së dhunuesi do të nxirret para drejtësisë, dënimeve të buta dhe pasigurisë ndaj rezultateve të procedurave të ndëshkimit të krimit.<sup>38</sup> Përveç të tjerave, kërkimi kombëtar tregon së vetëm një numër i vogël i të gjitha rasteve të raportuara përfundojnë në gjykatë.

Të gjitha vendet e rajonit kanë zhvilluar një legjislacion që siguron masat për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje por ato ndryshojnë në madhësi, qëllim dhe efektivitet. Ato mund të jenë urdhra kundër molestimit që ndalojnë dhunuesit të kenë kontakt apo të afrohen me viktimit; urdhra okupimi, që i japin të drejta viktimës si dhe fëmijëve të qëndrojnë në shtëpi apo që kufizojnë dhunuesin nga e drejta për të zaptuar apo rihyrë në shtëpi; urdhra shtrënguese si për shembull konfiskimi i armës. Heqja e së drejtës për licence armësh zjarri në të gjitha vendet e vëzhguara është nën kompetencat e zyrës së Ministrisë së Brendshme apo departamentit që lëshon licencat të këtiilla dhe mban të dhënat mbi licencat e lëshuara, të pezulluara apo të anuluar si dhe mbi ato të ndaluara, mbi armët e zjarrit të gjetura dhe të dorëzuara vullnetarisht. Burimet e këtyre masave mbrojtëse janë në mënyrë thelbësore specifike e Ligjit mbi dhunën në Familje, Ligjit mbi procedimet kriminale dhe/ose Kodit të Familjes. Masat mbrojtëse përfshijnë trajtimin e detyruar mjekësor për njerëzit më varësi ndaj alkoolit dhe drogave. Këto masa janë të përkohshme (ato mund të zgjasin deri në një vit) dhe jepen në raste gjykimi si raste veçanërisht urgjente.

Rregullorja e UNMIK-ut mbi Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje në Kosovë<sup>39</sup> siguron një fushë të gjerë të masave mbrojtëse që mund të lëshohen nga gjykata. Ato përfshijnë urdhra mbrojtjeje, urdhra të mbrojtjes së emergjencës dhe urdhra të mbrojtjes së përkohshme. Synimi i këtyre masave është së pari të ndajë fizikisht dhunuesin nga viktimat dhe të mbrojë ato prej ekspozimit të mundshëm ndaj dhunës apo kërcënimeve për dhunë. Sipas kësaj, gjykata mund të urdhërojë ndalimin e një armë zjarri duke përfshirë dhe armët e gjahut apo ato të sportit (Neni 2.1h) si dhe të urdhërojë Komisararin e policisë të pezullojë apo revokojë një licencë për armë zjarri të lëshuar nën Rregulloren e UNMIK-ut 2001.7 mbi Autorizimin e Mbajtjes së armëve në Kosovë (neni 2.1o). Ndalimi i një armë zjarri mund të urdhërohet gjithashtu si një masë emergjence. Gjyqi mund të urdhërojë çdo masë tjetër që konsiderohet e nevojshme për të mbrojtur shëndetin, mirëqenien apo gjendjen e qetë të viktimës dhe/ose të ndonjë personi tjetër më të cilin viktimat jeton në familje (neni 2.1p). Përveç viktimës dhe përfaqësuesit ligjor apo avokatit, kërkesa për ndalimin e armës së zjarrit mund të dorëzohet nga një qendër për punë sociale, nga çdo person më të cilin viktimat jeton në të njëjtën familje ose nga një person që e di së viktimat abuzohet. Gjyqi jep vendimin e tij i bazuar mbi këtë kërkesë në bazë të procedurave të përshpejtuara. Masa mbrojtëse mund të zgjasë deri në një vit. Dhunimi i masës konsiderohet shkelje ligji dhe dënohet me gjobë apo burgim deri në gjashtë muaj. Në rast ditësh pushimi të gjykatës, policia mund të lëshojë urdhra për masa mbrojtëse të përkohshme (neni 13). Sidoqoftë, ndalimi i një armë zjarri nuk mund të lëshohet nga policia si një masë e përkohshme.

Në Serbi dhe në IRJ të Maqedonisë gjykatat gjithmonë kërkojnë të dinë rreth pranisë së armëve të zjarrit gjatë procedimeve kriminale dhe urdhërojnë ndalimin e tyre prej dhunuesve bazuar në parashikimi ligjor, 'ndalimi i një mjete që është përdorur apo mendohet të përdoret në një akt kriminal'. Mjetet mund të konfiskohen nëse ka ndonjë mundësi së ato mund të përdoren përsëri në ndonjë akt tjetër kriminal. Gjykatat mbajnë shënim për të gjitha mjetet që janë gjetur apo ndaluar duke përfshirë dhe armët e zjarrit. Konfirmimi për ndalimin përmban karakteristikat teknike të armës së zjarrit. Deri sa të merret vendimi armët e zjarrit mbahen nën pronësinë e shtetit. Nëse një rast mbaron me pafajësinë e personit arma e ndaluar i kthehet pronarit. Në Serbi dhunimi i masave mbrojtëse është i dënueshëm sipas Kodin Penal, me gjobë ose burgim deri në gjashtë muaj. Edhe pse ky parashikim ekziston, praktika tregon së gjykatat ende nuk i përdorin këto masa mbrojtëse në mënyrë të rregullt.

<sup>38</sup> Nukolic-Ristanovic, Vesna dhe Dokmanovic, Mirjana, Standardet ndërkombëtare mbi dhunën në Familje dhe Zbatimi i tyre në Ballkanin Perëndimor, Beograd: Prometej, 2006. fq. 106 – 107.

<sup>39</sup> UNMIK/REG/2003/12.

Në Mal të Zi policia nuk është e lejuar të bëjë kërkesë për marrjen e masave mbrojtëse; kjo është përgjegjësi e gjykatës. Policia ka përfshirë së fundmi një formë të re për të informuar zyrtarët administrativë përgjegjës për dhënien e licencave të armëve të zjarrit rreth gjithë akteve kriminale të kryera dhe të dënuara *ex officio* pasi dënimi për akte të këtilla është një pengesë për marrjen dhe përfundimin e licencës. Nëse një armë zjarri përdoret në një akt kriminal, praktika e policisë është ndalimi i saj i përkohshëm dhe sjellja e procedurës para zyrës përgjegjëse administrative e cila do të bëjë konfiskimin e përkohshëm të saj nëse i pandehuri gjykohej si i fajshëm ose ja kthen atë të pandehurit nëse çështja mbyllet apo gjyqi refuzon padinë penale. Në Mal të Zi gjykatat kërkojnë të dhëna rreth një armë zjarri vetëm nëse ajo është përdorur apo mendohet të përdoret në një vepër kriminale. Masa shtrënguese e mohimit të një armë e cila mund të jetë një armë zjarri jepet vetëm si një masë sigurie pasi i pandehuri gjykohej i fajshëm. Legjislacioni malazez nuk parashikon ndalimin e një armë si masë mbrojtëse por si një masë sigurie.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë, gjykata urdhëron ndalimin e armës së zjarrit nëse viktimat raportojnë dhunë në familje të armatosur.

Gjatë gjyqimeve penale, gjykatat mund të urdhërojnë heqjen e të paditurit nga salla e gjyqit por kjo masë zakonisht nuk është e mjaftueshme për të mbrojtur viktimën. Gjyqi mund të urdhërojë arrestimin e përkohshëm të të pandehurit me qëllim mbrojtjen e viktimës, por kjo është një masë afatshkurtër (p.sh. Në Kroaci deri në 15 ditë) dhe në raste të rralla përdoret për dhunën në familje. Megjithatë barra e provës për krime seksuale nuk duhet të jetë më e rëndë sesa për krime të tjera, praktika gjyqësore mbetet prapa ligjit. Barra e provës është veçanërisht e vështirë dhe e dhimbshme për viktimat në raste të përdhunimeve martesore dhe krimeve seksuale.

Në rastet kur viktimat kryejnë një krim si përgjigje për dhunën në familje, ato mund ta quajnë atë si akt vetëmbrojtjeje për t'i shpëtuar ndëshkimit por është në dorë të gjykatave për të vendosur rast pas rasti. Sidoqoftë kërkimi kombëtar tregon se praktika gjyqësore nuk është në favor të grave që janë viktimat të dhunës në familje në rast se kanë vrarë mashkullin që abuzonte më to, veçanërisht nëse është përdorur armë (qoftë ajo thikë qoftë armë zjarri) për të mbrojtur veten e tyre prej një abuzimi afatgjatë. Në këto raste gjykatat kanë pak gjasa ta konsiderojnë kryerjen e vrasjes si një akt vetëmbrojtës dhe japin dënime të rënda burgimi.

Si rregull kornizat legjislative penale dhe civile, në vendet ku është kryer kërkimi nuk janë të rregulluara aq sa duhet. Ka një shembull të mirë të praktikës nga Serbia sidoqoftë për sa i përket ndërveprimit mes normave penale dhe civile.

### **Programet rehabilituese për personat që kanë shkelur ligjin**

Vihet re një mungesë të programeve rehabilituese për personat që kanë shkelur ligjin në lidhje me dhunën në familje, edhe në vendet ku këto janë detyrime të përshkruara në ligj si në rastin e Bosnjë dhe Hercegovinës dhe në rastin e IRJ të Maqedonisë. Ka vetëm pak OJQ të cilat kryejnë këto aktivitete por dhe këto jo në mënyrë sistematike. Në Kroaci, puna e OJQ-ve në këtë fushë është pjesërisht e financuar nga qeveria. Në Serbi, qendrat për punë sociale kanë pasur programe eksperimentale rehabilitimi por ato janë mbyllur për shkak të mungesës së fondeve.

### **Mekanizmat raportuese brenda sistemit shëndetësor**

Në të gjitha vendet ky është kryer kërkimi legjislacioni siguron mekanizma raportimi brenda sistemit shëndetësor publik. Profesionistët e kujdesit shëndetësor janë të detyruar më ligj për të raportuar në polici çdo lëndim serioz trupor apo shenjë të dhunës së armatosur. Sidoqoftë si doli nga kërkimi kombëtar punonjësit e kujdesit shëndetësor nuk i kushtojnë vëmendje të mjaftueshme bisedave me viktimat për të marrë ndonjë informacion rreth historie së dhunës dhe rrethanave nën të cilat ka ndodhur sjellja e dhunshme. Në Shqipëri punonjësit e kujdesit shëndetësor nuk kanë detyrim ligjor të pyesin pacientet e tyre rreth shkaqeve të lëndimeve dhe në të njëjtën kohë as të regjistrojnë përgjigjet e tyre në librin e shënimeve të pacientit.<sup>40</sup> Ka gjithashtu një mungesë

<sup>40</sup> Vetëm 13 për-qind e personelit të shërbimit shëndetësor raportuan se mbanin shënim rastet e dhunës prej të cilëve vetëm katër për-qind raportojnë se mbajnë shënim si rastet ashtu dhe shkaqet e dhunës. Në një studim të Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Punonjësve Sociale (2006) përgjigjet e shkruara të punonjësve të kujdesit shëndetësor (37 për-qind) treguan se ata nuk e njohin dhunën e bazuar mbi gjininë, dhe në të njëjtën kohë e konsiderojnë dhunën në familje si një çështje private të familjes.

të një protokollit të qartë për dokumentimin e shënimeve. Në përgjithësi ka nevojë për trajnime të stafit brenda sistemit të kujdesit shëndetësor për nevojat për konsultime me pacientet dhe personat që mbajnë shënimet.

### **Bashkëpunimi mes agjencive**

Në mënyrë që të zhvillohet një bashkëpunim më i mirë ndërprofesional në rastet e dhunës në familje, janë adoptuar protokollat e veprimit mes të gjitha institucioneve përkatëse në Kroaci dhe Mal të Zi. Kodi i Procedurës Kroate përmban një listë të detyrimeve për të gjithë njësitë kompetente që përfshihen në identifikimin dhe eliminimin e dhunës dhe në sigurimin e ndihmës dhe të mbrojtjes për personat e ekspozuar ndaj dhunës në familje. Në Mal të Zi në vitin 2003, departamentet e policisë, gjykatat, zyrat e prokurorëve, qendrat për punë sociale, administrata vendore, linjat telefonike SOS dhe institucionet e kujdesit shëndetësor nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi dhe një Marrëveshje Bashkëpunimi në pesë prej 21 bashkive të vendit. Skuadra të përbëra nga profesioniste të ndryshëm u krijuan në nivel vendor por ende nuk janë në funksionim.

Në vitin 2005, Zyra e Ombudsperson-it në Provincën Serbe të Vojvodinës morri nismën për të krijuar rrjetin 'Jeta pa Dhunë',<sup>41</sup> e cila përfshin të gjitha institucionet përkatëse (qendrat për punë sociale, policinë, gjykatat, zyrat e prokurorëve, institucionet shëndetësore e etj.) që merren me çështjet e dhunës në familje. Anëtarët e këtij rrjeti nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimit në nivel Province. Në bazë të këtij Memorandumi, në gati të gjitha nga 45 bashkitë e Vojvodinës, janë krijuar skuadra vendore që i kushtohen çështjes së dhunës në familje dhe mbrojtjes së viktimave.

Vetëm në Kosovë ekzistojnë njësi speciale të policisë që ndërhyjnë në rastet e dhunës në familje. Janë përcaktuar oficerë policie që do të merren me raste të ngjashme në Kroaci dhe Mal të Zi. Në Serbi ka një praktikë të suksesshme në nivel vendor (bashkia e Somborit) për krijimin e një skuadre lëvizëse me profesioniste nga fusha të ndryshme që funksionon 24 orë me qëllim ndërhyrjen në rastet e dhunës në familje e cila funksionon në partneritet me qendrën për punë sociale dhe me policinë vendore. Janë bërë përpjekje për të krijuar dhe një njësi speciale mjekësore me qëllim kryerjen e ekzaminimeve sistematike për viktimat e dhunës seksuale.

### **Trajnimi për profesionistët**

Si praktikë, trajnimi për oficerët e policisë, gjykatësit, prokurorët, punonjësit sociale dhe profesionistët e tjerë që merren me dhunën në familje nuk është i detyrueshëm dhe nuk sigurohet nga shteti. Ekzistojnë programe trajnuese në të gjitha vendet por ato nuk kanë kryer rregullisht dhe sistematikisht dhe përgjithësisht janë kryer nga OJQ-të. Vetëm në Kosovë të gjithë oficerëve të policisë u kërkohet të marrin pjesë në këto programe. Akademitë e policisë në Kroaci dhe Mal të Zi kohët e fundit kanë përfshirë dhe trajnimin e oficerëve të ardhshëm të policisë për tu marrë me çështjet e dhunës në familje në programin e tyre. Në IRJ të Maqedonisë ka pasur disa trajnime të sponsorizuara nga shteti mbi dhunën në familje.

## **3.3 Masat për të parandaluar dhunën në familje dhe dhunën e armatosur në familje**

Sipas kërkimit kombëtar, qeveritë në vendet e rajonit kanë bërë shumë pak përpjekje sistematike dhe gjithëpërfshirëse në drejtim të marrjes së masave dhe politikave me qëllim parandalimin e dhunës në familje. Hapi më i madh në këtë drejtim është bërë në krijimin e mekanizmave për Barazinë gjinore. Ato tashmë ekzistojnë në të gjitha vendet, si njësi qeverie apo parlamenti me emra dhe spektër të ndryshëm kompetencash po që përgjithësisht merren me vendosjen e një qasje sistematike drejt promovimit të të drejtave të grave dhe barazisë gjinore.

Si rrjedhojë të gjitha vendet kanë bërë progres në draftimin apo adoptimin e legjisllacionit për Barazinë gjinore si dhe planet e veprimit dhe strategjive kombëtare që përfshijnë çështjet e dhunës në familje. Sidoqoftë aktivitetet e qeverive në fushën e parandalimit të dhunës në familje ende janë shumë të varfra dhe kanë mbetur pas zotimeve që kanë marrë shtetet. Ka pasur kohët e fundit disa nisma për të përfshirë çështjet e barazisë gjinore në arsim dhe për të eliminuar stereotipat gjinore në programin shkollor por këto hapa janë vetëm në fillimet e tyre. Aktivitetet që qeverisë për të ngritur ndërgjegjen publike mbi dhunën në familje si dhe rastet e fushatave qeveritare kundër dhunës në familje janë ende shumë të rralla. Për më tepër mund të thuhet se nuk i është

<sup>41</sup> Avokati i Popullit të Provincës, Provinca Autonome e Vojvodinës, 'Raporti i Avokatit të Popullit të Provincës për vitin 2005', Novi Sad 2006, fq. 132-138.



kushtuar gati asnjë vëmendje armëve të zjarrit si një faktor rreziku apo lidhjes që kanë AVL-të me rregulloret mbi dhunën në familje.

### **Strategjitë dhe planet e veprimit kombëtar**

Një Strategji Kombëtare mbi Mbrojtjen Kundër Dhunës në Familje (për periudhën 2005 – 2007) ekziston vetëm në Kroaci, ndërsa është draftuar në Shqipëri. Strategjia Kroate e miratuar në 2004 dhe që është duke u zbatuar ndërkohë, përmban 27 parashikime dhe masa mbrojtëse afat shkurtër dhe afat gjatë. Këto masa hedhin dritë mbi nevojën për të ndryshuar legjislacionin si dhe praktikën dhe procedurat e gjykatës dhe policisë, arsimin, sistemin gjyqësor dhe për të ngritur ndërgjegjen e publikut. Strategjia përfshin detyrimet e të gjitha institucioneve përkatëse për të hetuar, parandaluar dhe ndëshkuar të gjitha format e dhunës brenda familjes. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare koordinohet nga një departament special pranë Ministrisë së Familjes dhe ka një buxhet të tijin. Veprimet e sponsorizuara nga Shteti në mbështetje të përpjekjeve për t'i dhënë fund dhunës në familje në Kroaci përfshijnë si masat për ndërhyrje (ndërhyrje e policisë) dhe masa mbrojtëse (parashikimet për shërbime). Kohët e fundit është vënë në dispozicion dhe një mbështetje financiare nga qeveria dhe fondet vendore për strehimoret e OJQ-ve por kushtet konkrete ndryshojnë nga vendi në vend. Shumica e shërbimeve për gratë viktime të dhunës në familje vazhdojnë të sigurohen nga OJQ-të të cilat ofrojnë këshillim ligjor mbështetje psikologjike dhe strehim. Strategjia nuk përmend kontrollin dhe rregullimin e AVL-ve.

Drafti i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore dhe Zhdukjen e Dhunës në Familje të Shqipërisë (2007 deri në 2010)<sup>42</sup> synon në harmonizimin e të gjithë kuadrit ligjor me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-se në këtë fushë, për të krijuar hapësira për zbatimin e çështjeve gjinore në politikën publike dhe për të ulur dhunën në familje. Një prej synimeve të tij është forcimi i politikave të përfshirjes së të gjithë personave të interesit në mënyrë që të parandalohet dhe eliminohet dhuna në familje. Duke njohur mungesën e mjeteve efektive në luftimin e dhunës në familje, Drafti Strategjia vendos masa mbrojtëse që duhet të merren nga qeveria shqiptare në fushat më të rëndësishme, p.sh. arsimit, sistemi gjyqësor, sistemi i kujdesit shëndetësor, sektori i shërbimeve sociale dhe ngritja e ndërgjegjes. Në kuadrin e detyrave të policisë për zbatimin e masave mbrojtëse të lëshuara nga gjykata, strategjia nënvijëzon detyrimin për të ndaluar çdo armë të gjetur nga kërkimet e policisë tek dhunuesit. Dokumenti nuk flet për çështjen e kontrollit të armëve të zjarrit.

Në vendet e tjera të rajonit, plan veprimet e qeverisë në këtë fushë janë përkufizuar brenda Plan Veprimeve Kombëtare për Barazinë Gjinore<sup>43</sup> në një kapitull të veçantë që i drejtohet dhunës kundër grave duke përfshirë dhe dhunën në familje. Kërkimi kombëtar tregon se ka një mungesë serioze në zbatimin e këtyre dokumenteve strategjike. Për shembull, megjithëse Këshilli i Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës miratoi Plan Veprimin Gjinor në vitin 2006, i cili përmban një ndarje të veçantë mbi dhunën në familje, deri më tani nuk është zhvilluar ndonjë strategji apo ndonjë plan veprim i posaçëm.

Në Mal të Zi, lufta kundër dhunës në familje është përfshirë në Planin e përgjithshëm Kombëtar për Parandalimin e Dhunës, të miratuar në vitin 2003 në bashkëpunim me OJQ-të. Synimet kryesore të planit janë përmirësimi i legjislacionit; ngritja e nivelit të arsimit mbi këtë çështje; vendosja e bashkëpunimit mes gjithë personave të interesit duke përfshirë dhe sektorin e Shoqërisë Civile; përmirësimin e pozicionit të grave, të rinjve dhe të moshuarve; zhdukjen e varfërisë dhe krijimin e kapaciteteve të institucioneve të kujdesit shëndetësor për t'iu përgjigjur dhunës në familje.

Në kontrast me këtë Korniza Fillestare Serbe e Strategjisë Kombëtare kundër Dhunës, e draftuar në vitin 2005, nuk e njeht dimensionin gjinor të dhunës. Serbia nuk ka një strategji kombëtare kundër dhunës në familje por puna për të draftuar këtë strategji në nivel Province në Vojvodinë filloi në shtator të vitit 2007, nën kujdesin e Sekretariatit për Punë, Punësim dhe Barazi Gjinore. Synimi është të krijohet një kornizë efektive për të luftuar dhunën në familje nëpërmjet masave afatgjata dhe afatshkurtra në nivel province dhe në nivel vendor. Do të krijohet me këtë rast një buxhet specifik për zbatimin e strategjisë.

Asnjë nga planet e veprimit kombëtar ekzistues (apo drafte) nuk i drejtohet çështjes së dhunës së armatosur në familje, armëve të zjarrit si një faktor rreziku për dhunën në familje apo lidhjeve me rregulloret për AVL-të.

<sup>42</sup> Ky dokument strategjie është pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

<sup>43</sup> Planet Kombëtare në fushën e barazisë gjinore janë draftuar në Mal të Zi dhe Serbi por nuk janë futur ende në zbatim.

## Mbështetja buxhetore

Në përgjithësi vendet e rajonit kanë mungesa për sa i përket buxheteve specifike që do të mbështesin aktivitetet në fushën e parandalimit të dhunës në familje. Si pasojë e kësaj shumica e aktiviteteve të përkufizuara në dokumentet e policisë nuk janë zbatuar ende. Përfundimisht në këto raste i gjejmë në IRJ të Maqedonisë (ku buxheti për dhunën në familje është i përfshirë më buxhetin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale nën kategorinë 'personat e përjashtuar në kuptimin social'), në Kroaci (nën Ministrinë e Familjes ka një departament të veçantë që merret më dhunën në familje) dhe në Kosovë (Shërbimi Policor Kosovar përmban një zë buxheti për të financuar veprimtarinë e njësisë speciale në këtë fushë<sup>44</sup>). Në Serbi, fondi për Përmirësimin Social pranë Ministrisë së Punës, Punësimin dhe Politikave Sociale ka siguruar për projekte përmirësuese në fushën e mbrojtjes sociale, duke përfshirë partneritetin mesh Shtetit dhe OJQ-ve. Në Provincën serbe të Vojvodinës, Sekretariati për Punë, Punësim, dhe Barazi Gjinore mbështet financiarisht në mënyrë të rregullt Punën e disa linjave telefonike SOS brenda qendrave për punë sociale, si dhe disa projekte specifike të OJQ-ve që synojnë në luftimin e dhunës në familje. Falë nismës së Avokatit të Popullit të Provincës një numër Sekretariatesh provinciale kanë ngritur zëra të posaçëm buxhetorë për të mbështetur aktivitetet në fushën e parandalimit të dhunës në familje në vitin 2007.<sup>45</sup> Ka një nismë për të vendosur një mbështetje buxhetore të përhershme për programet që synojnë në eliminimin e dhunës në familje, duke përfshirë trajnimin, linjat telefonike strehimoret dhe fushatat e ndërgjegjësimit.

Në Shqipëri, nuk ka zë në buxhet të caktuar për këtë çështje por Strategjia për Shërbime Sociale parashikon një rritje në buxhet për këto shërbime dhe për të mbështetur OJQ-të që të sigurojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje. Drafti i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje përfshin një buxhet për zbatimin e saj.

## Fushatat për ngritjen e ndërgjegjes

Si rregull, qeveritë në rajon nuk kanë nisur fushata për ngritjen e ndërgjegjes publike mbi dhunën në familje. Agjencitë udhëheqëse për këto fushata janë ende grupet e grave dhe OJQ-të e grave të cilat kanë organizuar fushata kombëtare të gjera si pjesë e fushatës ndërkombëtare '16 ditë aktivimi kundër dhunës kundër grave'. Fushatat qeveritare janë ende shumë të rralla. Ato nuk kanë pasur synime në terma afatgjatë dhe kanë qenë të kufizuara në përpjekjet e njësisë të veçanta Shtetërore siç është Zyra Qeveritare për Barazinë Gjinore në Mal të Zi. Përfundimisht nga kjo praktikë neglizhuese për rëndësinë e fushatave për ngritjen e ndërgjegjes bën IRJ e Maqedonisë. Këtu, tre ministri<sup>46</sup> drejtuan fushata kombëtare që i drejtohen dhunës në familje në vitin 2005 dhe 2006.

Praktika pozitive mund të gjenden përsëri në Provincën serbe të Vojvodinës, ku Sekretariati për Punë, Punësim dhe Barazi Gjinore i mbështet dhe i bashkohet në mënyrë të rregullt këtyre fushatave. Institucionet provinciale dhe vendore, anëtarët e rrjetit 'Jetë pa Dhunë' (ombudsperson-i provincës, qendrat për punë sociale, gjyqet, zyrat e prokurorëve, përfaqësuesit e policisë, institucionet e kujdesit shëndetësor, etj.) i janë bashkuar aktiviteteve për ngritjen e ndërgjegjes. Një numër nismash u janë propozuar dhe drejtuar institucioneve të shtetit. Këto nisma përfshijnë: vendosjen e një Fondi të Emergjencës për të ndihmuar viktimat e dhunës në familje; fuqizimin e policisë, gjykatësve dhe prokurorëve për t'iu përgjigjur rasteve të dhunës në familje; zhvillimin e rregullave të procedurës në rastet e dhunës në familje në nivel vendor; informimi i profesionistëve dhe zyrtarëve të shtetit mbi standardet ndërkombëtare në këtë fushë; vendosja e një mekanizmi monitorues; mbledhja e statistikave dhe e të dhënave si dhe informimi i rregullt dhe ngritja e ndërgjegjes së publikut rreth rëndësisë së luftimit të dhunës në familje si dhe eliminimin e praktikave diskriminuese kundër grave.

Trajtimi në media i dhunës së armatosur në familje bëhet në përgjithësi mbi baza 'sensacioni' me objektin kryesor tërheqjen e vëmendjes nga ana e publikut në vend që të ndriçohen anët serioze, përhapja dhe shkaqet

<sup>44</sup> 'Dhuna kundër Grave: A Shqetësohet Qeveria në Serbi? Fakte e mbledhura nga OJQ-të mbi përgjigjen e shtetit' 2006, Instituti për Shoqëri të Hapur, [http://www.stopvaw.org/sites/3f6d15f4-c12d-4515-8544-26b7a3a5a41e/uploads/SERBIA\\_VAW\\_FACT\\_SHEET\\_2006\\_3.pdf](http://www.stopvaw.org/sites/3f6d15f4-c12d-4515-8544-26b7a3a5a41e/uploads/SERBIA_VAW_FACT_SHEET_2006_3.pdf), qasja është bërë me 5 prill 2007.

<sup>45</sup> Për shembull, Sekretariati për Shëndetin dhe Punët Sociale vendosi fonde për arsimimin specifik të punonjësve sociale dhe vullnetarëve gjithashtu dhe për viktimat e dhunës në familje dhe disa shërbime të tjera.

<sup>46</sup> Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale mbajnë fushata Kombëtare së bashku me Shoqatën e Qytetarëve Akcija Zdruzenska, Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi Gjinore – ESE, Linja Kombëtare telefonike SOS e Organizatës së Gruas së Shkupit, Qendra e Krizës – Shpresë dhe Qendra Strehimore.



e fenomenit. Nuk janë marrë masa efektive për të siguruar se media promovon respekt për gratë dhe eliminon stereotipat e krijuara mbi baza gjinore dhe si dhe paragjykimet në prezantimet e medias.

Deri më tani asnjë nga këto aktivitete parandaluese Në fushën e dhunës Në familje nuk i është drejtuar çështjes së çarmatimit dhe kontrollit të armëve. Këto çështje nuk janë ngritur as në fushatat e drejtuara prej grupeve dhe OJQ-ve të grave.

### **Edukimi i fëmijëve dhe të rinjve**

Është filluar të diskutohet për praninë e programeve që janë të ndjeshme për sa i përket çështjeve gjinore dhe që nuk kanë stereotipa dhe paragjykimet, por nuk janë futur ende Në shumicën e vendeve të rajonit. Planet e Veprimit Kombëtar për Përparimin e Grave dhe ligjet mbi Barazinë gjinore, të miratuara nga shumica e vendeve ku është bërë kërkimi, sigurojnë për futjen e çështjeve të barazisë gjinore në arsimin fillor të mesëm dhe atë të lartë. Sidoqoftë, deri tani nuk janë zhvilluar programe arsimore që synojnë burrat dhe djemtë me qëllim, parandalimin e dhunës dhe eliminimin e stereotipave gjinorë. Në Shqipëri qeveria ka rishikuar tekstet shkollore për disa vite të shkollës fillore dhe janë vendosur kritere për të rishikuar tekstet nga këndvështrimi gjinor. Ky aktivitet është përshkruar nga ligji në Bosnjë dhe Hercegovinë por nuk është zbatuar ende.

### **3.4 Mekanizmat zbatues**

Dokumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut identifikojnë qeveritë si aktoret kryesore të detyruara për të zbatuar standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në mirëbesimin dhe përpikërinë e duhur. Ato janë përgjegjëse për të aplikuar këto principe në përputhje me luftimin dhe parandalimin e dhunës në familje siç është njohur nga normat ndërkombëtare si një çështje e që shqetëson publikun. Në përgjithësi në vitet e fundit qeveritë e Ballkanit Perëndimor kanë bërë përparime të dukshme në përshtatjen me detyrimet që rrjedhin prej CEDAW dhe dokumenteve të tjera të të drejtave të njeriut që kanë të bëjnë me dhunën Në familje dhe kanë vendosur një numër mekanizmesh për të zbatuar zotimet e marra në këtë fushë. Sidoqoftë deri më tani vënia në praktikë e këtyre mekanizmave nuk ka qenë aq efektiv sa duhet. Veçanërisht ka ende hapësira të mëdha në lidhje me mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave.

Në nivel kombëtar mekanizmat për zbatimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese në fushën e dhunës në familje janë ngritur nga legjislacioni përkatës në fusha të veçanta të aktiviteteve siç është Kodi Penal, Kodi Familjar, Kodi i Procedurës Penale, Ligji mbi Rëndin dhe Qetësinë Publike, Ligji mbi Barazinë Gjinore, Ligji mbi Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje, etj. Mekanizmat për zbatimin e legjislacionit përkatës për të luftuar dhunën në familje dhe mbrojtjen e viktimave janë ministritë përkatëse me degët e tyre ekzekutive: Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punës dhe Politikave Sociale.<sup>47</sup> Për më tepër, ekziston gjithashtu një numër ministrish përgjegjëse për zbatimin e masave mbrojtëse në terren siç është për shembull Ministria e Arsimit.

Strategjitë specifike për parandalimin e dhunës në familje, Në vendet ku ato ekzistojnë, si dhe dokumente të tjera (siç është për shembull Plani i Veprimit Kombëtar për Përparimin e Grave), ministritë e ndryshme si dhe organizma shtetërore që janë përgjegjëse për zbatimin e secilës nga këto aktivitete specifike. Disa nga këto dokumente formojnë një organizëm specifik monitorues. Për shembull Plani i Veprimit Kombëtar të Malit të Zi për Parandalimin e Dhunës (viti 2003) ka vendosur një Këshill Koordinues që luan rolin e një organizmi monitorues të formuar nga qeveria, ministritë përkatëse, policia dhe organizma të tjerë qeveritare dhe institucionale, si për shembull përfaqësues të OJQ-ve. Këshilli Koordinues ka autoritetin të krijojë ekipe shumë-sektoriale në nivel vendor.

Në fushën e monitorimit dhe propozimit të politikave që do të bëjnë ndryshimin, janë mekanizmat e barazisë gjinore ato që kanë kompetenca të këtyra. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, këto janë qendrat gjinore dhe komisionet parlamentare; Në Kroaci, Ombudsperson-i për Barazinë Gjinore dhe në Mal të Zi zyra për Barazinë Gjinore. Në Serbi, mekanizmat për Barazinë gjinore janë krijuar në nivel kombëtar, provincial dhe vendor dhe komisionet apo komitetet për Barazinë gjinore ekzistojnë në formën e organizmave qeveritare dhe parlamentare. Ben përjashtim Vojvodina në të cilën Sekretariati për Punë, Punësim dhe Barazi Gjinore është pjesë e pushtetit ekzekutiv, ndërsa

<sup>47</sup> Ministri me të njëjtat kompetenca mund të kenë tituj të ndryshëm. Për shembull Në Kroaci, ministritë përkatëse janë Ministria e Familjes, Mbeshtetjes dhe Solidaritetit ndërmjet Brezave dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, që ka përgjegjësinë për mbrojtjen sociale, ndërsa Në IRJ të Maqedonisë dhe Serbi është Ministria e Punës dhe Politikave Sociale.

Zyra e Ombudsperson-it ka një zëvendës i cili merret me Barazinë gjinore. Në Vojvodinë, është krijuar së fundmi, Instituti për Barazi Gjinore i cili është i pari në llojin e vet në rajon.

Në të gjitha vendet qendrat për punë sociale kanë një rol dhe ndikim të veçantë si institucione shtetërore që merren me viktimat dhe dhunën në familje.

### **Mbledhja dhe monitorimi i të dhënave**

Me gjithë disa përparime në harmonizimin e rregulloreve me standardet ndërkombëtare në fushën e parandalimit dhe luftimit të dhunës në familje, të gjitha shtetet e rajonit kanë mungesa në mbledhjen e të dhënave, kërkimin dhe monitorimin e tyre. të dhënat mbledhen më së shumti në mënyrë sporadike dhe të pjesshme, pa një strategji të qartë apo një qasje sistematike dhe uniforme, ndërsa nuk ekziston fare monitorimi i shtetit. Sidoqoftë, ka progres në këtë fushë. Për shembull policia në Republika Srpska ka filluar të mbajë shënime mbi përdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje, ndërsa zyrat e prokurorit kanë filluar të përmendin dhunën në familje në raportet statistikore që ato përgatisin.

Në disa vende mund të gjenden statistikave të shtetit në raportet e dhunës në familje si dhe dënimi dhe ndjekja e tyre. Në Serbi këto të dhëna mbledhen nga zyrat statistikore ndërsa në Kroaci kjo bëhet nga zyra e prokurorit të shtetit. Në IRJ të Maqedonisë, Ministria e Punës dhe Politikave Sociale mbledh të dhëna nga qendrat për punë sociale duke përdorur metoda të njëjta të mbledhjes së të dhënave çdo tre muaj. Parametrat e përdorur për mbledhjen e të dhënave përfshijnë mes të tjerave rastet e përfunduara të zgjidhura; rastet e raportuara nga institucionet apo organizatat e tjera; kombësinë, gjininë dhe moshën e viktimave; llojin e ndërhyrjes që kanë marrë qendrat për punë sociale; ndërhyrjen e policisë; masat e përkohshme të mbrojtjes të propozuara si dhe numrin e kërkesave që janë dorëzuar për të marre këto masa. Linja Maqedonase Telefonike Kombëtare SOS është gjithashtu e detyruar të mbledhë të dhëna dhe të njoftojë rregullisht Ministrinë rreth numrit të thirrjeve dhe llojin e mbrojtjes që është dhënë. Por ende ka të dhëna të pamjaftueshme mbi dhunën e armatosur Në familje për shkak të metodologjive të ndryshme të përdorura për mbledhjen dhe regjistrimin e të dhënave që përdoren nga institucione të ndryshme shtetërore si dhe mungesën e koordinimit mes këtyre institucioneve.

Në Serbi, IRJ të Maqedonisë, Kroaci dhe Republika Srpska, është e mundur të përftohen disa të dhëna mbi dhunën në familje prej Ministrisë së Brendshme. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, Statistikat Vjetore mbi Gjininë të Agjencisë së Statistikave ende kanë mungesa statistikash mbi dhunën kundër grave duke përfshirë këtu dhe përdorimin e armëve në dhunën në familje megjithëse Ligji për Barazinë Gjinore kërkon që të gjithë të dhënat dhe regjistrimet e organizmave shtetërore, shërbimeve publike institucioneve dhe korporatave private duhet të jenë të ndara sipas gjinisë dhe të hapura për publikun. Kroacia nuk ka krijuar ende një sistem të integruar të mbledhjes së të dhënave për dhunën në familje. Në Kroaci, institucionet e përfshira në çështjen e dhunës në familje i mbledhin të dhënat në mënyrë të veçantë. Është e detyrueshme për policinë të mbajnë të dhënat mbi dhunën në familje në bazë të seksit, llojit të dhunës dhe lëndimeve. Spitalet kanë filluar kohët e fundit të prodhojnë raporte mbi rastet e dhunës në familje. OJQ-të mbajnë të dhënat e tyre.

Në mënyrë që të mundësohet një rishikim më i lehtë e efektit së masave ligjore në disa vende (p.sh. Serbi dhe Mal të Zi) policia dhe/ose gjykata ka vendosur një sistem regjistrimi të të dhënave që do të lejonte identifikimin e më të lehtë të rasteve të dhunës në familje si dhe mbledhjen e një game të gjerë të dhënash për këto raste Në krahasim me rastet e tjera të kriminalitetit në përgjithësi.

Institucionet e zbatimit të ligjit në të gjitha vendet në rajon kanë mungesë të të dhënave për sa i përket dhunës së armatosur në familje, veçanërisht për sa i përket rasteve të raportuara, të ndjekura dhe të dënuara, të dhëna mbi viktimat, dhunuesit dhe nëse është përdorur ndonjë armë zjarri dhe llojin e armës. Ka gjithashtu mungesë të dhënash prej institucioneve të kujdesit shëndetësor dhe qendrave për punë sociale.

### 3.5 Përmbledhje

Falë përpjekjeve avokuese të lëvizjeve të grave, qeveritë e Ballkanit Perëndimor kanë bërë ndryshime pozitive në vitet e fundit për sa i përket harmonizimit të legjislacionit mbi luftën kundër dhunës në familje me standardet e vendosura nga ligji ndërkombëtar. Kushtetutat ndalojnë torturën dhe trajtimet mizore dhe diskriminimin me bazë gjininë. Janë zhvilluar mekanizmat legjislacioni mbi barazisë gjinore dhe është bërë një lëvizje pozitive drejt penalizimit të rasteve të dhunës në familje. Të gjitha vendet e dënojnë dhunën në familje *ex officio*. Shumica e shteteve e kanë përkufizuar atë si një akt kriminal specifik. Pothuaj të gjitha vendet kanë adoptuar ligje specifike të mbrojtjes ndaj dhunës në familje. Nëse ndonjë armë zjarri përdoret në kësi rastesh, policia është e detyruar t'ia ndalojë armën personit. Gjykata mund të urdhërojë konfiskimin e armës së zjarrit si një masë mbrojtëse, por mund t'i kthehet dhunuesit nëse ai gjendet i pafajshëm apo nëse gjykimi pezullohet për mungesë provash. Përdorimi i armëve të zjarrit konsiderohet si rrethanë rënduese.

Sidoqoftë, ka mungesa të dukshme në zbatimin e legjislacionit. Ligje specifike mbi dhunën në familje e trajtojnë atë si shkelje ligji, duke krijuar një paqartësi kur vjen për të konsideruar nëse një rast është një akt minor apo një vepër penale. Dënimet për dhunuesit janë zakonisht të ulëta, gjykimet janë të gjata dhe masat e mbrojtjes jo të përshtatshme, Kështu që viktimat nuk janë të nxitura për të kërkuar drejtësi. Strehimoret, këshillimoret dhe shërbimet e tjera për viktimat ende sigurohen në masën më të madhe nga OJQ-të e grave. Qeveritë ende japin rrallë mbështetje për masat mbrojtëse dhe u kushtojnë pak vëmendje politikave parandaluese në këtë fushë, edhe pse janë miratuar strategji apo plane veprimi kombëtare. Mbledhja e të dhënave dhe monitorimi i tyre kryhet në më të shumtën e rasteve në mënyrë pjesore dhe sporadike pa pasur një qasje sistematike dhe uniforme.

## 4 Rregullat kombëtare për mbajtjen e AVL-ve nga ana e civilëve

### 4.1 Legjislacioni i përfutimit dhe zotërimit të armëve të zjarrit

Në vendet e Ballkanit Perëndimor, pajisja me AVL dhe marrja e tyre në pronësi rregullohet nga Ligjet përkatëse mbi Armët.<sup>48</sup> Legjislacioni<sup>49</sup> dikton kushtet për përfutimin, pasjen në pronësi dhe mbajtjen e një arme dhe municioneve nga civilët dhe personeli i kompanive private të sigurisë.<sup>50</sup> Vendet kanë dy lloje të ndryshme licencash për armët: një për pajisjen dhe një për pajisjen me armë dhe mbajtjen e tyre. Procesi i lëshimit të një licence përmban dy faza. Së pari një letër (licence) autorizimi për armë duhet të merret nga organizmat e autorizuar administrative të policisë, pas së cilës arma e zjarrit mund të përfutet për një periudhë të caktuar kohore. Arma e zjarrit duhet të regjistrohet pranë autoriteteve përkatëse policore brenda një numri të caktuar ditësh (zakonisht tetë) menjëherë pas pajisjes me të.

Shqipëria është i vetmi vend ku civilëve nuk u lejohet me ligj të mbajnë armë zjarri përveç armëve të gjuetisë. Personat e vetëm të cilëve u lejohet të mbajnë armë zjarri janë atë që mbajnë poste shtetërore apo partiake të përcaktuar në Ligjin për Armët. Pasi lëshojnë pozicionet këtyre zyrtareve u mohohet e drejta e mbajtjes së një arme zjarri dhe ata duhet ta kthejnë atë tek organizmat përkatës të rendit Publik.<sup>51</sup>

Një analize krahasuese mbi kërkesat për përfutimin e një licence tregon ndryshimet mes rregullave kombëtare në këtë fushë:

Mosha
Mosha minimale për të përfutur licencën për arme zjarri është 18 vjeç në IRJ të Maqedonisë, Serbisë dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, 21 vjeç në Mal të Zi dhe Kroaci dhe 22 vjeç në Shqipëri.
Gjendja shëndetësor e dhe mundësia për të pasur dhe mbajtur armë
Legjislacioni maqedonas, malazez, kroat, boshnjak dhe shqiptar kërkon që personi i cili bën kërkesë për një licencë të kalojë ekzaminimin mjekësor dhe të sigurojë të dhëna të mjaftueshme që provojnë shëndetin të mirë kjo e përpiluar në formën e një certifikatë mjekësore. Sidoqoftë nuk është gjithnjë i detyrueshëm një testim i gjendjes mendore dhe psikologjike nga ana e aplikuesit. Ministria e Shëndetësisë (së bashku me Ministrinë e Brendshme në IRJ të Maqedonisë dhe Kroaci) është e autorizuar të rregullojë llojin e ekzaminimit mjekësor dhe mënyrat nëpërmjet së cilave ai kryhet në mënyrë që të vlerësojë aftësinë e aplikuesve për të pasur në zotërim dhe mbajtur një armë zjarri, si dhe listën e sëmundjeve dhe gjendjeve shëndetësore e që në një farë mënyrë e bëjnë të pamundur pasjen në zotërim apo mbajtjen e një arme zjarri. Vetëm ligji shqiptar në mënyrë të qartë kërkon një certifikatë që vërteton se personi nuk ka probleme me shëndetin mendor, përveçse të qenit i shëndetshëm fizikisht. Në Serbi instituti kompetent për lëshimin e licencave kërkon për një certifikatë mjekësore vetëm nëse ngrihen dyshime gjatë procedurës së lëshimit të licencës për sa i përket mundësisë së aplikuesit për të përbaluar zotërimin e armës zjarrit. <sup>52</sup> Ligji i ri kroat mbi Armët ka një përmirësim nga ligji i mëparshëm nëpërmjet së cilit kërkon që autoritetet kompetente të kontrollojnë shëndetin e aplikuesit brenda periudhës që lëshohet licenca e armës së zjarrit. Certifikata mjekësore është e vlefshme vetëm pesë vjet dhe duhet të rinovohet nëse personi do të mbajë licencën e cila lëshohet për dhjetë vjet. Autoriteti përkatës merr vendimin përfundimtar nëse licenca mund të rinovohet ose jo.

<sup>48</sup> Për shkak të kompleksitetit të sistemit ligjor në Bosnjë dhe Hercegovinë në këtë vend ka ligje përkatëse në këtë fushë në Republika Srpska dhe Distriktin e Brçkos, dhe ligje në nivelin kantonal në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës. Në Kosovë, zotërimi i AVL-ve nga ana e civilëve rregullohet nga Rregullorja Nr. 2001/7 e UNMIK-ut.

<sup>49</sup> Në Kroaci, ligji i ri mbi Armët hyri në fuqi me 1 shtator të vitit 2007. Ai hedh poshtë disa rregullime si për shembull mundësinë për një bashkë-përdorim të armëve të zjarrit, që i është dhënë për momentin 5,000 personave. Licencat për armët që ruhen si 'kujtim nga lufta' do të hidhet poshtë gjithashtu dhe personat që mbajnë licenca të këtuja do të kenë në dispozicion një periudhë dymujore për ta bërë armën të pavlefshme, për ta regjistruar atë në përputhje me rregulloret për përfutimin e një licence të rregullt apo për t'ia shitur ose dhuruar Shtetit.

<sup>50</sup> Rregullimi i mbajtjes së armëve të zjarrit nga ana e ushtarakëve, policëve dhe anëtarëve të autoriteteve të Shtetit zakonisht rregullohet nën një ligj të veçantë.

<sup>51</sup> Për sa i përket rastit të Shqipërie, kërkesat e listuara në këtë kapitull të raportit, kanë lidhje vetëm me personat që janë të autorizuar të zotërojnë armët e zjarrit sipas Ligjit Shqiptar mbi Armët.

<sup>52</sup> Pas rastit të fundit të një vrasjeje masive nga ana e një personi me problem të shëndetit mendor në Serbinë lindore në gusht të vitit 2007, kjo masë është venë në diskutim dhe ka provokuar një debat publik mbi përfutimin dhe mbajtjen në zotërim të rregullore të armëve. Është ngritur kështu çështja e kontrollit të rreptë të lëshimit të licencave për të gjithë zotëruarit e armëve të cilët kanë një arme zjarri duke përfshirë këtu dhe një test psikologjik.

<b>Nuk ka të dhëna kriminale</b>
<p>Kjo kërkesë për përfitim e një licence me armë zjarri përshkruhet në të gjitha vendet ku është kryer kërkimi. Ka vetëm ndryshime të lehta në përshkrimin e këtij kushti nga ligji. Në IRJ të Maqedonisë një person që aplikon për licencë nuk duhet të përfaqësojë rrezik për publikun apo me fjalë të tjera nuk duhet të ketë qenë i dënuar për vepra penale apo për prishje të rendit publik dhe paqes me elemente dhune. Në Kroaci, një person mund të përfitojë një licencë në rast se siguron që nuk ka qenë i dënuar për vepra penale kundër jetës apo trupit ose për vepra të tjera me elemente dhune ose për krime të tjera të lehta d.m.th. që nuk janë ndërmarrë gjykime që tregojnë se ndonjë armë mund të jetë keqpërdorur. Ligji i Malit të Zi kërkon që një person nuk duhet të jetë dënuar për vepra të kryera në detyrë.</p> <p>Ligji serb i armëve dhe Municioneve liston veprat penale kryerja e së cilave çon në mohimin e aplikimit për licencë. Këto vepra penale nuk përfshijnë dhunën në familje në mënyrë të veçantë, megjithëse është bërë një vepër specifike penale sipas kodit penal. Sidoqoftë, mund të konsiderohet se autoritetet nuk do t'ia lëshojnë një licencë për armë një personi i cili ka qenë i dënuar për dhunë në familje pasi ky është një krim që dënohet ex officio. Për më tepër, veprat penale të listuara në Ligjin për Armët përfshijnë një sërë aktesh të cilat mund të lidhen me dhunën në familje siç janë për shembull, vrasja, lëndimet e renda trupore, lëndimet e lehta trupore, përdhunimi, vënia në rrezik e mbijetesës së dikujt nëpërmjet një armë të rrezikshme gjatë një përlëshjeje apo grindjeje dhe sjellja e dhunshme. Kërkesa për licencë mund të refuzohet nëse është e nevojshme për të mbrojtur sigurinë personale të personave të tjerë.</p> <p>Në Serbi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë një prej kushteve për të përftuar licencë është ai se personi nuk ka qenë i dënuar me burgim për shkelje ligji ose për akte të dhunshme duke shkelur Ligjin për Rendin dhe Qetësinë Publike në tre vitet e kaluara (në Serbi dhe Republika Srpska) apo pesë vitet e kaluara (në Kantonin e Sarajevës)</p> <p>Meqenëse dhuna në familje dënohet ex officio në të gjitha vendet ku është kryer kërkimi, mund të thuhet se licenca për të përftuar, pasur në përdorim dhe mbajtur një armë zjarri nuk u lëshohet personave që kanë qenë dënuar apo ndjekur për akte të dhunës në familje. Sidoqoftë, nëse një ndjekje penale ndalohet për shkak të rrethanave apo heqjes së denoncimit apo nëse i pandehuri gjykohet si i pafajshëm, licenca do të lëshohet.</p>
<b>Justifikimi i arsyes</b>
<p>Në Mal të Zi, Kroaci, IRJ të Maqedonisë dhe Bosnjë dhe Hercegovinë aplikuesi për një licencë duhet të provojë se ka arsye të justifikueshme për të përftuar dhe pasur në përdorim një armë zjarri. Në IRJ të Maqedonisë aplikuesi duhet të provojë se siguria personale apo siguria e familjes apo e pronës është nën kërcënim serioz ndërsa në Bosnjë dhe Hercegovinë e mjaftueshme është të përmendësh arsyem për të cilën kërkohet licenca që në raste shumë të rralla kërkohet nga policia. Në Kroaci dhe Kosovë, qytetarët mund të marrin lejen e përfutimit të një arme zjarri vetëm për qëllime vetëmbrojtjeje. Vulnerabiliteti i personit duhet të mbështetet në fakte që përfshijnë por nuk janë të kufizuara në informacionin që vjen nga raportet e policisë. Për më tepër në Kroaci, licencat mund të lëshohen për gueti dhe për qëllime në shënjestrë ndërsa në Kosovë për truporjat e regjistruara të dikujt</p>
<b>Nuk ka shënime për krijim problematikash në familje</b>
<p>Në Mal të Zi, Në Kroaci dhe Në IRJ të Maqedonisë legjislacioni parashikon se mund të provohet se nuk ka rrethana që tregojnë keqpërdorimin e armës së zjarrit duke përfshirë dhe të dhëna për shqetësim të renduar të marrëdhënieve familjare. Në IRJ të Maqedonisë, autoriteti që merret me këtë çështje është i detyruar të kërkojë në të dhënat nëse personi është regjistruar si shkakhtar i prishjes së marrëdhënieve në familje.</p>
<b>Njohuri teknike për përdorim të saktë, ruajtje dhe mirëmbajtje të armës, si dhe rregulloreve përkatëse</b>
<p>Në IRJ të Maqedonisë, mal të Zi, Kroaci dhe Serbi një aplikues duhet të provojë nëpërmjet një certifikate përballë institucionit kompetent se ai ka kaluar trajnimin për përdorim të saktë, ruajtje dhe mirëmbajtje të armës së zjarrit.</p>
<b>Të tjera</b>
<p>Ligji Serb ndalon dhënien e licencës personave mundësitë e të cilëve për të punuar janë të kufizuara. Në mënyrë të ngjashme në IRJ të Maqedonisë, kërkohet që personi të mos i ketë të kufizuara mundësitë apo aftësitë për të punuar. Kjo duhet provohet nëpërmjet një certifikate të lëshuar prej qendrës për punë sociale e bazuar në një vendim gjykatë. Për më tepër në IRJ të Maqedonisë një person duhet të provojë se ka një vendbanim në vend ose nëse janë të huaj kanë përftuar qëndrimin e përkohshëm.</p> <p>Data e skadimit të licencës së armës së zjarrit Në Mal të Zi dhe në Serbi është pesë vjet dhe në Kroaci dhe në IRJ të Maqedonisë dhjetë vjet (në IRJ të Maqedonisë pesë vjet për personat mbi 65 vjeç). Në Republika Srpska licenca e armës së zjarrit që lëshohet për mbrojtje personale është e vlefshme për pesë vjet ndërsa në rastet e tjera për një periudhë të pa caktuar. Në kantonet e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës licenca lëshohet për një periudhë të pa-caktuar. Vlefshmëria e periudhës së licencës së armës së zjarrit në Kosovë është më e shkurtra vetëm një vit.</p> <p>Bazuar në kërkesën e aplikuesit licenca mund të zgjatet për të njëjtën periudhë kohe nën të njëjtat kushte me të cilat ajo përfitohet herën e parë. Përpara zgjatjes së vlefshmërisë së licencës në IRJ të Maqedonisë, autoriteti përgjegjës duhet të kontrollojë kërkesën që aplikuesi nuk përben rrezik për rendin publik. Për më tepër, nëse personi është më shumë se 65 vjeç ai është i detyruar të dorëzojë një certifikate mjekësore të vlefshme për një vit.</p>

## Kontrollet e prapavijës

Analiza e legjislacionit të AVL-ve në Ballkanin Perëndimor tregon se të gjitha vendet kanë dhënë vendime gjykatë për vepra penale të dënuara ex officio për të mohuar një aplikim për licencën e armës së zjarrit ose për të konfiskuar një armë zjarri dhe licencën shoqëruese. Licenca nuk mund të lëshohet nëse është duke u kryer një hetim krimi kundër aplikuesit. Kështu, dhuna në familje si një vepër penale e dënueshme ex officio në të gjitha vendet e kërkit, është një pengesë për të përfutur dhe pasur në përdorim një armë zjarri. Për më tepër në Kroaci, IRJ të Maqedonisë dhe Mal të Zi ka një kusht shtese që aplikuesi nuk duhet të ketë shqetësuar në kushte renduese marrëdhëniet e familjes. Sidoqoftë siç tregon dhe kërkit kombëtar nuk ekziston një kontroll i saktë i prapavijës që mund të marrë në konsiderate incidentet me dhunën në familje që nuk kanë qenë të gjykuara nga gjykata si për shembull, paralajmërimet e dhëna etj. Procedura për kontrollet e prapavijës nuk përfshin gjithnjë njoftimet e anëtarëve të familjes gjatë procesit të aplikimit për licencën e armës së zjarrit. Kërkit në Bosnjë dhe Hercegovinë thekson se duke pasur parasysh faktin që një numër i vogël rastesh të dhunës në familje gjykohen nga gjykata, mund të nxirret si përfundim se shumica e shkaktesave të dhunës në familje janë në gjendje të përftojë një licence për armë zjarri. Në përgjithësi mund të bëheshin kontrolle më të rrepta në mënyrë që të reduktohej ndikimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje nëpërmjet kufizimit të numrit të armëve të zjarrit të dhëna në përdorim për civilët.

Ministria e Brendshme e IRJ të Maqedonisë kryen kontrolle të prapavijës për të vendosur nëse aplikuesi nuk përbën një kërcënim për rendin publik, por nuk ka informacion të vlefshëm nëse autoritetet përgjegjëse konsultojnë anëtarët e familjes si pjesë e këtij procesi.

Në Serbi, është praktike e policisë të flasë me fqinjët e aplikuesit, kolegët dhe anëtarët e familjes së tij. Në mënyrë të ngjashme në Shqipëri zyrtarët e policisë bëjnë kërkit mbi personalitetin e aplikuesit duke marrë në pyetje bashkëshortet/tët apo ish bashkëshortet/tët. Policia në Mal të Zi ka përdorur kohët e fundit një formë të re e cila lehtëson kontrollet e prapavijës duke njoftuar rregullisht organizmat administrative të autorizuar për lëshim licence rreth akteve kriminale të kryera dhe që janë dënuar ex officio, që përbejnë një pengesë për të përfutur licencën për armë zjarri.

Rregullorja e AVL-ve në Kosovë vendos procedurat e kontrollit të prapavijës që duhet kryer nga Policia e UNMIK-ut dhe KFOR-i. Ky investigim përfshin por nuk kufizohet në kontrollin e historisë penale të aplikuesit, duke përfshirë dhe investigimet e ndryshme penale; kontrollin e të dhënave për probleme të mundshme të shëndetit mendor që mund të ndikojnë përshtatshmërinë e aplikuesit për të mbajtur një armë zjarri; kontrollin e të dhënave të thirrjeve në polici për shkak të prishjes së rregullit nga ana e aplikuesit apo ndonjë denoncim për sjellje anti-shoqërore; kontrollin e të dhënave mbi rezistencën që mund të ketë bërë aplikuesi ndaj arrestimeve dhe të dhënat mbi historinë e sjelljes së dhunshme që mund të përfshijnë të dhëna mbi ndonjë akt të mundshëm të dhunës në familje.

Në të gjitha vendet me përjashtim të Kosovës, sipas rregulloreve të AVL-ve, organizmat e autorizuar shtetërore lëshojnë një letër autorizimi për aplikuesin për të pasur në përdorim një armë zjarri nëse ai e kalon kontrollin e prapavijës dhe përmbush të gjitha kërkesat e përshkruara nga ligji. Në Kosovë Kreu i policisë së UNMIK-ut ka një të drejtë të pakufizuar të mohojë aplikimin për një licencë. Ajo nuk do t'i lëshohet asnjë personi që për mendimin e Kreut të policisë nuk është i përshtatshëm të mbajë një armë zjarri për asnjë arsye, edhe pse ai i përmbush të gjitha parashikimet ligjore.

Rregulloret e AVL-ve përshkruajnë kushtet për konfiskimin e përkohshëm të armës së zjarrit, municioneve dhe licencës. Nëse ka filluar ndjekje penale kundër mbajtësit të licencës së një armë zjarri për kryerjen e një veprë penale apo shkelje ligji rendit dhe qetësisë publike me elemente dhune, autoritetet përkatëse vendosin për konfiskim të përkohshëm të licencës derisa të merret vendimi i gjyqit dhe të jete njoftuar përkatësisht gjykata.

Në të gjitha vendet e kërkit një vendim gjykatë për dhunë në familje përbën bazë për heqjen e licencës për armë zjarri dhe konfiskim të armës së zjarrit. Masat e përkohshme të mohimit të mbajtjes në përdorim të një armë zjarri nga një dhunues përdoren si masa mbrojtëse nga gjykata derisa të arrihet kushti për lëshim/refuzim të licencës së armës së zjarrit. Kjo mase merret nga gjykata gjatë procedimit penal dhe është e vlefshme deri në fund të gjykimit. Kjo mase do të jepet e përhershme nëse i pandehuri gjykohet fajtor dhe dënohet për vepër penale (në disa vende dhe për krime të lehta). Në Kroaci licenca hiqet nëse personi ka një histori sjelljesh të dhunshme, abuzive, alkoolizmi apo të tjera sjellje negative të ngjashme. Në Kosovë licenca mund të pezullohet



ose hiqet në çdo kohë nëse organizmi i autorizuar merr ndonjë informacion se sipas opinionit të Kreut të policisë së UNMIK-ut, ndikon aftësinë e mbajtësit të licencës për të pasur në përdorim një armë zjarri ose për çdo arsye tjetër. Në këtë rast arma e zjarrit konfiskohet. Raportimi për kërcënim me armë zjarri përbën arsye për konfiskim në Kosovë, Shqipëri dhe Kroaci. Sidoqoftë masat e përkohshme mbrojtëse që ndalojnë marrjen në përdorim apo ndalimin e përkohshëm të një arme zjarri nuk përbejnë bazë për refuzim të kërkesës për licencë.

### **Mbajtja ilegale e armëve të zjarrit në përdorim**

Në shumicën e vendeve të kërkimit, mbajtja ilegale e armëve të zjarrit në përdorim trajtohet njësoj si një shkelje e ligjit (ku trajtohet si shkelje e Ligjit mbi armët) dhe si vepër penale (që trajtohet nga Kodi Penal). Si shkelje ligji dënohet me gjobë (Kroaci<sup>53</sup>, Serbi<sup>54</sup>, Republika Srpska<sup>55</sup>) dhe/ose me burg nga 30 deri në 45 ditë në Kroaci deri në 60 ditë në Serbi dhe Republika Srpska.

Mbajtja ilegale dhe tregtia e armëve të zjarrit dënohet si vepër penale. Në Serbi dhe Mal të Zi dëbohet me burg deri në tre vjet; në IRJ të Maqedonisë dënimet janë shumë herë më të rrepta nga një deri në dhjetë vjet për vepra të lehta dhe nga minimumi pesë vjet nëse vepra përfshin një sasi të madhe armësh. Sipas opinionit të aktivisteve dhe eksperteve të OJQ-ve këto dënime nuk janë aq të rrepta sa duhet.

### **Marrëveshjet ndërkombëtare dhe Strategjitë Kombëtare**

Të gjitha vendet e rajonit janë zotuar kundrejt Programit të KB-ve për Veprimin mbi AVL-te.<sup>56</sup> Sipas kësaj një numër shtetesh kanë krijuar Komisionet Kombëtare mbi AVL-të dhe kanë zhvilluar ose janë në procesin e zhvillimit të Strategjisë Kombëtare përkatëse. Sidoqoftë siç thekson kërkimi kombëtar asnjë nga Strategjitë Kombëtare nuk përfshin ndonjë veprimtari apo aktivitet specifik gjinor apo ndonjë zgjidhje sistematike për reduktimin e përdorimit të AVL-ve në rastet e dhunës në familje. Nuk është përfshirë asnjë perspektive gjinore në Strategjitë kombëtare megjithëse ato theksojnë rëndësinë e kontrollit të AVL-ve për të përmirësuar sigurinë publike dhe personale.

## **4.2 Mekanizmat zbatues**

Ka një sere mekanizmesh shtetërore përgjegjës për zbatimin e rregullimit të AVL-ve. Përveç Ministrisë së Brendshme këto zakonisht përfshijnë ministrinë e Brendshme, ministrinë e Punëve të Jashtme dhe ministrinë e Integritit (përgjegjëse për harmonizimin me standardet e BE-së). Policia është autoriteti përgjegjës për zbatimin e legjislacionit.

### **Mbledhja dhe monitorimi i të dhënave**

Të dhënat mbi AVL-të më së shumti mblidhen nga regjistri që është një organizëm i autorizuar i Ministrisë së Brendshme. Ai lëshon materiale udhëzuese mbi mbajtjen e të dhënave mbi krimet e raportuar ndërsa ministria e drejtësisë lëshon materiale udhëzuese për regjistrimin e të dhënave mbi aktet kriminale dhe gjykimin e tyre nga gjykata dhe zyra e prokurorit. Statistikat konsiderohen të hapura për publikun dhe mund të sigurohen nga të gjithë personat që janë të interesuar. Ato publikohen në mënyrë periodike dhe janë të vlefshme nëpërmjet website-s së Ministrisë së Brendshme. të dhëna të veçanta për raste të veçanta mund tu jepen vetëm organizmave të autorizuarashtu siç përshkruhet Në Ligjin mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për sa i përket monitorimit të dhunës së armatosur, spitalet, mjeket e përgjithshëm dhe institucione të tjera të kujdesit shëndetësor janë të detyruara për të raportuar në Ministrinë e Brendshme të gjitha lëndimet e shkaktuara nga armët e vogla. Ministria e Brendshme mban një regjistrë për këto lloj lëndimesh, të cilat përditësohen rregullisht. Megjithëse statistikat mbahen nga një sere institucionesh përgjegjëse, nuk ka ndonjë sistem për t'i

<sup>53</sup> Deri Në 6,500 euro.

<sup>54</sup> Deri Në 50,000 RDS (gati 625 euro).

<sup>55</sup> Në Republika Srpska dhe Në shumicën e Kantoneve të Bosnjës dhe Hercegovinës, mbajtja ilegale e armëve të zjarrit Në përdorim trajtohet si një shkelje e ligjit .Vetëm Në Kantonin e Sarajevës ajo trajtohet si Vepër Penale dhe dënohet me burg deri Në një vit.

<sup>56</sup> Programi i KB-ve për Veprimin mbi Parandalimin, Luftimin dhe Eliminimin e Tregtisë së paligjshme të armëve të Vogla dhe të Lehta Në të gjitha Format e tij (UN Document A/CONF.192/15, <http://disarmament.un.org/cab/poa.html>, dokumenti është kontrolluar me 12 korrik 2007.



analizuar ato brenda një kornize të unifikuar. Nuk ka informacion të vlefshëm për burime financiare të caktuara për mbledhjen e të dhënave mbi dhunën Në familje.

Kërkimi kombëtar tregon se ka një nevojë të madhe për të përmirësuar mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave në mënyrë të veçantë për sa i përket viktimave dhe shoktareve të dhunës së armatosur në familje si dhe procedurave për të parandaluar dhunën e armatosur në familje, dënimin e dhunuesve dhe mbrojtjen e viktimave. Nevoja me e rëndësishme është sigurimi i një bazë të dhënash me të sakte dhe me të njësuar në nivel kombëtar në mënyrë që të përfshijë të dhëna përkatëse në drejtim të armëve të zjarrit dhe përfundimit të licencës, marrjen në përdorim dhe heqjen, duke përfshirë dhe të dhëna nga gjykatat. Në këtë drejtim, është veçanërisht e rëndësishme të sigurohet një bazë e përpiktë e të dhënave mbi veprat penale, të ndara sipas akteve specifike, duke përfshirë dhe dhunën në familje.

Monitorimi i legjislacionit dhe zbatimit të tij gjithashtu nuk bëhet gjithashtu në mënyrë sistematike. Bosnja dhe Hercegovina në mënyrë të veçantë përballlet me vështirësi dhe mungesa në këtë fushë për shkak të kompleksitetit të sistemit të vet ligjor dhe mos harmonizimit të ligjeve në nivele kantoniale dhe atyre të entiteteve. Ky vend nuk ka një sistem regjistrimi të njësuar mbi dhunën në familje. Sistemi duhet të përfshirë të dhëna të sakta dhe informacione prej të gjithë personave përkatës të interesit (gjykatat, policia, zyrtarët e prokurorëve, qendrat për punë sociale, institucionet e kujdesit shëndetësor, strehimoret, etj.). Kërkimi në Bosnjë dhe Hercegovinë zbulon se askush nuk e di se sa licenca armësh zjarri janë lëshuar në Bosnjë dhe Hercegovinë apo se sa armë zjarri mbahen në përdorim ilegal nga civilët.

Duke njohur këtë mungesë në këtë fushë disa nga vendet kanë krijuar aktivitete të cilat synojnë përmirësimin e mbledhjes dhe monitorimit të të dhënave. Në IRJ të Maqedonisë, pritet të fillojë së afërmi, funksionimin një sistem i ri regjistrimit dhe menaxhimit të armëve. Ai do të përmbajë të dhëna mbi lëshimin e licencave të armëve për individët. Ka pasur gjithashtu përpjekje për të përmirësuar regjistrimin e rasteve kriminale, raporteve të policisë dhe statistikave të gjykatës në Shqipëri. Kërkimi në Serbi vuri re se krijimi i Njësisë së Mjekësisë Ligjore të specializuar bë dokumentacionin e mjekësisë ligjore do të përmirësonte efektivitetin në dokumentimin e lëndimeve trupore në një sere rastesh kriminale. Një mbajtje me e mire e të dhënave mbi veprat penale dhe shkeljet e ligjit do të lejonte gjithashtu për një kontroll me të mire në lëshimin e licencave.

### 4.3 Përmbledhje

Në disa drejtime legjislacioni mbi përfundimin dhe marrjen në përdorim të AVL-ve në vendet e Ballkanit Perëndimor ka njohur çështjen e dhunës në familje. Një licence nuk duhet t'i lëshohet një personi i cili ka një historik krimesh, duke përfshirë dhe dhunën në familje dhe sjelljen e dhunshme në familje. Disa vende kërkojnë që aplikuesi të mos ketë histori të marrëdhënieve të shqetësuara në shkallë të lartë në familje. Gjithashtu kërkesat përfshijnë testin mjekësor, provën që justifikon arsyen e përfundimit të armës së zjarrit dhe njohuritë teknike për përdorimin dhe ruajtjen e sakte të armës së zjarrit. Ligji gjithashtu përfshin kontrollet e prapavijës.

Sidoqoftë, ka një numër gabimesh për sa i përket rregullimit të përfundimit të licencës së AVL-ve. Testi mjekësor mbi shëndetin mendor si dhe për njerëzit e varur nga alkooli dhe drogat nuk është i detyrueshëm në secilin vend. Kontrollet e prapavijës nuk përfshijnë në të gjitha rastet konsultime me anëtarët e familjes dhe ish partneret rreth sjelljeve të mundshme të dhunshme të aplikuesit. Këto kontrolle zakonisht kanë mungesë të udhëzimeve dhe procedurave të qarta. Mbajtja e armëve të zjarrit në mënyrë ilegale dënohet si vepër penale dhe si shkelje e ligjit.

Rregulloret e AVL-ve përshkruajnë kushtet për ndalimin e përkohshëm të armëve të zjarrit, municioneve dhe licencave. Nëse një akuzë kriminale lëshohet për pronarin e armës së zjarrit, arma do të konfiskohet deri në dhënien e vendimit nga gjykata. Një vendim gjykatë për dhunën në familje është baze për konfiskimin e armës së zjarrit dhe licencës. Masat e përkohshme për të ndaluar dhunuesin për të mbajtur një armë zjarri pendores si mase mbrojtëse nga gjykata deri sa të arrihen kërkesat për të lëshuar apo refuzuar një armë zjarri.

Duke qenë në të njëjtën linjë me Programin e Veprimit të KB-ve mbi AVL-të qeveritë kanë zhvilluar apo janë në procesin e zhvillimit plane veprimi kombëtare në fushën e kontrollit të AVL-ve. Sidoqoftë deri tani asnjë nga këto dokumente strategjike nuk është analizuar nga këndvështrimi gjinor dhe çështja e dhunës së armatosur në familje ka munguar. Ka gjithashtu mungesa të dukshme në mbledhjen e të dhënave, në regjistrimin dhe monitorimin në lidhje me zbatimin e legjislacionit të AVL-ve.

## 5 Lidhjet mes regjimeve të kontrollit të armëve të vogla dhe legjislacionit të dhunës në familje

### 5.1 Legjislacioni dhe praktika

Nuk ka lidhje të forta në secilin prej vendeve të kërkimit mes rregullimit të AVL-ve dhe parandalimit të dhunës në familje. Mungesa e të dhënave të besueshme dhe regjistrimeve rreth rasteve të dhunës në familje dhe përdorimit të AVL-ve Në sferën private pengon në mënyrë domethënëse përparimin e luftës kundra dhunës së armatosur në familje. Ekziston vetëm një kërkim specifik që flet për lidhjen mes regjimit të kontrollit të AVL-ve dhe legjislacionit të dhunës në familje i cili u zhvillua në Mal të Zi.<sup>57</sup>

Kërkimi kombëtar zbuloi së ekzistojnë lidhje mes këtyre dy kornizave ligjore dhe këto janë ne:

- a) Kërkesat ligjore të nevojshme për të përfutur një licencë për armë zjarri; dhe
- b) Baza ligjore për të ndaluar armët e zjarrit dhe/ose pezulluar licencën për armë zjarri.<sup>58</sup>

Ligjet kombëtare për të luftuar dhunën në familje dhe për të mbrojtur viktimat nuk thekson në mënyrë të fortë armët në përgjithësi dhe armët e zjarrit kur përkufizon masat mbrojtëse. Praktika me e mire gjendet ën Ligjin Shqiptar mbi masat kundër Dhunës në Marrëdhëniet në Familje. Ai i detyron oficeret e policisë të ndalojnë çdo armë që i përket një dhunuesi të kapur gjatë një kontrolli policor apo të urdhërojnë një dhunues të doreze çdo armë që ai zotëron.

Përdorimi i një arme duke përfshirë dhe një arme zjarri për të kërcënuar dhe dhunuar integritetin fizik të një anëtarit të familjes apo të çdo personi të përfshirë në marrëdhënie intime konsiderohet si një rrethanë renduese në procesin e gjyqimit të të pandehurit. Kërcënimi për të përdorur arme zjarri konsiderohet si një situatë renduese. Kodi penal shqiptar parashikon dënim me burg nga pesë deri në 15 vjet për krimin e 'sulmi seksual apo homoseksual nën kërcënimin e armëve të zjarrit'. Dënimet e përshkruara nga ligji janë shume herë me të ashpra në rastet e lëndimit dhe vdekjes. Për shembull, në Mal të Zi dhe Serbi nëse një dhunues ka përdorur arme zjarri ai duhet të dënohet me burg nga tre muaj në tre vjet dhe në raste fatale nga tre deri në 12 vjet. Sidoqoftë, sipas opinionëve të OJQ-ve të grave, ka një hapësirë boshe mes legjislacionit dhe praktikës. Përdorimi i armëve të zjarrit rrallë merret si një rrethanë renduese në procedimet penale në rastet e dhunës në familje, madje dhe atëherë dënimet mesatare janë të ulëta.<sup>59</sup>

Kërkimi i bere në gjithë rajonin tregon se ka një nevojë urgjente për të përmirësuar legjislacionin dhe praktiken e tanishme duke pasur parasysh uljen e përdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje. Për të arritur këtë qëllim, janë identifikuar një numër aktiviteteve si parakusht për të arritur këtë synim:

- a) Forcimi i aftësive të profesionistëve për të zbatuar në mënyrë korrekte legjislacionin specifik në fushën e dhunës në familje, veçanërisht në rastet kur rrezikohet të përdoren armët e zjarrit;
- b) Krijimi i strukturave të mirë informuara të mirë koordinuara dhe operative në mënyrë që të zbatojnë me mire legjislacionin ekzistues;
- c) Forcimi i oficerëve të policisë për të kryer kontrole gjithëpërfshirëse të prapavijës me qëllim, përpilimin e raporteve mbi karakterin e atyre që aplikojnë për licence të armëve të zjarrit.

Ka gjithashtu nevojë për të kryer ndryshime ligjore në mënyrë që të bëhet më e vështirë për individët zotërimi i armëve të zjarrit në përgjithësi. Disa nga këto kërkesa shtesë mund të jenë të kontrollit e detyrueshme të regjistrimeve mbi aktet e dhunës në familje, jo vetëm në gjykata, por gjithashtu dhe në policia, qendrat për punë sociale, mes anëtarëve të familjes, ish partnereve, fqinjëve etj., dhe kontrole të detyrueshme të regjistrimeve mbi

<sup>57</sup> Krkeljic, Ljiljana, Armët e Vogla dhe Dhuna e bazuar mbi gjininë në Mal të Zi – Një studim kërkimor, Podgorica: UNDP, 2007.

<sup>58</sup> Detaje të kriterëve për të përfutur licencën për arme zjarri dhe për të konfiskuar licencën për armë zjarri mund të gjenden në kapitullin 4, seksionin 4.1 Përfutimi i armëve dhe legjislacioni zotërimin të një arme zjarri.

<sup>59</sup> Sipas kërkimit kombëtar Në Serbi, dënimi mesatar për rastet e lëndimit të rende trupor do të ishte maksimumi një vit burg. OJQ-te e grave në Bosnjë dhe Hercegovinë vërejnë se rastet e dhunës në familje trajtohen me seriozitet vetëm kur shkaktohen dëme serioze për shëndetin e viktimës.

aktet kriminale që lidhen me aktet e dhunshme. Regjistrimet e rasteve të dhunës në familje duhet të shkëmbehen të të dyja procedurat juridike (penale dhe civile) në mënyrë që të parandalohet dhuna e mëtejshme. Kjo mund të bëhet duke krijuar një sistem special regjistrimi mbi dhunën në familje.

Sipas atyre që kanë dalë nga kërkimi kombëtar, mënyrat më të mira për të lidhur legjislacionin e dhunës në familje dhe rregullimin e AVL-ve janë si më poshtë:

- a) Zbatimi dhe marrëdhëniet korrekte mes ligjeve dhe rregulloreve për të dhënë lejen për të mbajtur armë zjarri dhe legjislacionit mbi dhunën në familje, në mënyrë që askush që ka histori të kryerjes së dhunës në familje të mos zotërojë një armë zjarri;
- b) Ngushtimi i kërkesave të licencës së armës së zjarrit. Duhet të jetë kërkesë gjithashtu marrja e opinionit nga (disa) anëtarë të familjes të cilët jetojnë me aplikuesin për licencë.
- c) Kufizimet e licencave për armët e zjarrit. (Ka rast në të cilat armët e zjarrit janë përdorur për rastet e dhunës në familje).
- d) Dënime më të ashpra në raste kur armët e zjarrit janë përdorur, për të kërcënuar, bërë presion apo dëmtuar viktimën. Çdo lloj abuzimi i armëve në dhunën në familje duhet të konsiderohet si rrethanë renduese dhe duhet rregulluar me ligj;
- e) Kryerja e fushatave të ndërgjegjësimit kundër mentalitetit të mbajtjes së armëve të zjarrit në shtëpi si dhe kundër 'kulturës së armëve'
- f) Kontrollë të vazhdueshëm mbi sjelljen e personave që kanë në pronësi dhe ose mbajnë armë zjarri në mënyrë të ligjshme;
- g) Testime të detyrueshme mjekësore të kushteve psikologjike të aplikuesve dhe personave që kanë licencë për armët e zjarrit.

Kriteri për të propozuar dhe vendosur masa të përkohshme për konfiskimin e armëve të zjarrit duhet të intensivkohet në mënyrë që të reduktohen rastet kur ndodh dhunë e armatosur në familje. P.sh., duhet të mundësohet urdhërimi i masave mbrojtëse në rastet e kërcënimit dhe nëse dhunuesi shfaq të dhëna të sjelljes së dhunshme apo nëse është i dhënë pas alkoolit apo narkotikëve. Procedurat për zbatimin e kësaj mase duhet të merren më me shpejtësi gjë që mund të kërkojë nga gjykatat që të lëshojnë masën pa pasur nevojë p.sh. për kërkesa dhe zbatim të menjëhershëm nga ana e policisë.

Për sa i përket praktikës gjyqësore nëse një armë zjarri ilegale përdoret në rastin e dhunës në familje përveç akuzës për rast dhunë në familje të dhunuesit ai akuzohet po ashtu për një zotërim të një arme ilegale. Kërkimi kombëtar tregon se legjislacioni penal zakonisht parashikon dënime më të ashpra për mbajtjen e armëve ilegale se sa për dhunën në familje. P.sh. në Mal të Zi dënimi për zotërim të një arme ilegale është burg deri në tre vjet, ndërsa për dhunën në familje dënimet janë gjoba ose burg deri në një vit. Nëse në këtë rast është përdorur armë zjarri dënimet shkojnë nga 3 muaj deri në tre vjet burg. Ashtu sikurse vihet re në kërkimin malazez praktika gjyqësore ndjek legjislacionin dhe dënime më të mëdha jepen për zotërim ilegal të armëve sesa për dhunën brenda familjes.<sup>60</sup> Kërkimi kroat tregon se në këndvështrimin e prokurorëve dhe gjykatësve krimi i zotërimit ilegal të një arme konsiderohet se ka të njëjtën peshë sikurse dhe ai i dhunës në familje.

## 5.2 Hapësirat dhe praktikat e mira

### Hapësirat

Sfida më domethënëse që minon luftën për ti dhënë fund dhunës në familje në Ballkanin Perëndimor është hapësira mes legjislacionit dhe përkushtimeve qeveritare. Parashikimet ligjore përkatëse shpesh nuk zbatohen, nuk zbatohen në mënyrë të saktë apo nuk interpretohen në mënyrë të saktë nga qeveria dhe institucionet shtetërore përkatëse (policia, gjykatat, prokurorët, qendrat për punë sociale etj.). Të gjitha vendet e rajonit kanë mungesë porsa i përket për sa i përket planeve të veprimit apo strategjive kombëtare efektive për të luftuar dhunën në familje dhe në mënyrë të veçantë dhunën e armatosur në familje. Përveç përparimeve të fundit në

<sup>60</sup> Për shembull në 25 rastet e dhunës në familje, gjykata në Podgoricë të Malit të Zi ka dhënë vetëm 6 dënime me burg, ndërsa pjesa tjetër u quajtën të pafajshëm apo u pezullua gjykimi.

zhvillimin e kornizave ligjore që synojnë eliminimin e dhunës në familje, ligjet nuk mbështeten nga politika të qarta në të gjitha nivel që përfshijnë gjithë aktorët përkatës.

Në përgjithësi ka mungesë të mbështetjes buxhetore për zbatimin e legjislacionit dhe masave ligjore dhe politike e shoqëruar kjo me mungesën e trajnimit profesional në këtë pikë. Në disa vende siç është Bosnja dhe Hercegovina çështja e dhunës në familje vazhdon të injorohet krejtësisht nga të gjithë institucionet përkatëse megjithëse janë miratuar ligje specifike për dhunën në familje. Qeverive ende u mungon ndjeshmëria në njohjen e rasteve të dhunës në familje si çështje që përbën shqetësim për to së bashku me lidhjet që ka ajo me përhapjen e armëve të zjarrit.

Për më tepër ka ende hapësira si në kornizën ligjore që rregullon dhunën në familje dhe zotërimin e armëve të zjarrit dhe në zbatimin e tyre. Kjo është veçanërisht e dukshme në nivelet e mëposhtme:

- a) *Zbatimi në përgjithësi i masave të mbrojtjes së përkohshme*: Qeveritë rrallë bëjnë përpjekje për të krijuar apo mbështetur kushtet për zbatimin e masave mbrojtëse që kërkojnë investime dhe burime siç janë strehimoret dhe mbështetje e përkohshme financiare; zyrtarët e policisë, prokurorët, gjykatësit dhe zyrtarët e tjerë nuk janë gjithmonë të vetëdijshëm mbi nevojat për mbrojtje të viktimave; viktimat nuk janë gjithmonë dhe saktësisht të informuara paraprakisht mbi mundësinë për të kërkuar masa të caktuara mbrojtëse; ka mungesë të masave efektive mbrojtëse gjatë gjykimeve penale; barra e provës bie mbi viktimat, ka mungesë të procedurave të shpejta të mbrojtjes duke përfshirë dhe rastet gjatë procedimeve penale;
- b) *Zbatimi i masave mbrojtëse për konfiskimin e armës së zjarrit dhe ose mohimin e licencës së armës së zjarrit*;
- c) *si rregull gjykata dhe policia nuk kryejnë kontrole të detyrueshme për të parë nëse dhunuesi zotëron apo ka nën kontroll një armë zjarri ilegale*; armët e zjarrit konfiskohen kur viktimat apo dikush tjetër raporton mbi përbormin e tyre; procedimi penal është i ngadaltë dhe nuk garanton sigurinë e viktimës; zbatimi i urdhrave të gjykatës është i ngadaltë; arma e zjarrit i kthehet shkelësit të ligjit nëse procedimi pezullohet për shkak të mungesës së fakteve;
- d) *dënimi i shkelësit të ligjit*: nëse dhuna në familje konsiderohet në të njëjtën kohë si vepër penale dhe si shkelje ligji kjo sjell paqartësi ligjore në përkufizimin e rasteve kur ajo duhet konsideruar si vepër penale dhe kur si një shkelje e lehtë e ligjit. Në këtë rast, prokurorët publikë e kanë të vështirë të identifikojnë nëse aktet kualifikohen si dhunë në familje, d.m.th. kur akti së qeni i kualifikuar si shkelje e lehtë e ligjit dhe kur ai bëhet vepër penale. Praktikant tregojnë se prokurorët më së shumti e konsiderojnë dhunë në familje si një shkelje të lehtë të ligjit dhe kështu u japin dhunuesve dënime më të lehta; gjykatat nuk e konsiderojnë gjithmonë rrethanë rënduese përdorimin e armës së zjarrit për të bërë presion viktimës;
- e) *zbatimi dhe interpretimi nga profesionistët*: ka mungesë profesionistësh të kualifikuar të cilët merren me rastet dhe viktimat e dhunës në familje; mungesë e njësive speciale të policisë; mungesë e oficerëve gra të policisë; mungesë e një ndjeshmërie gjinore ndërmjet profesionistëve; mungesë e procedurave efektive të policisë në drejtim të dhunës së armatosur në familje; mungesë e koordinimit ndërmjet gjithë aktorëve dhe institucione përkatëse dhe mungesë e akteve ligjore plotësuese për sa i përket procedimit nga institucionet përkatëse;
- f) *zbatimi i parashikimeve ligjore që lidhen me kërkesat për lëshimin e licencës së armës së zjarrit*; mungojnë udhëzimet e qarta se si policia duhet të kryejë kontrollet e prapavijës në lidhje me aplikuesin; ish bashkëshortët ose partnerët nuk përfshihen në këtë kërkim;
- g) *zbatimi i ligjeve nëse dhunuesit janë zyrtarë të policisë, të forcave ushtarake apo të institucioneve të tjera shtetërore, të cilët e kanë të lejuar të mbajnë armë zjarri*; ka një tendencë për të neglizhuar për të mos i shprehur hapur aktet e dhunës në familje nëse ato kryhen nga zyrtarë të shtetit; nuk ka të dhëna të mjaftueshme për aktet e dhunës në familje nga oficerët e policisë dhe ushtrisë (për këtë arsye nuk është e mundur të vlerësohet niveli i rasteve të dhunës në familje në shtëpitë e tyre); ka mungesë të programeve mbështetës psikologjike që do ndihmonin këta zyrtarë që t'ia dalin mbanë ndikimeve negative që rrisin dhunën si p.sh. stresi dhe ekspozimi ndaj traumave;
- h) *parandalimi*; nuk ka programe rehabilitimi për shkelësit e ligjit; mungesa e të dhënave për përdorimin e armëve të zjarrit për dhunën në familje; mungesë e statistikave dhe harmonizimit të regjistrimit në sistemin juridik dhe institucioneve të tjera qeverisëse si në nivelin vendor ashtu dhe në atë kombëtar;

mungesë e kërkimeve dhe studimeve; mungesë e fushatave të ndërgjegjësimit; mungesë e programeve arsimore mbi të drejtat e njeriut, të drejtat e grave, barazisë gjinore, zgjidhjes së paqte të konfliktit dhe mungesë të fushatave kundër kulturës së dhunës.

Kërkimi kombëtar tregon se një numër hapësirash të shënuara më lart vijnë si rezultat i mungesës së rregulloreve dhe institucioneve të nevojshme për zbatimin e legjislacionit të dhunës në familje si dhe të mungesës së politikave të qarta ndërsektoriale, mbështetjes buxhetore dhe personelit të trajnuar.

Për sa i përket çështjes së dhunës në familje janë evidentuar hapësirat e mëposhtme në legjislacionin e armëve të zjarrit:

- a) kontrollet mjekësore jo gjithmonë përfshijnë ekzaminimin e shëndetit mendor apo kontrollin psikologjik të aplikuesit;
- b) nuk ekziston kontrolli mjekësor i detyrueshëm duke përfshirë dhe kontrollin psikologjik gjatë periudhës që është e vlefshme licenca e armës së zjarrit<sup>61</sup>;
- c) periudha e vlefshmërisë së armës së zjarrit është zakonisht shumë e gjatë (5 vjet ose më shumë);
- d) nuk është gjithmonë i detyrueshëm kërkimi i prapavijës për marrëdhëniet në familje; mungojnë udhëzimet e qarta se si ai duhet kryer dhe cilët persona duhen përfshirë në të;
- e) mungojnë bazat e të dhënave të sakta dhe ta unifikuara të cilët përfshijnë të dhëna jo vetëm nga gjykata dhe policia por gjithashtu dhe nga institucionet e kujdesit shëndetësor dhe qendrat për punë sociale;
- f) mungojnë kontrollet e detyruara të prapavijës për arsyen që jepet nga aplikuesi e cila justifikon nevojën për të zotëruar dhe ose mbajtur një armë zjarri; shumë rrallë policia kërkon mbi vlefshmërinë e arsyes së dhënë;
- g) kontrolli mbi civilët që kanë në pronësi një armë zjarri është i pamjaftueshëm;
- h) dënimet për zotërimin ilegal të armëve të zjarrit janë të ulëta;
- i) nuk ka kufizime mbi numrin e armëve të zjarrit të zotëruara nga një individ në asnjë nga vendet e kërkimit.

## Praktikat e mira

Një nga masat mbrojtëse më të rëndësishme për sa i përket luftimit të dhunës në familje është konfiskimi i detyrueshëm i armëve të përdorura në rastet e dhunës së armatosur në familje si një urdhër mbrojtës emergjent i zbatuar në Shqipëri nga ligji i miratuar kohët e fundit mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje.

Në Kosovë licenca nuk i lëshohet një personi i cili ka historik të sjelljeve të dhunshme duke përfshirë dhe dhunën në familje. Gjithashtu pengesë për përfitim të licencës përbën historiku i problemeve të shëndetit mendor. Në Kroaci, IRJ të Maqedonisë dhe Mal të Zi, policia duhet të sigurohet se nuk ekzistojnë rrethana që tregojnë keqpërdorimin e armëve të zjarrit duke përfshirë prishjen në raste të rënduara të rasteve familjare. një formë e re mbi raportimin e rasteve kriminale të dënuara *ex officio* është zbatuar Në Mal të Zi gjë që lehtëson kontrollet e prapavijës mbi mundësinë nëse shkelësi i ligjit që zotëron armë zjarri ka historik familjar, etj.

Ligji i adoptuar mbi armët në Kroaci, ka përfshirë kontrollin mjekësor të detyrueshëm për individët të cilët kanë licenca për armë zjarri brenda periudhës së vlefshmërisë së licencës. Vlefshmëria e licencës është 10 vjet, ndërsa kontrolli mjekësor është i vlefshëm për 5 vjet. Për më tepër në Kroaci historikët e krimeve kanë përfshirë në bazat e të dhënave nga oficerët e policisë nga të gjitha stacionet e policisë si dhe nga të gjitha departamentet speciale të drejtorive të përgjithshme të policisë. Të dhënat e përpiluar në nivel kombëtar përdorin praktika të njëjta për sa i përket regjistrimit të të dhënave mbi krimin në të gjithë vendit. Sistemi i informacionit të policisë kroate ofron një nivel të pazakontë detajesh mbi dhunën e armatosur. Sistemi i informacionit përmban të dhëna të cilat kanë informacion që prej 30 vjetësh më parë gjë që mundëson analizimin e faktorëve të mëposhtëm: sa nga numri total i secilit nga llojet e krimit përfshin AVL-të; cila gjini është më së shumti viktimë apo dhunues; cila grup-moshë është më shpesh viktime apo dhunues; nëse krimet janë pak a shumë të përhapura mes personave me të ardhura të ulëta grupeve etnike, refugjatëve apo grupeve të tjera; çfarë lloj arme është me shumë e përdorur

<sup>61</sup> Përveçse në Kroaci ku licenca është e vlefshme për 10 vjet dhe kontrolli mjekësor është i vlefshëm për 5 vjet.

për secilin nga llojet e ndryshme të krimit; sa krime kanë qenë rezultat i llojeve të ndryshme të incidenteve; në cilën zonë janë më të përhapura krimet që kanë lidhje me armët e zjarrit; në cilat vendndodhje ka më shumë gjasa të ndodhin krimet (shtëpi, vendi i punës, shkollë e tij); në cilën periudhë të ditës/javës/muajit/vitit ka më shumë gjasa të ndodhin krimet; cilat janë variacionet në llojet e krimeve që ndodhin në vende të ndryshme dhe nëse rastet e krimeve që kanë të bëjnë me armët e zjarrit lidhen me abuzimin e substancave të veçanta.

### 5.3 Propozimet ekzistuese për ndryshimet ligjore dhe strategjike

Deri më sot si qeveritë ashtu dhe OJQ-të në rajon kanë mungesë ndërgjegjësimi për sa i përket ndërlidhjes që ekziston mes përhapjes së armëve të zjarrit dhe dhunës në sferën private, si rrjedhojë është bërë vetëm një propozim për ndryshim ligjor që lidhte legjislationet në këto dy fusha me qëllim, rritjen e sigurisë personale dhe uljen e dhunës në familje. Kjo ka qenë një nismë e filluar nga Victimology Society në Serbi në vitin Në 1989. Kjo OJQ ka zhvilluar dhe futur për herë të parë nja model të ri të mbrojtjes ligjore kundër dhunës në familje e cila përfshin një propozim për të çmënuar Ligjin mbi Armët dhe municionet. U propozua refuzimi i aplikimit për licencë të armëve të zjarrit atëherë kur ky refuzim është i domosdoshëm për të ruajtur sigurinë personale apo anëtarët e familjes ose, kërkohet nga një anëtar i familjes i cili është ose ka qenë viktime e dhunës. Kjo nismë u prezantua në publik gjatë një debati publik rreth modelit të ri të propozuar të mbrojtjes kundra dhunës në familje por që ende nuk është miratuar nga qeveria.

Kohët e fundit janë bërë propozime për ndryshime ligjore që kanë të bëjnë me dhunën në familje në Republika Sërpska, por ato nuk kanë të bëjnë më lidhjen e regjimit të AVL-ve me legjislationin e dhunës në familje. Në korrik 2007, OJQ-të e grave dhe Asambleja e qytetarëve të Helsinkit të Banja Lukës i dorëzuan Qendrës Gjinore dhe Ministrisë së Drejtësisë propozimet e tyre mbi ndryshimin e ligjit mbi mbrojtjen nga dhuna në familje. Propozimet e tyre përfshijnë ndërmjet të tjerash heqjen nga ligji të parashikimeve që e përkufizojnë dhunën në familje si akt të shkeljes së ligjit. Për tu siguruar që policia apo punonjësit sociale shoqërojnë dhe vendosin viktimën në strehimore dhe për ti mundësuar viktimës të zgjasë qëndrimin në strehimore nën kushte të veçanta apo derisa të mbarojë gjykimi. Qeveria e Republika Sërpska-s gjithashtu ka dorëzuar një draft në parlament mbi ndryshimet e legjislationit të dhunës në familje. Ndryshimet më të rëndësishme të propozuara lidhen me financimin e strehimoreve nga ana e buxheteve të komunës dhe qytetit duke filluar nga viti 2009, ndërkohë që në periudhën tranzitore nga vit 2007-2008, strehimoret do të financohen nga qeverisja e entitetit.

### 5.4 Përmbledhje

Vendet në Ballkanin Perëndimor kanë mungesë kërkimi mbi lidhjet mes regjimeve të AVL-ve dhe legjislationit të dhunës në familje. Analiza mbi legjislationin mbi këto dy fusha ka treguar se mund të gjenden pika kontakti në kërkesat ligjore të nevojshme për të përfutur licencën e armës së zjarrit dhe bazat ligjore për të ndaluar armët e zjarrit dhe ose për të pezulluar licencën e armëve të zjarrit. Rregulloret kombëtare të AVL-ve kërkojnë që personi i cili aplikon për një licencë të armës sa zjarrit të mos këtë historik kriminal duke përfshirë këtu dhe histori kriminale të dhunës në familje. Përdorimi i një arme duke përfshirë këtu dhe përdorimin e armës së zjarrit për të kërcënuar dhe dhunuar integritetin fizik të një anëtar i familjes apo ndonjë personi tjetër të përfshirë në marrëdhënie intime konsiderohet si një rrethanë rënduese në dhënien e dënimit.

Përparimet e dukshme për zhvillimin e kornizës ligjore për të luftuar dhunën në familje janë penguar nga hapësirat mes legjislationit dhe zbatimit të tij. Parashikimet ligjore në mënyrë të veçantë ato që lidhen me mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës së armatosur në familje shpesh nuk zbatohen nga institucionet përkatëse shtetërore. Për më tepër ka një mungesë të mbështetjes buxhetore për zbatimin e masave politike dhe ligjore e shoqëruar kjo me një mungesë të trajnimit të profesionistëve në këtë fushë.

Kërkimi kombëtar tregon se ekziston nevoja për të përmirësuar legjislationin dhe praktikën aktuale që ka të bëjë me zvogëlimin e përdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje. Aftësitë e profesionistëve duhet të përforcohen në mënyrë që të përmirësohet zbatimi i legjislationit specifik mbi dhunën e armatosur në familje. Policia duhet të fuqizohet në mënyrë që të ndërmarrë kontrolle të qarta të prapavijës me qëllim përgatitjen e raporteve që vlerësojnë përshtatshmërinë e karakterit të aplikuesit për licencën e armës së zjarrit. Kushtet për të përfutur licencën e armës së zjarrit duhet të jenë më të rrepta në mënyrë që të parandalohet keqpërdorimi i tyre. Qeveritë duhet të jenë më të përgjegjshme në zbatimin e legjislationit, dënimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit, kryerjen e fushatave të ndërgjegjësimit dhe ndërmarrjen e ndryshimeve ligjore. Aktualisht nuk ka propozim apo nismë për ndryshim ligjor dhe politik në këto fusha në rajon.



## 6 Përfundime

Përhapja dhe gjetja e lehtë e AVL-ve në Ballkanin Perëndimor si pasojë e konflikteve të kohëve të fundit e një historie të trazuar dhe traditës së 'kulturës së armëve' kanë ndikuar në dhunën pasigurinë dhe krimin si në aspektin publik dhe atë private. Dhuna në familje është forma më e përhapur e dhunës në të gjithë vendet e rajonit dhe numri i këtyre rasteve vazhdon të ngrihet. Si përdorimi i AVL-ve ashtu dhe dhuna na familje konsiderohet si fenomen i orientuar nga përkatësia gjinore; pronarët e AVL-ve dhe shkaktarët e rasteve të dhunës në familje janë përgjithësisht burrat ndërsa viktimat përgjithësisht gratë;

Në vitet e fundit, vendet e rajonit kanë bërë disa përpjekje në zbatimin e disa standardeve ndërkombëtare në fushën e luftimit të dhunës në familje. Të gjitha vendet tani dënojnë atë *ex officio*. Pjesa më e madhe e tyre kanë adoptuar ligje specifike ndërkohë që janë zhvilluar strategji dhe planë kombëtare veprimi. Janë parashikuar me ligji masa që synojnë mbrojtjen e viktimave siç mund të përmendim urdhrat e gjykatave. Zyrtarët shtetërorë janë të detyruar të raportojnë dhunën në familje dhe të mbrojnë viktimat.

Sidoqoftë zbatimi i plotë i legjislacionin pengohet nga mungesa e politikave që merren me dhunën në familje zhvillimin e pamjaftueshëm institucional në këtë fushë dhe një mbështetje e kufizuar për OJQ-të që merren me dhunën në familje. Strehimoret, këshillimoret dhe shërbimet e tjera për mbrojtjen e viktimës ende në masën më të madhe sigurohen nga OJQ-të. Qeveritë bëjnë përpjekje shumë të vogla sistematike për të ndërmarrë masa parandaluese si për shembull fushatat e ndërgjegjësimit, programet arsimore për të rinjtë dhe trajnimi për profesionistët. Nuk ekzistojnë programet rehabilituese të institucionalizuar për shkelësit e ligjit. Ende bashkëpunimi ndërmjet agjencive nuk është i koordinuar mirë. Planet e veprimit kombëtare dhe strategjitë ose nuk janë adoptuar ose, ku ato ekzistojnë ose nuk janë zbatuar ose mbështeten dobët. Ka mungesë të mbledhjes sistematike të të dhënave, kërkimit dhe monitorimit në mënyrë të veçantë porsa i përket dhunës së armatosur në familje. OJQ-të e grave.

Pika ekzistuese të kontaktit mbi AVL-të dhe dhunën në familje lidhen me kërkesat ligjore të nevojshme për të përftuar licencën e armës së zjarrit si dhe bazat ligjore për ndalimin e armëve të zjarrit dhe, ose heqja e licencës së armës së zjarrit. Për sa i përket anës pozitive rregullore kombëtare mbi AVL-të diktojnë që një person i cili aplikon për licencë të armës së zjarrit nuk duhet të ketë qenë i ndjekur ose i dënuar për vepra penale, duke përfshirë këtu dhunën në familje dhe sjelljet e dhunshme. Për më tepër, ligjet në Mal të Zi, Kroaci dhe IRJ të Maqedonisë kërkojnë që aplikuesit të mos kenë kryer prishje të rëndë të marrëdhënieve të familjes. Kontrolli mjekësor i shëndetit mendor, provat e justifikuar e arsyes për të përftuar një armë zjarri dhe certifikata që deklarohen se aplikuesi ka njohuri teknike për përdorimi dhe ruajtjen e saktë të armës së zjarrit nuk përshkruhen si kërkesa për të përftuar një licencë. Kontrollat e prapavijës nuk përfshijnë në ta gjitha rastet konsultimet me anëtarët e familjes ish partnerët dhe fqinjët rreth sjelljeve të dhunshme të aplikuesit apo abuzimit të alkoolit apo të narkotikëve. Praktika tregon se kontrollat e prapavijës nuk kryhen gjithnjë ashtu siç duhet dhe se ato kanë mungesa të qarta të udhëzimeve dhe procedurave.

Sfida më e dukshme që pengon luftën e dhënies fund të dhunës në familje është hapësira mes legjislacionit dhe përkushtimeve të qeverisë. Shembulli më alarmant vjen nga Bosnja dhe Hercegovina ku çështja e dhunës së armatosur në familje injorohet krejtësisht nga institucionet përkatëse megjithëse është adoptuar legjislacioni specifik mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje.

Në proceset penale përdorimi i një arme zjarri për të kërcënuar dhe dhunuar integritetin fizik të një anëtari të familjes apo të çdo personi tjetër të përfshirë në një marrëdhënie intime konsiderohet si rrethanë rënduese. Megjithatë dënimet për këto krime janë zakonisht të ulëta. Në shumicën e vendeve gjykatat mund ti ndalojnë armën dhe ti heqin licencën dhunuesit të ligjit. Sidoqoftë nëse një rast rezulton i pafajshëm apo vendimi tërhiqet për shkak të mungesës së të dhënave arma e zjarrit e ndaluar i kthehet pronarit. Kërkimi kombëtar tregon se procedimet penale në rastet e dhunës në familje nuk janë mjaftueshëm të shpejta e të sigurta; masat mbrojtëse urdhërohen rrallë ose nuk janë efektive dhe dënimet janë zakonisht të ulëta. Të gjitha këto shkurajojnë viktimat për të pasur qasje në sistemin e drejtësisë dhe për të kërkuar mbrojtje.

Qeveritë rrallë bëjnë përpjekje për të krijuar apo mbështetur kushtet e zbatimit të masave mbrojtëse që kërkojnë investime dhe burime siç janë për shembull strehimoret dhe trajtimet e detyrueshme për dhunuesit të cilët kanë probleme me varësinë. Oficerët e policisë, gjykatësit, prokurorët dhe zyrtarët e tjerë nuk janë gjithmonë të



ndërgjegjshëm për nevojat që kanë viktimat për tu mbrojtur prej dhunuesve. Zyrtarët jo gjithmonë kontrollojnë nëse dhunuesi ka në pronësi ndonjë armë zjarri ilegale. Viktimat nuk janë gjithmonë dhe, ose saktësisht të informuara mbi të drejtat e tyre për të kërkuar masa mbrojtëse.

Në vendet në të cilat dhuna në familje konsiderohet qoftë si vepër penale qoftë si shkelje ligji prokurorët publikë kanë vështirësi për të kualifikuar aktet e dhunës në familje, d.m.th. për të përcaktuar nëse dhuna në familje duhet të ndalohej së klasifikuari si shkelje e lehtë e ligjit dhe të konsiderohet të vepër penale. Praktika e prokurorëve është që ta konsiderojnë atë më shpesh si shkelje e lehtë e ligjit gjë që rezulton në dhënien e dënimeve më të lehta. Këto hapësira kryesisht shkaktohen nga mungesa e përpjekjeve të qarta dhe sistematike të qeverive për të ndërmarrë masa të përgjithshme mbrojtëse lidhur me dhunën e armatosur në familje. Si rezultat i kësaj ekziston një listë e gjatë e hapësirave në të gjithë vendet e kërkimit. Ato përfshijnë mungesën e profesionistëve të trajnuar dhe të ndjeshëm për sa i përket çështjeve gjinore; mungesës së një njësie policie të dedikuar ndaj saj; mungesa e oficerëve femra të policisë; mungesa e protokolleve efektive të policisë që merren me dhunën e armatosur në familje; mungesë e koordinimit mes aktorëve dhe institucioneve përkatëse dhe mungesa e akteve ligjore shtesë për procedim nga ana e institucioneve përkatëse.

Shtetet tentojnë të neglizhojnë dhe, ose shmangin regjistrimin e akteve të dhunës në familje nëse ato kryhen nga oficerët e policisë dhe forcave të armatosura, profesionet e të cilëve i lejojnë ata të zotërojnë një armë zjarri. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme rreth akteve të dhunës në familjet e tyre. Për këtë arsye mbetet i panjohur niveli i rasteve të dhunës në familje, gjithashtu ato mbeten jashtë hapësirës së mbrojtjes dhe politikave parandaluese.

Janë evidentuar hapësira gjithashtu në regjimin e kontrollit të AVL-ve. Kontrollat mjekësore për përfundimin e licencës së armës së zjarrit nuk përfshijnë gjithmonë ekzaminimin e shëndetit mendor apo kontrollin psikologjik. Periudha në të cilën është e vlefshme licenca e armës së zjarrit është zakonisht shumë e gjatë (5 vjet ose më shumë). Nuk ka bazë të dhënash të përpiktë dhe të unifikuar në asnjë nga vendet në mënyrë të tillë që të përfshijë të dhëna nga gjykata dhe policia si dhe nga institucionet e kujdesit shëndetësor dhe qendrat për punë sociale. Planet e veprimit kombëtar për përparimin e grave dhe barazinë gjinore dhe ato për luftën e dhunës në familje, aty ku ekzistojnë nuk cekin çështjen e kontrollit të armëve. Kjo çështje nuk ka qenë në axhendën e asnjë mekanizmi për barazi gjinore të asnjërit prej vendeve të këtij kërkimi.

Qeveritë duhet të bëjnë më shumë përpjekje për të mbushur këto hapësira dhe për të zhvilluar politika dhe masa efektive që do t'i jepnin fund të gjitha formave të dhunës, përfshi këtu dhunën në familje. Lidhja e këtyre politikave me regjimet e kontrollit të AVL-ve do të ndihmonte në kuptimin më të mirë të shkaqeve të dhunës dhe do të përcaktonte strategjinë më të mira për reduktimin e dhunës.

## 7 Rekomandime për Qeveritë

Ndërsa shumë prej qeverive të rajonit kanë bërë përparime në vitet e fundit për sa i përket përmirësimit të kornizës ligjore që rregullon si zotërimin e armëve të zjarrit ashtu dhe dhunën në familje, ka ende shumë për të bërë. Më poshtë po japim rekomandimet e përgjithshme që mund të merren parasysh nga vendet e rajonit në varësi të nivelit të përparimit të tyre. Kapitulli 9-të përmban një përmbledhje të përfundimeve specifike për çdo vend dhe rekomandime për qeveritë.

### Strategjitë kombëtare dhe politikat e përgjithshme

- Duhet të njohin se dhuna në familje është një formë specifike e dhunës me bazë gjinore që i pengon gratë të gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut; që ajo është një çështje që i shqetëson të gjithë dhe që kërkon ndërhyrje nga autoritetet publike.
- Të përdorin standardet ndërkombëtare në këtë fushë (KB, KE, BE, dhe OSBE) dhe të praktikojnë më të mira globale si gurët e themelit për draftimin, miratimin dhe zbatimin e legjislacionit të saktë, politikave ndërsektoriale dhe praktikave të gjykatës dhe policisë. Nuk duhet të ketë përjashtime ligjore apo privilegje që lejojnë ndonjë lloj dhunë apo kërcënimi për dhunë brenda familjes dhe marrëdhënieve intime.
- Të zhvillojnë dhe adoptojnë strategji dhe plane veprimi të sakta dhe efektive për të parandaluar dhunën në familje duke përfshirë dhunën e armatosur dhe të mbrojnë viktimat në nivel kombëtar dhe vendor. Të sigurojnë monitorim dhe rishikim sistematik të planeve dhe strategjive të miratuara. Të sigurojnë raportim sistematik të procedurave dhe rishikimin periodik të planeve dhe strategjive.
- Të përfshijnë përdorimin e armëve të zjarrit në rastet e dhunës në familje si një nga përparësitë në strategjitë dhe planet e veprimit kombëtar për të luftuar dhunën në familje. Të lidhin strategjitë dhe planet e veprimit në këtë fushë me ato të fushës së kontrollit të AVL-ve
- Të rishikojnë planet e veprimit dhe strategjitë kombëtare të AVL-ve nga një këndvështrim gjinor. Të fillojnë veprimet specifike me bazë gjinore si një çështje që përshkruan gjithë strategjitë kombëtare mbi AVL-të.
- Të përfshijnë masa që synojnë parandalimin e dhunës në familje në strategjitë dhe planet veprimit kombëtar mbi AVL-të.
- Të sigurojnë që çështja e kontrollit të AVL-ve nga perspektiva gjinore ndodhet në axhendën e mekanizmave të barazisë gjinore të nivelit kombëtar dhe vendor.
- Të sigurojnë zëra buxhetore specifike për zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit kombëtar mbi AVL-të dhe dhunën në familje.
- Të krijojnë një institucion qeveritar përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave dhe masave për luftimin e dhunës në familje.
- Të përcaktojnë aktorët shtetërorë përgjegjës për zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit kombëtar mbi AVL-të dhe dhunën në familje. Të marrë masa për të forcuar bashkëpunimin dhe koordinimin mes tyre. Të vendosë procedura të qarta raportimi.
- Të mbështesin OJQ-të në aktivitetet e tyre ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore në këtë fushë. Të sigurojë bashkëpunim sistematik dhe të krijojë një kornizë financiare të përshtatshme në mbështetje të kësaj.

### Korniza ligjore

- Të sigurojë një qasje të plotë dhe ndërsektoriale për të lidhur kornizat dhe masat e ndryshme ligjore në fushën e luftimit të dhunës në familje dhe regjimeve të kontrollit të AVL-ve (zgjidhjet dhe procedurat e Kodit Penal dhe zgjidhjet dhe procedurat e Kodit Civil).
- Të harmonizojë përkufizimet e dhunës në familje të dhëna në ligje të ndryshme ( Kodi Penal, Kodi Familjar, Ligji mbi Dhunën Në familje) si dhe strategjitë dhe planet e veprimit kombëtar në këtë fushë. Të

miratojë një përkufizim të qartë të dhunës në familje duke përfshirë dhunën që ndodh në marrëdhëniet intime dhe atyre mes ish partnerëve.

- Të rishikojë efektivitetin e masave ekzistuese mbrojtëse dhe procedurave të policisë dhe gjykatës. Të bëjë ndryshimet e nevojshme në mënyrë që ty sigurojë viktimave të dhunës në familje mbrojtje dhe qasje të shpejtë në sistemin e drejtësisë.
- Të sigurojë se viktimat e dhunës në familje mund të aplikojnë për urdhra mbrojtëse për të ndaluar abuzimin duke përfshirë parandalimin e abuzuesit për të hyrë në shtëpinë e përbashkët në vendbanimin apo në vendin e punës së viktimës dhe duke kërkuar ndalimin e armës së zjarrit nga abuzuesi dhe heqjen e licencës së armës së zjarrit.
- Të zhvillojë dhe miratojë rregullore dhe shtesa të akteve ligjore për mënyrën e vlerësimit, dorëzimit, lëshimit dhe monitorimit të masave për ndalimin e zotërimit të një arme zjarri apo të çdo arme tjetër si dhe për ndalimin dhe konfiskimin e tyre.
- Të vendosë ndalimin e detyrueshëm të armëve të zjarrit si një masë emergjence e urdhëruar nga gjykata për të mbrojtur viktimat në rastet e dhunës së armatosur.
- Të marrë masa të përkohshme për të mos lejuar zotërimin apo për të ndaluar një armë zjarri ose çdo armë tjetër si kriter për të refuzuar kërkesën për licencë për armë zjarri dhe si bazë për mos-zgjatjen dhe konfiskimin e licencës.
- Të përshkruajë, të vendosë kushte më të rrepta për përfundimin e licencës së armës së zjarrit. Një aplikuesi për licencë t'i nënshtrohet kontrolleve të kompetencës duke përfshirë kontrollin e detyrueshëm të shëndetit mendor dhe kushteve psikologjike dhe varësinë ndaj alkoolit dhe, ose substancave narkotike. Certifikata e kompetencës nuk duhet të lëshohet personit që ka prirje të dhunshme apo ka qenë i dënuar për një vepër apo për nja shkelje ligji që përfshin abuzimin seksual apo fizik. Licenca nuk duhet t'i lëshohet ndonjë personi kundër së cilit është lëshuar masë mbrojtëse. Të vendosë kontrolle të gjëra të prapavijës të rrethanave që mund të tregojnë dhunën në familje në momentin që bëhet miratimi i kërkesës për licencë. Kontrollat e prapavijës duhet të jenë të detyrueshme dhe duhet të përfshijnë investigimin mbi çdo histori apo mundësi por të prishur marrëdhëniet në familje. Bashkëshortët aktualë dhe ata të mëparshëm duhet të njoftohen mbi qëllimin e individit për të përfunduar licencën e një arme zjarri. Të sigurojë se licenca e armës së zjarrit të refuzohet kur shihet e nevojshme për sigurinë personale të një anëtarit të familjes ose nëse refuzimi kërkohet nga një anëtar i familjes i cili është ose ka qenë viktimë e dhunës.
- Të vendosë një periudhë një mujore 'pritjeje' për të përfunduar armën e zjarrit pas përfundimit të licencës.
- Të sigurojë se raportet e dhunës në familje dhe krimeve të tjera në mënyrë automatike detyrojnë rishikimin e licencës së personit që zotëron një armë zjarri.
- Të përfshijë kërkime rreth pranisë së armëve të zjarrit si një praktikë standarde në të gjithë incidentet e dhunës në familje dhe të aplikojë menjëherë masat për t'i hequr ato aty ku shihet se ka rrezik. Shkelësi i ligjit duhet të shënjohe dhe duhet të konsiderohet në mënyrë serioze revokimi i lejeve dhe të jepen urdhra ndalues aty ku shihet se ekziston kërcënim për sigurinë.

### **Mbrojtja e viktimave të dhunës në familje**

- Të sigurojë se dhuna në familje ndiqet dhe dënohet si vepër penale.
- Të lehtësojë qasjen e viktimave ndaj sistemit të drejtësisë, zgjidhjet civile dhe programet rehabilituese duke përfshirë qendrat e kujdesit shëndetësor. Të mbrojë të drejtat e fëmijëve dhe minorenëve. Të sigurojë se në të gjitha nivelet e procedimit viktimat mund të marrin kujdes shëndetësor dhe psikologjik dhe mbrojtje. Të sigurojë ndihmë ligjore falas për viktimat. Të sigurojë urdhra shtrëngues kundër dhunuesve.
- Të sigurojë se gjykata mund të vendosë çdo lloj kushti shtesë (siç është gjendja e mendjes apo kushtet mendore prirja drejt dhunës dhe përdorimi apo varësia ndaj alkoolit apo drogave) që i duket e arsyeshme në mënyrë që të mbrojë dhe të sigurojë shëndetin dhe mirëqenien e personit që ka bërë ankesën duke përfshirë dhe urdhrin për të ndaluar çdo armë të rrezikshme që është në zotërim apo nën kontrollin e dhunuesit.

- Të miratojë rregulloret për sjelljet e policisë për rastet e dhunës në familje të cilat kërkojnë kontrolle të detyrueshme për praninë e armëve dhe për informacionin për viktimat mbi mundësinë për të kërkuar masa të përkohshme për të ndaluar zotërimin apo për ta ndaluar një armë zjarri apo çdo armë tjetër si dhe të drejtën për të ngritur akuzë penale.
- Të sigurojë zëra buxhetore për strehimore, këshillimoret, ndihmat ligjore, programet rehabilituese, kujdesi shëndetësor dhe shërbime të tjera për viktimat e dhunës në familje.
- Të sigurojë se zyrtarët publikë në mënyrë të veçantë personeli i zbatimit të ligjit, sistemi juridik, personat e kujdesit shëndetësorë dhe punonjësit socialë të jenë tërësisht familjarë me parashikimet ligjore të aplikueshme dhe të jenë të sensibilizuar dhe ti përgjigjen në mënyre adekuate të gjitha formave të dhunës në familje.
- Të përfshijë masat e mbrojtjes së emergjencës në kodin e procedurave penale dhe ligjin mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje, duke përfshirë ndalimin e ngacmimit apo persekutimin e viktimës, përjashtimin e dhunuesit nga shtëpia dhe konfiskimin e armës.
- Të sigurojë bashkëpunimin sistematik ndërmjet agjencive dhe që njësitë speciale të policisë dhe profesionistët e trajnuar të sigurojnë ndërhyrje të shpejtë dhe efektive si dhe mbrojtje 24 orëshe për viktimën.
- Të zhvillojë strategjitë dhe procedurat e ndërhyrjes në nivel vendor.

### Masat parandaluese

- Të zbatojnë masat e ndërgjegjësimit duke përfshirë fushat e tolerancës zero, për të tërhequr vëmendjen e publikut për seriozitetin e kësaj çështjeje dhe për të bërë përdorimin e armëve dhe dhunën në familje si nga ana shoqërore dhe ajo morale.
- Të sigurojnë edukim mbi barazinë gjinore dhe sjelljet jo të dhunshme që në moshë të hershme; të përfshijë atë në programe arsimore si dhe të trajnojnë mësuesit.
- Të sigurojnë mbështetje institucionale për programet për dhunuesit siç për shembull rehabilitimi në mënyrë që të parandalohen rastet e tjera të dhunës së armatosur në momentin që ata kthehen në shtëpi.
- Të ofrojnë edukim të saktë dhe trajnim sistematik për policinë dhe gjithë pjesëmarrësve të sistemit të drejtësisë. Ekziston nevoja për të përmirësuar kuptimin mbi rreziqet që lidhen me armët e zjarrit. Të gjitha palët duhet të kuptojnë shpeshësinë me të cilën armët e zjarrit marrin pjesë në ciklin e dhunës në familje.
- Të krijojnë programe për menaxhimin e stresit për profesionistët të caktuar dhe persona që kanë marrë pjesë në një mënyrë apo në një tjetër në luftë apo konflikteve gjatë viteve 1990 pasi ky stres mund të manifestohet si dhunë.
- Të sigurojnë dhe nxisin trajnime për shoqatat e qytetarëve mbi kuptimin dhe ndikimin e përdorimit të armëve në dhunën në familje; të sigurojnë përfshirjen e tyre aktive në aktivitete parandaluese në nivel vendor.
- Të sigurojnë trajtim të saktë nga ana e medias të dhunës së armatosur në familje.

### Statistikat, mbledhja dhe monitorimi i të dhënave

- Të sigurojnë financimin dhe mbështetjen institucionale për përpilimin e të dhënave, studimeve dhe kërkimeve mbi shtrirjen, shkaqet dhe efektet e AVL-ve të përdorura në dhunën në familje dhe mbi efektshmërinë e politikave dhe masave për të parandaluar dhe për tu marrë me dhunën e armatosur në familje.
- Të vlerësojnë kostot e dhunës në familje, të mbështesë kërkimin, të zhvillojë treguesit për vlerësimin dhe të mbledhë të dhëna në mënyrë uniforme dhe sistematike.
- Të kryejnë kërkime mbi përhapjen e dhunës në familje tek oficerët e policisë dhe ushtrisë si dhe zyrtarëve të tjerë të cilët janë licencuar nga profesioni i tyre por të mbajtur një armë zjarri. Të marrë

masa të përshtatshme për të dënuar abuzuesit dhe për të zhvilluar programe parandaluese për këtë grup specifik.

- Të zhvillojnë dhe financojnë mekanizmat monitorues për të zbatuar ligjet dhe politikat mbi dhunën e armatosur në familje.
- Të mbajnë një sistem statistikash të unifikuar, një historik dhe të dhëna mbi rastet e dhunës së armatosur në familje; përdorimin e armëve të zjarrit në dhunën në familje; viktimat dhe abuzuesit në të gjitha nivelet dhe në të gjitha institucionet përkatëse të shtetit (polici, gjykata, zyrat e prokurorëve, qendrat për punë sociale, institucionet e kujdesit shëndetësor, strehimore, etj.). Në mbledhjen e të dhënave të bashkëpunojnë me OJQ-të që bashkëpunojnë me viktimat e dhunës në familje.
- Të vendosin mbajtjen e detyrueshme të shënime në rastet e dhunës së armatosur në familje, duke vendosur parametrat të cilët rregullojnë shkallën e përdorimit të armëve, shkaqet e dhunës, pasojat e saj, shpenzimet në lidhje me dhunën, etj, prej të gjithë institucioneve përkatëse (Ministria e Brendshme, Ministria e Punës dhe Politikave Sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe sistemi juridik).

## 8 Aktivitete dhe strategjitë e reja: Mundësitë për përfshirje të shoqërisë civile

Në gjithë rajonin, OJQ-të veçanërisht grupet e grave kanë luajtur një rol qendror në avokimin për eliminimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave. Ndryshime pozitive si krijimi i legjislacionit që synon luftimin e dhunës në familje kanë ardhur si rezultat i përpjekjeve afatgjata të lëvizjeve të grave. Ato kanë dhënë ndihmesën e tyre në bërjen publike të këtij problemi dhe ka luajtur një rol domethënës në mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave duke mbledhur dhe monitoruar të dhëna dhe duke ndërgjegjësuar publikun. Për më tepër ato kanë një rol të rëndësishëm në edukimin dhe trajnimin e policive, gjykatësve, prokurorëve, punonjësve sociale dhe zyrtareve të tjerë të shtetit në mënyrë që ti përgjigjen saktësisht rasteve të dhunës në familje.

Sidoqoftë grupet dhe OJQ-të e grave deri me tani nuk i kanë kushtuar vëmendje mjaftueshëm përdorimet e armëve të zjarrit në rastet e dhunës në familje apo çështje të kontrollit të AVL-ve. Lidhja e dukshme midis këtyre dy çështjeve hap mundësi për përfshirje të mëtejshme të OJQ-ve.

### Strategjitë kombëtare dhe politikat e përgjithshme

- Përfshijnë çështjen e dhunës së armatosur në familje, kur përfshihen në draftimin dhe rishikimin e strategjive dhe planeve të veprimit kombëtar mbi luftimin e dhunës në familje; përfshijnë masat specifike që synojnë ngushtimin e përfutimit të AVL-ve dhe kërkesave për zotërimin e tyre dhe që zvogëlojnë mundësinë për të gjetur AVL-të.
- Avokojnë dhe llojnë pranë qeverive për të përfshirë çështjen e eliminimit të dhunës në familje në strategjitë dhe planet e veprimit kombëtar mbi luftimin e dhunës dhe në regjimet kombëtare të kontrollit të AVL-ve.

### Korniza ligjore

- Të përfshijnë çështjen e dhunës së armatosur në familje kur draftojnë dhe hartojnë nisma dhe ndryshime në kornizën aktuale ligjore që kanë të bëjnë me lidhjen mes dhunës në familje dhe armëve të zjarrit.
- Të përdorin dokumentet e ratifikuar ndërkombëtare të kësaj fushë si mjete lobuese.
- Të llojnë për kontrole më të rrepta të AVL-ve si përfaqësues të shoqërisë civile dhe grupeve të grave në mekanizmat për barazinë gjinore.
- Të përdorin median për të evokuar për kërkesa më të rrepta për përfutimin dhe zotërimin e AVL-ve.

### Mbrojtja e viktimave të dhunës në familje

- Të përfshijnë çështjen e dhunës së armatosur në familje në trajnimet përkatëse për zyrtarët shtetërorë.
- Të zhvillojë programe për të mbështetur viktimat e dhunës së armatosur në familje.
- Të japë shërbime në partneritet me sistemin shtetëror të mbrojtjes, në mënyrë që të koordinohen shërbimet dhe të plotësohen nevojat e viktimave.

### Masat parandaluese

- Të drejtojnë fushata ndërgjegjësuese mbi dhunën e armatosur në familje me qëllim tërheqjen e vëmendjes së publikut mbi seriozitetin e kësaj çështjeje, gjetjen e lehtë të armëve të zjarrit dhe nevojën për një kontroll më të rreptë të AVL-ve.



- Të shpërndajnë informacion mbi ligjet që kanë të bëjnë me dhunën në familje dhe kontrollin e armëve të publikut.
- Të bashkëpunojnë dhe të krijojnë partneritet me OJQ-të të cilat merren në mënyrë specifike me çështjet e kontrollit të AVL-ve për të drejtuar fushata dhe aktivitete të përbashkëta.
- Të rrisin ndikimin në media, për të njohur nevojën e lidhjes së rregullore së dhunës në familje me regjimin e kontrollit të AVL-ve.

#### **Statistikat, mbledhja dhe monitorimi i të dhënave**

- Të përfshijnë çështjet mbi armët e zjarrit si një faktor rreziku për dhunën në familje në kërkime dhe studimet e tyre.
- Të mbledhë dhe shpërndajë të dhëna të sakta dhe të pavarura mbi dhunën në familje duke dhënë detaje për natyrën dhe shkallën e dhunës, shkallët e procedimit dhe dënimit, dhe natyrën e ndëshkimit të aplikuar me mënyrë transparente dhe në kohën e duhur.

Kur sigurojnë shërbime për viktimat si për shembull, strehimore, linjat telefonike të ndihmës dhe këshillimoret, të përfshijnë regjistrimin dhe mbledhjen e të dhënave në rastet e dhunës në familje në të cilat armët e zjarrit janë përdorur nga abuzuesit për të kërcënuar, bërë presion, dhe dëmtuar viktimat; të përfshijnë të dhënat mbi reagimet e policisë, punonjësve të kujdesit shëndetësor, punonjësve sociale, etj.

## 9. Përmbledhje e konkluzioneve dhe rekomandimeve për qeveritë nga studimet kombëtare<sup>62</sup>

### Shqipëria

#### 1. Strategjitë kombëtare dhe politikat e përgjithshme

##### *Përfundime:*

Është përgatitur drafti i strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit për barazinë gjinore dhe zhdukjen e dhunës në familje (2007-2010) i cili specifikon se çdo armë e cila i përket dhunuesve e gjetur gjatë kontrolleve të policisë duhet të ndalohet ose dhunuesi duhet urdhëruar që ti dorëzojë armët. Sidoqoftë çështja e gjerë e kontrollit të armëve nuk diskutohet në vetvete.

##### *Rekomandime:*

Miratimi dhe zbatimi i strategjisë kombëtare për barazi gjinore dhe zhdukjen e dhunës në familje. Të përforcohet çështja e kontrollit të armëve brenda strategjisë dhe të garantohet një buxhet specifik për zbatimin e saj.

#### 2. Korniza ligjore

##### *Përfundime:*

Korniza ligjore porsa i përket dhunës në familje ka pësuar përmirësime në vitet e fundit me miratimin e ligjit specifik Ligji mbi dhunën në familje në vitin 2006. Shqipëria është pjesë e të gjithave konventave kryesore ndërkombëtare, instrumenteve të të drejtave të njeriut sidoqoftë ka vend për përmirësime të mëtejshme për sa i përket harmonizimit me CEDAW-un dhe dokumenteve të tjerë të të drejtave të njeriut që kanë të bëjnë me dhunën në familje. Niveli i njohurive dhe aplikimi i këtyre instrumenteve nga ana e prokurorëve dhe gjykatësve është aktualisht i kufizuar. Legjislationi siguron heqjen e licencës së një arme zjarri nëse ajo është përdorur për të kryer një vepër penale. Sidoqoftë dënimi për dhunën në familje nuk përbën automatikisht bazë për refuzimin e kërkesës për licencë pasi nuk njihet si vepër penale nga Kodi Penal.

##### *Rekomandime:*

Të harmonizohet legjislationi me CEDAW-un dhe rekomandimet dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare dhe të sigurohen trajnime dhe sensibilizime në këtë fushë për profesionistët dhe personat përkatës përgjegjës. Të njihet dhuna në familje si krim nga kodi penal dhe të sigurohet se dënimi i saj përmban pengesë për marrjen e licencës së armës së zjarrit.

#### 3. Mbrojtja e viktimave të dhunës në familje.

##### *Përfundime:*

Qeveria shqiptare mbështet një strehimore për viktimat e dhunës në familje ndërkohë që të gjitha shërbimet e tjera sigurohen nga OJQ-të të cilat mbështeten nga donatorë të huaj. Ligji mbi dhunën në familje siguron urdhra mbrojtjeje për viktimat të cilat mund të urdhërohen nga policia duke përfshirë dhe ndalimin e armëve të zjarrit. Është në praktikën e policisë të urdhërojë këto masa mbrojtëse gjatë rasteve penale.

<sup>62</sup> Ky kapitull jep një përmbledhje të konkluzioneve kryesore për qeveritë të cilat janë marrë nga kërkimi kombëtar që u krye në secilin vend. Rekomandime të përgjithshme për përfshirjen e mëtejshme të shoqërisë civile gjenden në kapitullin 8 dhe janë të aplikueshme për çdo vend.

Rekomandime:

Mbështetje e OJQ-ve që sigurojnë shërbime strehime për viktimat dhe rritje e përgjegjësisë së qeverisë për masa të tjera mbrojtëse si për shembull këshillimoret, ndihma ligjore dhe programet rehabilituese siç janë ravijëzuar në Ligjin mbi dhunën në familje dhe Në draftin e strategjisë kombëtare.

#### 4. Masat parandaluese

Përfundime:

Masat për të parandaluar dhunën në familje deri tani kanë qenë shumë të kufizuara. Mungojnë pothuajse fare programet arsimore që trajtojnë këtë çështje; besimi i publikut në sistemin gjyqësor është i ulët për shkak të dështimeve të njëpasnjëshme për të dënuar dhunuesit apo dënimet zemërgjera; profesionistët e sistemit të kujdesit shëndetësor nuk janë të detyruar të pyesin pacientet rreth shkaqeve të lëndimeve të tyre dhe pothuajse nuk ekziston ndërgjegjësimi mbi këtë çështje.

Rekomandime:

Zgjerimi i programeve shkollore të cilat synojnë luftimin e dhunës në familje. Krijimi i praktikave për stafin e shërbimeve shëndetësore që do të regjistrojnë dhe raportojnë rastet e dhunës në familje duke përfshirë kategoritë specifike të dhunës në familje dhe lëndimet me armë zjarri. Të rritet ndërgjegjësimi mbi problemet e dhunës në familje dhe abuzimit të armëve të zjarrit dhe të bëhet i vlefshëm në masë të gjerë informacioni mbi të drejtat e viktimave.

#### 5. Statistikat, mbledhja dhe monitorimi i të dhënave

Përfundime:

Nuk ka të dhëna të vlefshme mbi dhunën në familje apo dhunën e armatosur në familje. OJQ-të regjistrojnë të dhënat por ato nuk janë të krahasueshme apo të përpiluara në nivel kombëtar. Sidoqoftë është planifikuar një Studim Kombëtar mbi dhunën në familje i cili do të vlerësojë efikasitetin e politikave të qeverisë dhe do të sigurojë të dhëna bazë. Studimi do të përfshijë analizën e marrëdhënieve mes pranisë së armëve të zjarrit në shtëpi dhe përhapjen e dhunës në familje tek gratë dhe fëmijët.

Rekomandimet:

Krijimi i një sistemi të harmonizuar të mbledhjes së të dhënave në rangun kombëtar dhe vendor i cili do të centralizojë mbledhjen e të dhënave nga policia, gjykatat, prokurorët dhe institucionet e kujdesit shëndetësor. Të sigurohet se rezultatet e Strategjisë Kombëtare mbi dhunën në familje përdoren për të informuar mbi zhvillimet e legjislacionit dhe politikave përkatëse mbi dhunën në familje dhe dhunën e armatosur në familje.

### Bosnja dhe Hercegovina

#### 1. Strategjitë kombëtare dhe politikat e përgjithshme

Përfundime:

Bosnja dhe Hercegovina nuk kanë një strategji kombëtare mbi dhunën në familje, nuk kanë as në nivelin e strategjive të entiteteve. Vetëm kantoni i Sarajevës ka një plan veprimi specifik mbi këtë çështje. Strategjia kombëtare e AVL-ve nuk merr në konsideratë çështjet e dhunës së armatosur në familje.

Rekomandime:

Zhvillimi dhe adoptimi i një strategjie dhe një plani veprimi kombëtar për të luftuar dhunën në familje dhe dhunën e armatosur në familje si dhe plane të veprimeve në rangun e entiteteve. Vendosja e çështjes së përkatësisë gjinore si një çështje ndërsektoriale në strategjinë kombëtare mbi kontrollin e AVL-ve.

## 2. Korniza ligjore

### *Përfundime:*

Megjithëse janë bërë ndryshime pozitive të rregullta në fushën e dhunës në familje gjatë viteve të fundit, natyra e dyzuar e legjislationit të Bosnjës dhe Hercegovinës kufizon vlefshmërinë e instrumenteve ndërkombëtarë mbi të drejtat e njeriut dhe ndërkohë zbatimi i legjislationit është ende i papërshtatshëm. Legjislationi që rregullon përfundimin e armës së zjarrit dhe licencës është aktualisht i mbushur me paqartësi duke e bërë shumë të lehtë përfundimin e një arme zjarri duke përfshirë dhe shkaktarët e dhunës në familje pa pasur nevojën për të demonstruar 'arsye të forta'.

### *Rekomandime:*

Harmonizimi i ligjeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me futjen dhe zbatimin e Ligjit mbi mbrojtjen ndaj dhunës në familje (FBH dhe RS) dhe Kodit Penal (Shteti RS, FBH dhe Distrikti i Bërçko-s). Miratimi i një ligji të harmonizuar në nivel shtetëror mbi përfundimin, mbajtjen dhe zotërimin e armëve të zjarrit nga individët privatë dhe sigurimi se zotërimi ilegal i armës së zjarrit do të klasifikohet si vepër penale në të gjithë shtetet.

## 3. Mbrojtja e viktimave të dhunës në familje.

### *Përfundime:*

Masat mbrojtëse sigurohen nën ligjin e vitit 2005 mbi mbrojtjen ndaj dhunës në familje sidoqoftë në praktikë këto masa zbatohen shumë rrallë për shkak të burimeve dhe njohurive të kufizuara të personave që sigurojnë këto shërbime. OJQ-të e grave sigurojnë shumicën e shërbimeve të mbrojtjes për viktimat por kanë një mungesë tepër të lartë burimesh për tu marrë me këtë problem. Masat mbrojtëse në lidhje me ndalimin e armëve të zjarrit apo heqjen e licencave për armët e zjarrit nuk eksitojnë.

### *Rekomandime:*

Sigurimi i një mbështetjeje më të madhe financiare për institucionet që sigurojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje. Ngritja e strehimoreve të tjera në bashkëpunim me OJQ-të e bazuar mbi vlerësimin e nevojave. Sigurimi se ka një infrastrukturë të përshtatshme për zbatimin e parashikimeve që rrjedhin nga Ligjin mbi mbrojtjen e dhunës në familje. Sigurimi se krijohen dhe zbatohen masat që kanë të bëjnë më konfiskimin e armëve të zjarrit.

## 4. Masat parandaluese

### *Përfundime:*

Vetëm kantoni i Sarajevës ka një plan veprimi specifik për të luftuar dhunën në familje por edhe ky nuk përmend çështjen e dhunës së armatosur në familje. Ligji për barazinë gjinore siguron për futjen e programeve që janë të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore në sistemin arsimor dhe sigurimi se çështjet e barazisë gjinore do të përfaqësohen në media. Sidoqoftë nuk përfaqësohet çështja e dhunës ndaj grave.

### *Rekomandime:*

Vendosja e planeve të veprimit për të luftuar dhunën në familje nëpërmjet shtetit. Promovimi i ndërgjegjësimit publik mbi dhunën në familje duke përfshirë dhunën e armatosur në familje. Krijimi i masave mbrojtëse siç janë programet rehabilituese dhe këshilluese për dhunuesit si dhe shërbimet e këshillimit martesor. Përfshirja e problemeve të dhunës kundër grave në programet e shkollave dhe institucioneve të tjera arsimore ashtu siç është parashikuar në ligjin për barazi gjinore.

## 5. Statistikat, mbledhja dhe monitorimi i të dhëna

*Përfundime:*

Agjencia e statistikave të Bosnjës dhe Hercegovinës nuk mbledh statika mbi dhunën kundër zjarri apo përdorimin e armëve të zjarrit në dhunën Në familje (apo krime të tjera). Mbajtja e shënimeve mbi licencat e armëve të zjarrit nuk është centralizuar si rrjedhojë nuk ka të dhëna se sa licenca janë lëshuar në të gjithë shtetin.

*Rekomandimet:*

Mbajtje e të dhënave në mënyre sistematike dhe të koordinuar mbi dhunën në familje duke përfshirë përdorimin e armëve të zjarrit nga gjithë institucionet përkatëse. Krijimi i një sistemi të bazave të të dhënave ta centralizuar për të menaxhuar çështjen e licencave të armëve të zjarrit në nivel shteti.

## Kroacia

### 1. Strategjitë kombëtare dhe politikat e përgjithshme

*Përfundime:*

Vlerësohet se çdo një në tre gra ka përjetuar dhunë në familje. Qeveria e njej këtë problem mjaft të hapur dhe ka zhvilluar një strategji kombëtare për (2005-2007) e cila vendos disa masa afatshkurtra dhe afatgjata për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimave. Sidoqoftë strategjia nuk i referohet përdorimit të armëve të zjarrit për dhunën në familje dhe nuk siguron asnjë zë buxheti për zbatimin e strategjisë duke kufizuar rreptësishtë efektivitetin e saj. një strategji kombëtare mbi AVL-të është zhvilluar nga Komisioni Kombëtar mbi AVL-të dhe ka filluar të qarkullojë për komente ndërmjet ministrive.

*Rekomandime:*

Rritja e afatit kohor të strategjisë kombëtare për mbrojtjen kundër dhunës në familje dhe sigurimi i zërave buxhetor për zbatimin e saj. Sigurimi se janë bërë lidhjet mes strategjisë kombëtare mbi dhunën në familje dhe kontrollit të AVL-ve në mënyrë që të luftohet çështja e dhunës në familje nga të dy këndvështrimet.

### 2. Korniza ligjore

*Përfundime:*

Ndërsa është Në fuqi legjislacioni për të luftuar dhunën në familje aktualisht ka një hapësirë të madhe mes legjislacionit dhe praktikës dhe ka mungesë koordinimi mes personave të interesit. Çështja e dhunës së armatosur në familje nuk është e rregulluar me ligj dhe si e tillë duhet të përndiqet si dy lloje krimesh të ndryshme nga ana e gjykatës. Një ligj i ri mbi armët hyri në fuqi në shtator 2007, i cili krijoi ndryshime pozitive në kuptim të krijim të kriterëve më strikte për të përfutur licencën e një arme zjarri.

*Rekomandime:*

Përmirësimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues duke siguruar trajnimin mbi parashikimet ligjore të aplikueshme për zyrtarët publikë që janë përfshirë në luftimin e dhunës në familje dhe sensibilizimin mbi të gjitha format e dhunës kundër grave, duke përfshirë dhe përdorimin e armëve të zjarrit.

### 3. Mbrojtja e viktimave të dhunës në familje.

*Përfundime:*

Shumica e veprimeve mbrojtëse Në Kroaci sigurohet nga OJQ-të të cilat në masën gati 30% financohen nga qeverisja kombëtare dhe vendore. Ka raste të Rregullave mbi Procedurat e dhunës në familje të cilat vendosin rregulla të qarta për policinë dhe personave që sigurojnë shërbime të cilat kanë të bëjnë më këto raste. Masat e

përkohshme të mbrojtjes duke përfshirë dhe konfiskimin e një arme sigurohen nga ligji por lëshohen rrallë nga gjykata.

*Rekomandime:*

Të merret përgjegjësi me e madhe për financimin e sistemit të mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje. Të sigurohet trajnim dhe sensibilizim për të luftuar mentalitetin patriarkal brenda në mes zbatuesve të ligjit dhe agjencive juridike që kontribuojnë në këtë mënyre në një zbatim jo të saktë të masave mbrojtëse.

#### **4. Masat parandaluese**

*Përfundime:*

Strategjia kombëtare thekson masa mbrojtëse të ndryshme kundër dhunës në familje por nuk përfshin dhunën e armatosur në familje. Ndonjë mbështetje është siguruar nga qeveria për aktivitetet e ndërgjegjësimit mbi dhunën në familje të OJQ-ve por jo mbështetje ka qenë e pamjaftueshme dhe sporadike.

*Rekomandime:*

Zbatimi dhe përmirësimi i masave mbrojtëse që gjenden në Strategjinë Kombëtare dhe përfshirja e masave mbrojtëse që synojnë dhunën e armatosur në familje. Mbështetja e aktiviteteve arsimore dhe ndërgjegjësuese mbi dhunën në familje dhe dhunën e armatosur në familje.

#### **5. Statistikat, mbledhja dhe monitorimi i të dhënave**

*Përfundime:*

Sistemi i informacionit të policisë kroate ofron një nivel të pazakontë të detajeve mbi dhunën e armatosur duke lejuar analizën e bazuar mbi parametra të ndryshëm siç janë: gjinia, mosha dhe etnia e dhunuesit dhe viktimës, lloji armës së përdorur, vendngjarja e krimin, etj. Sidoqoftë ka mungesë të informacioneve të besueshme mbi dhunën në familje duke përfshirë dhunën e armatosur në familje dhe shumë institucione aktualisht nuk i bëjnë informacionet që ato kanë mbi dhunën në familje.

*Rekomandimet:*

Vendosja e dhunës në familje dhe llojit të armëve të zjarrit apo armëve të përdorura aty ku është e mundur si parametra në sistemin e informacionit të policisë. Bërja publike e të dhënave mbi të gjithë format e dhunës.

### **Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë**

#### **1. Strategjitë kombëtare dhe politikat e përgjithshme**

*Përfundime:*

Qeveria maqedonase e njeht problemin e dhunës në familje dhe përhapjes dhe keqpërdorimit të AVL-ve dhe ka zhvilluar strategji kombëtare në të gjitha fushat për të siguruar një qasje sistematike dhe të qëndrueshme.

*Rekomandime:*

Sinkronizimi dhe koordinimi i aktiviteteve dhe masave të planifikuara në të dyja strategjitë për rrjedhojë dhënia e përparësisë për çështjen e dhunës së armatosur në familje në strategjinë kombëtare kundër dhunës në familje dhe krijimi i veprimeve specifike me qendër çështjen gjinore si një çështje që ndërlidhet me strategjinë kombëtare mbi AVL-të.



## 2. Korniza ligjore

### *Përfundime:*

Janë bërë përpjekje për të modifikuar legjislacionin kombëtar në lidhje me dhunën në familje e cila njihej si vepër penale në 2004 dhe legjislacioni mbi zotërimin dhe përfitim të armëve dhe ti njësojë ato me standardet ndërkombëtare. Nevojiten reforma të tjera ashtu si dhe theksohen në strategjitë respektive kombëtare si dhe përmirësimet në fushën e vendosjes dhe zbatimit.

### *Rekomandime:*

Zhvillimi dhe adoptimi i akteve plotësuese ligjore apo manualeve mbi standardet për vlerësimin, dorëzimin, lëshimin dhe monitorimin e masave për të parandaluar zotërimin dhe ose ndalimin e një arme zjarri apo armëve të tjera. Adoptimi i standardeve të policisë në rastet e dhunës në familje, duke përfshirë kontrollin e detyrueshëm për armë zjarri. Forcimi i legjislacionit për përfitim të licencës së armës së zjarrit duke vendosur kontrolle të prapavijës tërësore që kanë të bëjnë çdo lloj historiku të dhunës në familje.

## 3. Mbrojtja e viktimave të dhunës në familje.

### *Përfundime:*

Përpjekje janë bërë për të përmirësuar sistemin e mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje në atë që qeveria mbështet aktualisht 6 strehimore dhe linja kombëtare telefonike SOS. Urdhrat për masat e përkohshme mbrojtëse sigurojnë nevojat e ndryshme për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje sidoqoftë aktualisht ato nuk përdoren në mënyrë të drejtë apo të saktë si masa për mbrojtjen e viktimave pasi ato shihen me tepër si masa ndëshkuese për dhunuesit dhe kështu që kërkohen rrallë nga qendrat për punë sociale. Urdhrat e përkohshëm të mbrojtjes për të ndaluar një armë zjarri kërkohen apo jepen shumë rrallë.

### *Rekomandime:*

Të sigurohet se strukturat përkatëse profesionale interpretojnë dhe zbatojnë në mënyrë korrekte urdhrat e përkohshëm të mbrojtjes duke përfshirë konfiskimin apo ndalimin e zotërimit të një arme zjarri.

## 4. Masat parandaluese

### *Përfundime:*

Do të hyjë në fuqi në vitin 2008 strategjia kombëtare kundër dhunës në familje e cila thekson masa thelbësore parandaluese. Janë kryer fushata ndërgjegjësuese mbi dhunën në familje më së shumti nga shoqëria civile por me mbështetjen gjithnjë në rritje të qeverisë.

### *Rekomandime:*

Përfshirja e çështjes së dhunës në familje dhe kontrollit të armëve në strategjitë dhe fushatat ndërgjegjësuese që kanë në qendër çështjen e dhunës në familje.

## 5. Statistikat, mbledhja dhe monitorimi i të dhënave

### *Përfundime:*

Ka mungesë të të dhënave prej së cilave mund të vlerësohet ndikimi i armëve të zjarrit në rastet e dhunës në familje. Mekanizmat raportues dhe regjistruar të institucioneve të ndryshme përgjegjëse aktualisht janë të pakoordinuara dhe të përshtatshme.

#### *Rekomandimet:*

Kryerja e studimeve cilësore mbi përhapjen e armëve të zjarrit të përdorura në dhunën në familje. Mbajtja e detyruar e shënimeve tek institucionet përgjegjëse (MB, MPPS, MSH, sistemi gjyqësor) mbi dhunën në familje që përfshin përdorimin e armëve, shkaqet e dhunës, pasojat dhe shpenzimet. Mbajtja e detyruar e shënimeve mbi rastet e lëndimeve nga ana e shërbimeve shëndetësore.

## **Mal i Zi**

### **1. Strategjitë kombëtare dhe politikat e përgjithshme**

#### *Përfundime:*

Është miratuar strategjia kombëtare për parandalimin e dhunës por në praktikë janë zbatuar pak aktivitete për shkak të mungesës së burimeve dhe personave të interesit. Drafti i planit të veprimit të barazisë gjinore përmban një nënndarje mbi parandalimin e dhunës por zbatimi varet nga adoptimi i ligjit mbi barazinë gjinore i cili ende ka ngelur pezull. Nuk ka lidhje mes këtyre strategjive dhe strategjisë kombëtare dhe kontrollit ta AVL-ve.

#### *Rekomandime:*

Zbatimi i përparësive të identifikuara në strategjinë kombëtare për parandalimin e dhunës (2003-2006) me theks mbi aktivitetet që kanë të bëjnë me parandalimin e dhunës në familje. Adoptimi i ligjit mbi barazinë gjinore dhe fillimi i zbatimit të planit të veprimit mbi barazinë gjinore duke siguruar dhënien e burimeve përkatëse dhe integrimin e masave që synojnë luftën kundër dhunës së armatosur në familje.

### **2. Korniza ligjore**

#### *Përfundime:*

Dhuna në familje është krim që dënohet *ex officio* drafti i ligjit për parandalimin e dhunës në familje duhet të adoptohet gjatë vitit 2007 por nuk përfshin referenca për konfiskimin e armëve. Legjislationi ende ngelet mbrapa rekomandimeve të komisionit të CEDAW-ut. Përpjekjet për të nxitur procesin e dënimit të shkaktareve të dhunës në familje duke përfshirë dhunën në familje si një akt i shkeljes së ligjit kanë çuar në dënime më të zbehta të dhëna për shkaktarët.

#### *Rekomandime:*

Adoptimi i mekanizmave ligjore që e sjellin legjislationin malazez në të njëjtën linjë më standardet ndërkombëtare dhe konventat e ratifikuara.

### **3. Mbrojtja e viktimave të dhunës në familje.**

#### *Përfundime:*

Ka masa specifike për mbrojtjen e viktimave të dhunës seksuale gjatë procedurave gjyqësore. Masat mbrojtëse për viktimat e dhunës në familje sigurohen nga Kodi i procedurës penale. Sidoqoftë ato nuk zbatohen në praktikë. Ndalimi i armës nuk përshkruhet si masë mbrojtëse por si masë sigurie vetëm pasi është marrë vendimi i dhënies së dënimit. Shteti nuk siguron asnjë shërbim mbrojtjeje për viktimat si p.sh. strehimore, linja telefonike SOS, ndihma ligjore etj. dhe nuk janë vendosur rregullore që kanë të bëjnë më sjelljen e autoriteteve që punojnë me rastet e dhunës në familje.

#### *Rekomandime:*

Të zbatohen masat mbrojtëse siç parashikohen në ligjin mbi parandalimin e dhunës në familje dhe të përfshihet ndalimi i armës së zjarrit si armë mbrojtëse e detyrueshme. Marrje e përgjegjësisë mbi sigurimin e viktimave të dhunës në familje duke përfshirë këtu ndihmë falas ligjore, mbrojtje gjyqësori, strehimore, linja telefonike SOS

dhe kujdes shëndetësor. Zhvillimi i rregulloreve për të gjitha autoritetet përkatëse mbi mënyrën se si ato do të merren më rastet e dhunës në familje dhe dhunës së armatosur në familje.

#### **4. Masat parandaluese**

*Përfundime:*

Shumë pak është bërë nga shteti për zbatimin e masave mbrojtëse kundrejt dhunës në familje apo për të reduktuar pasojat e armëve të zjarrit në dhunën në familje. Nuk ka buxhet të përcaktuar për këtë çështje. OJQ-të kanë bërë disa përpjekje për të edukuar zyrtarët qeveritarë dhe median, për të ngritur ndërgjegjësimin dhe monitoruar legjislacionin. Nuk është kryer asnjë aktivitet që ka të bëjë me çështjen e kontrollit të armëve.

*Rekomandime:*

Të merren përgjegjësi më të mëdha për parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës së armatosur në familje duke përfshirë dhënësit e shërbimit të trajnimit dhe profesionistët e tjerë, të merren në mënyrën e duhur me dhunën në familje dhe për të theksuar çështjen e përdorimit të armëve të zjarrit. Caktimi i burimeve përkatëse financiare për të zbatuar aktivitetet parandaluese duke përfshirë fushatat ndërgjegjësuese që kanë në qendër dhunën familjare dhe përdorimin e armëve të vogla.

#### **5. Statistikat, mbledhja dhe monitorimi i të dhënave**

*Përfundime:*

Nuk ka statistika zyrtare në Mal të Zi mbi dhunën kundër grave ose dhunën në familje. OJQ-të mbajnë të dhëna mbi dhunën në familje por kjo nuk është e centralizuar apo harmonizuar.

*Rekomandime:*

Vendosja e një metode për mbledhjen e të dhënave për dhunën në familje e cila përfshin detaje të kërcënimeve dhe lëndimet nga armët dhe llojet e tyre.

### **Serbia**

#### **1. Strategjitë kombëtare dhe politikat e përgjithshme**

*Përfundime:*

Serbia nuk ka një strategji kombëtare mbi dhunën në familje dhe korniza fillestare e strategjisë kombëtare kundër dhunës e vitit 2005, nuk përfshin dhunën kundër grave megjithëse ajo është e njohur në planin e veprimit kombëtar për zhvillimin e gruas. Provinca autonom e Vojvodinës ka filluar të draftojë një strategji provinciale kundër dhunës në familje dhe ka bërë shumë përparime pozitive në këtë fushë. Strategjia Kombëtare e Bashkuar e kontrollit të AVL-ve e draftuar në 2004 nuk është ratifikuar ende nga Serbia.

*Rekomandime:*

Draftimi dhe adoptimi i strategjisë kombëtare kundër dhunës në familje dhe përfshirja e çështjes së dhunës kundër grave në strategjinë kombëtare kundër dhunës. Ratifikimi i strategjisë kombëtare për kontrollin e AVL-ve dhe sigurinë se ajo përmban referenca për të reduktuar dhunën e armatosur në familje.

#### **2. Korniza ligjore**

*Përfundime:*

Nuk ka legjislacion specifik kundër dhunës në familje në Serbi por ajo dënohet sipas Kodit Penal. Amendimet e vitit 2005 të Kodit Penal reduktojnë dënimet për dhunën në familje. Dhuna në familje nuk përfshihet si kriter

për refuzimin e licencës së armës së zjarrit në ligjin për armët dhe municionet. Sidoqoftë në praktikë armët në përgjithësi ndalohen nga policia në rastet në të cilat zotërimi mund të çojë në vepër penale apo shkelje ligji apo nëse është e nevojshme për ruajtjen e sigurisë publike. Aktualisht nuk ekziston asnjë kontroll mjekësor i detyrueshëm për përfitim të licencës së armës së zjarrit, sidoqoftë mendimet janë propozuar në mënyrë të tillë që të përfshijnë kontrollet e detyrueshme si rezultat i një vrasjeje masive me armë zjarri në Serbinë lindore.

*Rekomandime:*

Adoptimi i ligjit mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje i cili konsolidon elementet përkatës nga Kodi Penal dhe Kodi Familjar. Rritje e minimumit dhe maksimumit të dënimeve për aktet kriminale të dhunës në familje brenda kodit penal. Mendimi i ligjit për armë dhe municione në mënyrë që të kërkojë kushte më të rrepta për përfitim dhe sigurimin e armëve të zjarrit duke përfshirë kontrolle detyrueshme mjekësore dhe psikologjike. Përfshirja e dhunës në familje në listën e veprave të cilat detyrojnë refuzimin e aplikimit të licencës për armë zjarri.

### **3. Mbrojtja e viktimave të dhunës në familje.**

*Përfundime:*

Masat të përgjithshme mbrojtëse brenda kodit të familje aplikohen në rastet e dhunës në familje por ato aplikohen rrallë. Shoqëria civile ka zhvilluar procedura për policinë, punonjësit socialë dhe shërbimet shëndetësore por këto nuk janë pranuar ende nga autoritetet. Provinca e Vojvodinës ka hapur dhe mbështet financiarisht një strehimore për viktimat; në vendet e tjera strehimoret financohen nga donatorët ndërkombëtare.

*Rekomandime:*

Garantimi i shpejtë dhe efektiv i masave mbrojtëse për viktimat e dhunës në familje duke përfshirë ndalimin e armës së zjarrit. Provinca e Vojvodinës të adoptojë rregullore për profesionistët dhe siguresit e shërbimeve dhe të fusë rregulloret e nivelit shtetëror dhe format e raportimit për policinë, dhe punonjësit e shërbimeve sociale dhe kujdesit shëndetësor. Sigurimi i mbështetjes financiare për linjat telefonike SOS për viktimat, strehimoret, programet e këshillimit dhe këshillat ligjore.

### **4. Masat parandaluese**

*Përfundime:*

Nuk ka pasur fushata ndërgjegjësuese apo programe arsimore të drejtuara nga shteti mbi dhunën në familje apo abuzimin e armëve të zjarrit. Sekretariati i provincës së Vojvodinës ka vendosur një fond për edukimin e punonjësve socialë dhe vullnetarëve mbi dhunën në familje dhe ka mbështetur në mënyrë të gjerë fushatën e drejtuar nga OJQ-të '16 ditë aktivizim kundër dhunës kundër grave', në vitin 2005-2006. Procedurat për të përfutur licencën e armës së zjarrit janë aktualisht duke u rishikuar gjë që e bën më të vështirë përfitim të një arme zjarri.

*Rekomandime:*

Kryerja e fushata ndërgjegjësuese dhe futja e programeve në shkolla dhe universitete të cilat merren me çështjen e dhunës në familje dhe e shfaqin hapur lidhjen e saj me mbajtjen e armëve të zjarrit. Futja e kritereve më të rrepta për përfitim të armëve të zjarrit siç parashikohet në mendimet e parashikuara.

### **5. Statistikat, mbledhja dhe monitorimi i të dhënave**

*Përfundime:*

Zyra e statistikave të Republikës së Serbisë mbledh, analizon dhe shpërndan të dhëna dhe kohët e fundit ka filluar të zhvillojë bazat e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Sidoqoftë nuk ka institucione Shtetërore që mbledhin të dhëna të sakta mbi dhunën e armatosur duke përfshirë dhunën e armatosur në familje. Ministria e Brendshme mbledh të dhëna mbi dhunën në familje mbi numrin e armëve të ndaluara dhe numrin e vdekjeve nga dhuna e

armatosur. OJQ-të që punojnë më viktimat e dhunës në familje nuk regjistrojnë të dhëna që kanë të bëjnë më përdorimin e armëve të zjarrit.

*Rekomandimet:*

Vendosja e një sistemi zyrtar për mbledhjen e të dhënave në mes të institucione shtetërore që merren me dhunën në familje dhe sigurimi i mbledhjes së të dhënave të ndara sipas gjinisë mbi përhapjen e armëve të zjarrit mbi rastet e dhunës në familje. Vendosja e formave të raportimit për policinë dhe stafin mjekësor që merret me viktimat e dhunës në familje.

## **Territori i Kosovës i administruar nga KB<sup>63</sup>**

### **1. Strategjitë kombëtare dhe politikat e përgjithshme**

*Përfundime:*

Kosova nuk ka strategji as për dhunën në familje as për kontrollin e AVL-ve.

*Rekomandime:*

Adoptimi dhe zbatimi i strategjive për mbrojtjen kundra dhunës në familje dhe kontrollin e AVL-ve. Sigurimi së strategjitë janë të lidhura dhe së të dyja ato i drejtohen çështjes së dhunës së armatosur në familje dhe të sigurimi i aktiviteteve nga ana e qeverisë për mbrojtje dhe parandalim.

### **2. Korniza ligjore**

*Përfundime:*

Dhuna në familje rregullohet nga rregullorja specifike e UNMIK-ut po ashtu edhe nga parashikimet ligjore në disa pjesë të tjera të legjisllacionit. Rregullorja NR 2001/7 e UNMIK-ut thekson se karta e autorizimit të armëve (KAA) nuk do ti lëshohet askujt që ka 'një historik të sjelljeve të dhunshme' ku përfshihet dhuna në familje. Sidoqoftë korniza aktuale ligjore ka mungesa dhe nuk siguron masa efektive për të mbrojtur viktimat e dhunës.

*Rekomandime:*

Adoptimi i një legjisllacioni të qartë që përmban masa për të eliminuar dhunën e armatosur në familje, që dënon dhunuesit dhe mbron viktimat. Adoptimi i një ligji special mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje i cili duhet të përmbaje masa që mbrojnë viktimat nga dhuna e armatosur duke përfshirë qasje të shpejte në sistemin e drejtësisë, dënime të ashpra për dhunuesit dhe ndalimin e detyrueshëm të armëve të zjarrit nga ana e dhunuesve.

### **3. Mbrojtja e viktimave të dhunës në familje.**

*Përfundime:*

Urdhrat e mbrojtjes mund të jepen nga gjykata për viktimat. Kodi Penal përshkruan masa të mbrojtjes së përgjithshme që mund të aplikohen për viktimat e dhunës së armatosur në familje duke përfshirë dhunimin e KAA-së për çdo kush që ka një historik të sjelljeve të dhunshme dhe ndalimin e armës nga një person i cili e përdor atë për të kërcënuar, frikësuar apo në çdo lloj mënyre tjetër të paautorizuar.

*Rekomandime:*

Monitorimi dhe zbatimi i urdhrave të mbrojtjes dhe analizimi i efikasitetit të tyre. Futja e ndryshimeve ligjore nëse këto janë të nevojshme për të ngritur efektshmërinë e urdhrave të mbrojtjes. Informimi i viktimave rreth

<sup>63</sup> Për shkak të vështirësive administrative dhe vonësive kërkimi i mbajtur në Kosovë nuk ka qenë aq i zgjeruar sa ai që është kryer në vendet e tjera të rajonit. Kështu që përfundimet janë më pak të detajuara.

mundësisë për të kërkuar urdhrat e mbrojtjes. Rritje e ndjeshmërisë kundrejt çështjeve gjinore tek gjykatësit dhe prokurorët duke inkurajuar ata që të lëshojnë më shpesh urdhrat e mbrojtjes në mënyrë të veçantë në rastet e dhunës së armatosur në familje ku ka rrezik të përdoren armët e zjarrit. Krijimi i mundësive për ngritjen e strehimoreve të reja.

#### **4. Masat parandaluese**

##### *Përfundime:*

Kërkimi kombëtar nuk ka siguruar asnjë informacioni mbi aktivitetet e ndërgjegjësimit apo edukimit që janë mbajtur në Kosovë. Sidoqoftë shërbimi policor i Kosovës siguron trajnim të detyrueshëm për të gjithë oficerët që merren me dhunën në familje. Aktualisht është duke u kryer një fushatë ndërgjegjësimi mbi rreziqet e keqpërdorimit të armëve të vogla.

##### *Rekomandime:*

Krijimi dhe adaptimi i Planit të Veprimit mbi luftimin e dhunës kundër grave. Vendosja e fondeve për zbatimin e tij duke përfshirë zëra të veçantë buxhetorë për veprime që luftojnë dhunën kundër grave në institucionet ekzistuese qeveritare. Vendosja e mbështetjes financiare për OJQ-të merren me viktimat e dhunës në familje. Përfshirja e shoqërisë civile në të gjithë mekanizmat kombëtare që merren me dhunën kundër grave dhe kontrollin e AVL-ve.

#### **5. Statistikat, mbledhja dhe monitorimi i të dhënave**

##### *Përfundime:*

Informacioni mbi dhunën e armatosur në familje nuk është i vlefshëm në Kosovë. Sidoqoftë të dhënat e siguruar nga institucionet e zbatimit të ligjit janë mjaft të detajuara për standardët rajonale<sup>64</sup>.

##### *Rekomandimet:*

Vendosja e një grupi punë ndërministror për tu marrë me çështjen e dhunës në familje dhe përfitim dhe mbajtjen e AVL-ve. Zhvillimi i një mekanizmi të saktë të mbledhjes së të dhënave që do të përfshijnë të gjithë personat dhe institucionet përkatës të interesit.

---

64 SEESAC, *Strategic overview of armed violence data collection and analysis mechanisms (South Eastern Europe)*, Belgrade, 2006, p.79, Beograd 2006, fq 79.



## Shtojca A – Një rishikim i praktikave me të mira globale

Qysh prej fundit të viteve 1990të, një numër shtetesh e kanë konsideruar përmirësimin e rregullave kombëtare për mbajtjen e armëve si një aspekt thelbësor i parandalimit të dhunës në familje. Disa shtete kanë reformuar legjislativën e brendshme në lidhje me armët, duke u fokusuar mbi përmirësimin e kontrollit për blerjen e armëve, ruajtjen e sigurt të armëve, si dhe çarmatimin e partnerëve abuzivë.

27 qeveritë e Bashkimit Evropian kanë rënë dakord për standarde minimale për zotërimin e armëve të zjarrit përmes Direktivës së BE-së për Armët e Zjarrit. Mes masash të tjera, Shtetet bien dakord se për një kategori të caktuar armësh zjarri është i nevojshëm një autorizim për posedim, dhe se aplikantët duhet të kenë një 'shkak të mirë për armëmbajtje', të jenë mbi 18 vjeç, dhe të kenë 'pak mundësi për të qenë një rrezik për vetveten, rendin publik apo sigurinë publike'<sup>65</sup>.

Një numër vendesh kanë amenduar rregulloret e tyre kombëtare qysh prej vitit 2001, duke përfshirë Brazilin, Kamboxhian, Bjellorusinë, dhe Mbretërinë e Bashkuar. Sa i përket parandalimit të dhunës me armë zjarri në familje, Afrika e Jugut, Kanadaja dhe Australia paraqesin shembujt e praktikave të mira të cilat mund të përdoren nga vendet në Ballkanin Perëndimor.

### Afrika e Jugut

Afrika e Jugut ka përqindjen më të lartë në botë për vrasjen e grave. Nga studimet më të fundit rezultoi se një në çdo pesë persona që kanë vrarë gruan zotëronte ligjërisht një armë zjarri.<sup>66</sup> Kjo statistikë ve në dukje nevojën për një kontroll më të mirë të armëve si dhe legjislativën dhe rregulloret të përmirësuara që synojnë eliminimin e dhunës me armë zjarri ndaj grave. Përhapja e kësaj lloji dhune ka rezultuar në debate publike kombëtare dhe në ndërhyrje si nga qeveria ashtu edhe nga OJQ-të.

Në Dhjetor 2002, Gun Free South Africa dhe Technikon SA ndërmorën një studim mbi rolin e sistemit të drejtësisë penale në lidhje me përjashtimin e personave të papërshtatshëm për të poseduar armë zjarri<sup>67</sup>. Një prej konkluzioneve të tyre ishte se jot e gjithë zyrtarët përgjegjës për armët e zjarrit kontrollonin Regjistrin e Dhunës në Familje për të dhëna të mëparshme të dhunës në familje, dhe disa nuk e bënë fare këtë kontroll. Të tjera probleme të cilat shpesh pamundësojnë marrjen e armëve të ligjshme prej pronarëve potencialisht të papërshtatshëm janë të lidhura me faktin se incidentet e dhunës në familje janë shpesh të regjistruara muaj ose vite përpara se të konsultohet regjistri dhe mund të kenë ndodhur në afërsi të një rajoni të ndryshëm policie ose të një zone të ndryshme. Studimi gjithashtu zbuloi se gjykatat jo gjithmonë dërgonin informacionin për urdhrat mbrojtës në kohën e duhur.

Reformat legjislativë të ndërmarra për të adresuar problemin në Afrikën e Jugut përfshinë edhe kalimin e një Ligji mbi Dhunën në Familje dhe Ligji për Kontrollin e Armëve të Zjarrit. (nr. 116 i vitit 1998)<sup>68</sup> synuan të ofronin grave mbrojtje nga dhuna brenda familjes duke krijuar detyrime për organet e zbatimit të ligjit për të mbrojtur viktimat sa më shumë që të ishte e mundur. Ligji është i aplikueshëm për një sërë marrëdhëniesh Brenda familjes, dhe mbulon si lidhjet heteroseksuale ashtu dhe lidhjet mes të njëjtit seks. Sipas këtij Ligji, një viktimë e dhunës në familje mund të aplikojë për të marrë një urdhëresë mbrojtëse për të ndaluar abuzimin si dhe për të ndaluar abuzuesin për të hyrë në shtëpinë e përbashkët, në rezidencën e viktimës, apo në vendin e punës së viktimës.

Një nga novacionet kyçe të Ligjit lidhet me urdhëresat mbrojtëse të cilat përfshijnë konfiskimin e armëve të rrezikshme prej të pandehurit. Sipas Nenit 7(2a), gjykata mund të vendosi çfarëdo lloji kushti shtesë që konsideron si arsyeshëm të nevojshëm për të mbrojtur dhe garantuar sigurinë, shëndetin apo mirëqenien e ankimuesit, duke përfshirë edhe një urdhëresë për të sekuestruar armë të rrezikshme zjarri nga pronësia apo kontrolli i të pandehurit.

<sup>65</sup> Studim pozicionimi i IANSA: National regulation of small arms', <http://www.iansa.org/un/review2006/National-regulation-of-small-arms.pdf>, aksesuar më 29 Korrik 2007.

<sup>66</sup> Ellis, Estelle, 'Dying at the hands of their lovers', 28 Qershor 2004, <http://www.capeargus.co.za/index.php?fSectionId=49&fArticleId=2130110>, qasja është bërë më 20 korrik 2007.

<sup>67</sup> *Ibid.*

<sup>68</sup> Republika e Afrikës së Jugut, 'Domestic Violence Act', *Government Gazette*, Vol. 402, No. 116, Cape Town, 02 Dhjetor 1998.

Sipas Nenin 9, gjykata duhet të urdhërojë policinë që të sekuestrojë çdo armë në pronësi apo nën kontrollin e të pandehurit, nëse:

- (a) *Personi në fjalë ka kërcënuar apo ka shprehur synimin për të vrarë apo dëmtuar vetveten, apo çdo person në një lidhje familjare, qoftë me përdorimin apo dhe pa përdorimin e një mjeti të rrezikshëm apo arme zjarri të rrezikshëm; ose*
- (b) *Pronësia e të tillë mjeti apo arme zjarri të rrezikshme nuk është në interesin me të mirë të personit në fjalë apo cilitdo personi tjetër në një lidhje familjare, si pasojë e:*
  - (i) *Situatës psikike apo gjendjes mendore të të pandehurit;*
  - (ii) *Dhënia drejt dhunës; ose*
  - (iii) *Përdorimit apo varësia prej pijeve alkoolike apo drogave nga i pandehuri.*

Kjo masë ligjore i jep viktimës së dhunës në familje një mbrojtje të menjëhershme dhe efektive nga i pandehuri i cili ka një armë, të cilën e mban ligjërisht apo në kundërshtim me ligjin. Në këtë mënyrë, viktimë mbrohet qysh prej fillimit të procedimit kundrejt të pandehurit. Kjo është një masë e rëndësishme mbrojtëse, duke qenë se viktimat e dhunës në familje janë veçanërisht të cënueshme gjatë procedimit penal. Gjykata e urdhëron këtë masë duke marrë për bazë opinionin e saj, pa qenë i nevojshëm ndonjë aplikim prej ankimesit. Ajo urdhëron sekuestrimin e armës direkt prej policisë, në mënyrë që të ndërmerren hapa të menjëhershëm për të mbrojtur viktimën e dhunës në familje prej përdorimit të armës nga i pandehuri.

Çdo armë e rrezikshme që sekuestrohet duhet të mbahen nën kontrollin e policisë për aq kohë sa gjykata çmon të arsyeshme. Arma do të kthehet personit nën hetim, ose nëse personi nën hetim nuk është pronar, atëherë vetë pronarit, vetëm pas një vendimi prej gjykatës (Neni 9.3a dhe 9.3b). Gjykata mund të vendosi që arma të kalojë në favor të Shtetit nëse kjo gjë do të ishte në interes të sigurisë së cilitdo personi të interesuar (Neni 9.3iii).

Novacioni i dytë kyç në Ligjin mbi Dhunën në Familje është tentative e këtij ligji për të paraqitur monitorim dhe kontroll statusor të zbatimit të ligjit prej policisë. Legjislatorët kanë vendosur detyrime të veçanta për policinë, në mënyrë që të sfidojnë historinë e gjatë të lënies pas dore prej policisë të rasteve të dhunës në familje.<sup>69</sup>

Ligji prezanton një detyrim për policinë për të ndihmuar ankimesit dhe për ti informuar ata rreth të drejtave të tyre (Neni 2). Sipas kësaj mase ligjore, policia duhet të ndërmarrë veprime për të ndihmuar dhe mbrojtur viktimën në vendndodhjen e dhunës në familje apo sa më shpejt që të jetë e mundur pas kryerjes së aktit, apo kur ndodhia e dhunës në familje raportohet. Policisë i kërkohet që të shpjegojë ankimesve se policia është aty për të ofruar çfarëdo lloj asistence që bëhet e nevojshme prej rrethanave, që mund të përfshijë ndihmën që ankimesi të gjejë një banesë të përshtatshme apo të marrë trajtim mjekësor. Policia duhet të informojë ankimesit për të drejtën e tyre për të aplikuar për një urdhëresë mbrojtëse dhe për të filluar një procedim penal përmes një padie. Një oficer policie mundet, pa nevojën e një mandate, të arrestojë çdo individ në vendndodhjen e një incidenti të dhunës në familje, të cilin oficeri e sheh si të dyshuar si kryerësin e një krimi që përfshin elemente dhune (Neni 3). Policia është e detyruar që të arrestojë abuzuesin nëse ai nuk i bindet urdhëresës mbrojtëse.

Dështimi në zbatimin e këtyre detyrave që dalin nga Ligji mbi Dhunën në Familje përbën abuzim me detyrën. Komisioneri Kombëtar i Shërbimit Policor të Afrikës së Jugut është i detyruar që të paraqesë raporte gjashtë mujorë përpara Parlamentit, dhe përpara Drejtorisë së Ankimeve të Pavarura, që është organi civil i kontrollit.

Krijimi i Ligjit mbi Dhunën në Familje u ndoq nga disa amendime në Ligjin mbi Armët e Zjarrit. Ligji i ri për Kontrollin e Armëve të Zjarrit (2000)<sup>70</sup> paraqet një sistem dy-hapësh për licencimin e armëve të zjarrit. Një person i cili dëshiron të aplikojë për një leje duhet fillimit ti nënshtrohet një testi kompetence. Një certifikatë kompetence mund të mos i jepet një personi i cili është i epuar drejt dhunës, ose një personi i cili është dënuar, qoftë brenda qoftë jashtë Afrikës së Jugut, për një krim që përfshin abuzim fizik apo seksual që ka ndodhur brenda një lidhjeje familjare, ashtu siç përkufizohet në Ligjin mbi Dhunën në Familje (Neni 9.2h(ii)). Regjistruesi

<sup>69</sup> Vetten, Lisa, 'Addressing domestic violence in South Africa: Reflections on strategy and practice', Takimi i Grupit të Ekspertëve: Dhuna kundër grave: Praktikat e mira në luftimin dhe eliminimin e dhunës kundër grave, Vjenë: Seksioni i Kombeve të Bashkuara për Përparimin e Grave, 17 - 20 Maj 2005, f. 5.

<sup>70</sup> Republika e Afrikës së Jugut, 'Firearms Control Act', *The Official Gazette*, 2000.

mund ta deklarojë personin si të papërshtatshëm për të mbajtur një armë zjarri nëse një urdhëresë mbrojtëse është lëshuar kundërt këtij personi, sipas dispozitave të Ligjit mbi Dhunën në Familje (Neni 102.1a). Gjykata mundet gjithashtu të deklarojë një person si të papërshtatshëm, nëse ky person është burgosur apo dënuar për çfarëdo lloj krimi që përfshin abuzim fizik apo seksual që ka ndodhur brenda një lidhjeje familjare (Neni 103.1(i) dhe (l)).

Ligji përmban dispozita që lidhen me deklaratat e papërshtatshmërisë të cilat lejojnë policinë që të heqë armët prej shtëpive ku ushtrohet dhunë dhe të ndalojë të pandehurin që të marrë leje të tjera për armë për pesë vjet. Një certifikatë kompetence skadon pesë vjet pas datës së lëshimit (Neni 10.2), kështu që kushdo që dëshiron të zgjasë lejen për mbajtjen e armës së zjarrit duhet ti nënshtrohet prapë testit të kompetencës.

Këto ndryshime ligjore janë mbështetur duke forcuar politikat kundër dhunës në familje. Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Krimeve i konsideron krimet e dhunshme ndaj grave dhe fëmijëve si një prioritet kombëtar, një status që këto krime kanë vazhduar ta ruajnë në dokumente të mëvonshëm të planifikimit strategjik kombëtar<sup>71</sup>.

## Kanadaja

Në Kanada, mesatarisht 40 për qind e grave të vrara nga burrat e tyre qëllohen me armë zjarri; shumica (80 për qind) e këtyre qëllohen me pushkë dhe shotgun ligjërisht të poseduara<sup>72</sup>, gjë që tregonte nevojën urgjente për një reformë në legjislacionin e kontrollit mbi armët e zjarrit. Në 1995, Kanadaja miratoi Ligjin mbi Armët e Zjarrit, i cili përfshin, midis të tjerash:

- a) Regjistrimin e të gjitha armëve të zjarrit brenda vitit 2003 si dhe një sistem kombëtar informacioni;
- b) Kontroll i rreptë i liçensimit për të gjithë armëmbajtësit të cilët posedojnë armë zjarri (me licencë të rinovueshme çdo pesë vjet) brenda vitit 2001, si dhe kontrole të vazhdueshme për përshtatshmërinë e mbajtjes së armës së zjarrit;
- c) Kontrole mbi shitjen e municioneve;
- d) Dënime më të forta për përdorimin abuziv të armëve të zjarrit.

Ligji mbi Armët e Zjarrit paraqet masa për liçensimin e pronarëve të armëve dhe për regjistrimin e armëve të zjarrit. Të kombinuara me trajnimin dhe zbatimin e përshtatshëm, këto masa janë esenciale për të hequr armët e zjarrit prej situatave ku gratë janë të rrezikuara. Sipas ligjit të ri<sup>73</sup>, një licencë është e nevojshme për të mbajtur armë zjarri, dhe raporte për dhunën në familje dhe të tjera shkelje automatikisht sjellin një rishikim të licencës së pronarit të armës së zjarrit. Ky është një përmirësim në krahasim me situatën e mëparshme, kur Certifikata e Blerjes së Armës së Zjarrit ishte e nevojshme vetëm për të blerë armë dhe jo për t'i pasur ato në pronësi, dhe dy të tretat e pronarëve të armëve të zjarrit nuk kishin një leje të vlefshme<sup>74</sup>. Licencimi i armëmbajtësve është thelbësor, me synimin për të mbajtur armët larg duarve të burrave potencialisht abuzivë, apo larg individëve me një histori të dhunshme. Ligji i ri detyron kontrole të zgjeruara të sfondit historik për çdo person i cili aplikon për një liçencë.

Sipas këtij Ligji, bashkëshortët e tanishëm apo të kaluar (në tre vitet e shkuara) do të lajmërohen për synimin e një individi për të marrë një liçencë për armëmbajtje. Miratimi i bashkëshortes nuk është i nevojshëm për të lejuar blerjen e armës, gjithsesi, nëse një bashkëshorte ka shqetësime në lidhje me këtë fakt, atëherë ndërmerret një rishikim i dytë i aplikimit për leje. Së bashku me lajmërimin e bashkëshortes, një linjë me një numër pa pagesë

<sup>71</sup> Vetten, Lisa, 'Addressing domestic violence in South Africa: Reflections on strategy and practice', Takimi i Grupit të Ekspertëve: Dhuna kundër grave: Praktikata e mira në luftimin dhe eliminimin e dhunës kundër grave, Vienë: Seksioni i Kombeve të Bashkuara për Përpërimin e Grave, 17 – 20 Maj 2005, f. 2.

<sup>72</sup> Burimi: Guns and Domestic Violence, <http://www.guncontrol.ca/Content/DomesticViolence.html>, qasja është bërë më 12 Gusht 2007.

<sup>73</sup> Deri më Tetor 2001, në gjithë Kanadanë, më tepër se 4,000 liçenca për armë zjarri janë refuzuar apo revokuar qysh prej hyrjes në fuqi të ligjit në ri në 01 Dhjetor 1998. Kjo shifër tregon se janë bërë 32 herë më shumë revokime armësh nga persona potencialisht të rrezikshëm, në krahasim me pesë vitet e fundit të aplikimit të ligjit të vjetër. Gjithashtu, 90,400 shitje armësh potencialisht të rrezikshme janë dërguar për hetime të mëtejshme (*Guns and Domestic Violence*).

<sup>74</sup> Burimi: Guns and Domestic Violence, <http://www.guncontrol.ca/Content/DomesticViolence.html>, qasja është bërë më 12 Gusht 2007.

(1-800-731-4000) u krijuar për bashkëshortet e aplikantëve, apo të tjerë individë që mund të kishin shqetësime në lidhje me sigurinë e tyre<sup>75</sup>.

Reforma ligjore është mbështetur fuqimisht nga sektori civil në Kanada, i cili ka kërkuar zhvillimin e një Strategjie Kombëtare Parandalimi gjithëpërfshirëse në lidhje me kontrollin e armëve të zjarrit dhe luftën ndaj dhunës në familje. Koalicioni Kanadez për Kontrollin e Armëve ka bërë një seri rekomandimesh në lidhje me zbatimin e ligjit të tanishëm si dhe ndryshimet në rregulloret që lidhen me ligjin e ri<sup>76</sup>. Këto përfshijnë:

- a) Një përjasje të tipit 'nëse ka dyshime, atëherë nuk jepet', në lidhje me liçencat për armët e zjarrit;
- b) Lajmërime rutinë të bashkëshortëve të tanishëm apo të mëparshëm në lidhje me aplikimin për certifikata dhe leje për blerjen e armës së zjarrit;
- c) Përmes kontrolleve të komunitetit që ndërmerren nga policia, nëse një ish bashkëshorte nuk mund të gjendet. (Privatësia dhe siguria e atyre që marrin pjesë në këtë investigim duhet të jetë e siguruar);
- d) Njohje të faktit se shumica e viktimave të dhunës në familje sulmohen 30 herë përpara se të paraqitet një ankimim formal. Pavarësisht nga ky fakt, studimet tregojnë se problemi është shpesh i ditur;
- e) Zgjerim i hetimit përtej bankave të të dhënave lokale. Kjo është shumë e rëndësishme për të siguruar që kontrollet janë gjithëpërfshirëse. Aplikuesit janë të detyruar të paraqesin informacion mbi rezidencën e mëparshme për pesë vitet e shkuara, dhe policia duhet të kontrollojë edhe në ato juridiksione të mëparshme;
- f) Praktika standarde në lidhje me gjithë rastet e ndodhura të dhunës në familje duhet të përfshijë hetimin rreth prezencës së armëve të zjarrit dhe aplikimin e menjëhershëm të masave për të hequr armët aty ku perceptohet se ka një risk. Kundërvajtësit duhet të bëhen publikë dhe një konsideratë serioze i duhet dhënë procesit të revokimit të lejeve dhe marrjes së urdhëresave ndaluese atje ku ka një kërcënim për sigurinë e kujtdo individi;
- g) Edukim gjithëpërfshirës për policinë dhe të gjithë pjesëmarrësit në sistemin gjyqësor është akoma i nevojshëm urgjentisht në lidhje me dhunën në familje. Ekziston nevoja për të përmirësuar kuptimin e rreziqeve që lidhen me armët e zjarrit. Të gjitha palët duhet të kuptojnë shpeshtinë me të cilën armët e zjarrit janë pjesë e ciklit të dhunës në familje, veçanërisht në zonat rurale. Ato duhet ta dinë dhe të aplikojnë të gjitha masat që kanë në dispozicion për të reduktuar këto rreziqe;
- h) Më tepër kërkim dhe një monitorim më i mirë i arritjeve nevojitet për të siguruar përgjegjshmëri.

## Australia

Kontrolli i armëve për një kohë të gjatë ka qenë një shqetësim i atyre që punonin me reduktimin e dhunës në familje në Australi<sup>77</sup>. Diferenca mes një episodi fatal dhe jo-fatal të dhunës në familje mund të krijohet krejtësisht prej pranisë së një arme të rrezikshme zjarri<sup>78</sup>. Reformat e ligjit mbi armët e zjarrit në vitet 1990të<sup>79</sup> kanë paraqitur masa që synojnë goditjen e përdorimit të armëve të zjarrit në dhunën në familje<sup>80</sup>.

Sipas legjislacionit të ri, pronësia e armëve të zjarrit ka nevojë për një liçencë, e cila mund të merret duke përbushur një seri kriteresh që përfshijnë moshën minimale 18 vjeç, një histori penale të pastër, të qenurit 'një

<sup>75</sup> Në periudhën mes Dhjetorit 1998 dhe Tetorit 2001, linja ka marrë më tepër se 26,000 telefonata (Canadian Firearms Centre, Making a Difference: The Firearms Act, available at: <http://www.cfc-ccaf.gc.ca/en/legal/act/default.asp>).

<sup>76</sup> Burimi: Guns and Domestic Violence, <http://www.guncontrol.ca/Content/DomesticViolence.html>, qasja është bërë më 12 Gusht 2007.

<sup>77</sup> *The impact of guns on women's lives*, Amnesty International, IANSA dhe Oxfam International, Oxford, 2005. f. 17.

<sup>78</sup> 'Firearms Western Australia', faqja internet e Policisë së Australisë Perëndimore, <http://police.wa.gov.au/Services/pdf/schoolprojects.pdf>, qasja është bërë më 25 Korrik 2007.

<sup>79</sup> Ligji mbi Armët e Zjarrit 1996 (New South Wales), Ligji mbi Armët e Zjarrit 1996 (Victoria), Ligji mbi Armët e Zjarrit 1977 (South Australia) (sipas amendimeve të vitit 1996). Në vitin 1996 dhe 1997, të gjitha shtetet dhe territoret e Australisë amenduan ligjet e tyre mbi armët e zjarrit, për tu përputhur me Marrëveshjen Kombëtare për Armët e Zjarrit, të Adoptuar në Maj 1996.

<sup>80</sup> Australian Government, 'Reform - The Australian firearms buyback scheme', faqja internet e Prokurorit të Përgjithshëm, [http://www.familyrelationships.gov.au/www/agd/agd.nsf/Page/Firearmsregulation\\_Reform-theaustralianfirearmsbuybackscheme](http://www.familyrelationships.gov.au/www/agd/agd.nsf/Page/Firearmsregulation_Reform-theaustralianfirearmsbuybackscheme), qasja është bërë më 02 Gusht 2007.

individ i shëndetshëm e i përshtatshëm', nënshtrimi i një trajnimit për sigurinë, dhe tregimi i 'arsyeve të sinqerta' për mbajtjen e armës. 'Arsyet e sinqerta' duhet të provohen veças për secilën armë zjarri, duke vendosur efektivisht një limit mbi numrin e armëve të zjarrit që një person i vetëm mund të posedojë.

Kur vendos nëse të japë apo të rinovojë një liçencë, policia mund të marrë në konsideratë të gjitha rrethanat relevante. Dhuna në familje është një arsye e mundshme për të refuzuar apo shfuqizuar liçencën. Masat ligjore që lidhen me këtë çështje janë shumë të ngjashme në të gjitha shtetet e Australisë. Në New South Wales, refuzimi i një kërkesë për liçencë apo shfuqizimi i një liçence janë të detyrueshme nëse një person ka qenë subjekt i një urdhërese shtrënguese në dhjetë vitet e fundit, ndërsa në shtetin Australian Capital Territory, në tetë vitet e fundit. Në shtetin Victoria, një liçencë mund të revokohet përmes një urdhërese ndërhyrëse, dhe historia e dhunës në familje merret parasysh në aplikimin e ri. Në shtetin New South Wales, policia është e detyruar që të konfiskojë armët në rastin e dhunës në familje. Në shtetet Victoria dhe Queensland, policia ka fuqinë që të sekuestrojë armët e zjarrit, mbi bazën e një urdhërese shtrënguese për dhunë në familje, nëse arma mund të përdoret në aplikimin e dhunës në familje.

#### **Masa të tjera përfshijnë<sup>81</sup>:**

- a) Personave të dënuar për sulm ndaj personave të tjerë u hiqet e drejta për të marrë një liçencë për armë zjarri për të paktën pesë vjet;
- b) Personave që janë subjekt i urdhëresave shtrënguese për dhunë në familje u hiqet e drejta për të marrë një liçencë për armë zjarri për pesë vjet;
- c) Personat që kanë një urdhëresë shtrënguese për dhunë në familje janë subjekt i konfiskimit të detyrueshëm të të gjitha armëve të tyre;
- d) Të gjitha armët duhet të regjistrohen në momentin e blerjes si dhe kur rinovohet licenca;
- e) Ekzistenca e një periudhe 28-ditore priteje përpara se të blihet një armë.

Vlerësimet për reformat në Australi nxorën si konkluzion faktin se ligjet kishin sjellë një reduktim dramatik të vdekjeve prej armëve të zjarrit<sup>82</sup>.

Përveç Australisë, 15 shtetet e tjera të Forumit të Ishujve të Paqësorit ranë dakord për një Ligj Model për Armët në vitin 2003, që përmbante një radhë masash të ngjashme për rregullimin e pronësisë mbi armët e zjarrit<sup>83</sup>. Respektivisht, individët që janë subjekt i urdhëresave shtrënguese për dhunë në familje nuk kanë të drejtë të marrin një liçencë për armë zjarri për pesë vjet. Individët që kanë urdhëresa shtrënguese për dhunë në familje janë subjekt i konfiskimit të detyrueshëm të të gjitha armëve të zjarrit në pronësi të tyre. Të gjitha armët e zjarrit duhet të jenë të regjistruara në momentin e blerjes apo kur licenca duhet të rinovohet. Ekziston një periudhë 28-ditore për 'ftohjen' përpara se të blihet një armë zjarri. Armët e zjarrit nuk mund të blihen apo të shiten privatisht, por vetëm nëpërmjet tregtarëve të liçensuar apo përmes policisë. Ekzistojnë kërkesa strikte mbi mënyrën e ruajtjes dhe depozitimit të armëve të zjarrit.

<sup>81</sup> *The impact of guns on women's lives*, Amnesty International, IANSA dhe Oxfam International, Oxford, 2005. f. 17.

<sup>82</sup> Chapman, S. et al., 'Australia's 1996 gun law reforms: faster falls in firearm deaths, firearm suicides, and a decade without mass shootings', 06 Nëntor 2006, <http://injuryprevention.bmj.com/cgi/content/full/12/6/365>, qasja është bërë më 1 Gusht 2007.

<sup>83</sup> Studim pozicionimi i IANSA: National regulation of small arms', <http://www.iansa.org/un/review2006/National-regulation-of-small-arms.pdf>, qasja është bërë më 29 Korrik 2007.

## Shtojca B – Bibliografia

### **Për këtë studim janë konsultuar botimet, dokumentacionet, raportet dhe dokumentet e mëposhtëm:**

'Firearms Western Australia', <http://police.wa.gov.au/Services/pdf/schoolprojects.pdf>, qasja është bërë më 25 Korrik 2007

'Guns and Domestic Violence', <http://www.guncontrol.ca/Content/DomesticViolence.html>, qasja është bërë më 12 Gusht 2007

'Marrëveshjet Ligjore dhe Sociale për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje: Analizë mbi konkluzionet e vendimeve gjyqësore në Tiranë, Shkodër, Vlorë', Tiranë, 2005

'Strategjia Afatgjatë për Zhvillimin e Sistemit Shëndetësor", Shqipëri, 2004

'Plani Kombëtar i Veprimit për Përmirësimin e Pozicionit të Grave si dhe për Nxitjen e Barazisë Gjinore; 2007-2010', <http://www.awin.org.yu/NAP/indexN.htm>, qasja është bërë më 20 Gusht 2007

'Raporti Kombëtar i Avokatit të Popullit 2006', Kroaci, <http://www.prs.hr>, qasja është bërë më 12 Gusht 2007

'NGOs in the Former Yugoslav Republics Focus on Education of Youth to Change Post-War Culture of Violence', 09 June 2007, [http://www.stopvaw.org/NGOs\\_in\\_the\\_Former\\_Yugoslav\\_Republics\\_Focus\\_on\\_Education\\_Youth\\_to\\_Change\\_Post-War\\_Culture\\_of\\_Violence.html](http://www.stopvaw.org/NGOs_in_the_Former_Yugoslav_Republics_Focus_on_Education_Youth_to_Change_Post-War_Culture_of_Violence.html), qasja është bërë më 04 Tetor 2007

